

BIBLIOTEKA

SHYQYRI FEJZO

8.34-32

F 39



Ta mendojmë..!

Satirë Humor

8SH-32
F39

SHYQYRI FEJZO

Ta mendojmë

satirë



humor



SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

Redaktor
NAUM PRIFTI

Piktor
KASTRIOT ZAIMI

Recensues
Stavri Pone
Xhezair Abazi

HALLET E HALLËS SIME

— Do ta mbajmë gjatë hallën kësaj radhe. Nuk e lë të ikë, sikur njëra të bëhet. Të çlodhet ca ditë këtu në qytet. U kapit me punë në fshat, e uruara! — më thotë ime shoqe më e vendosur se kurrë. Doemos, pranova. Si do kundërshtoja për hallën time që, kur isha i vogël, më nginjte me përralla?

Dy-tri ditët e para halla rrinte si mbi gje-mba. Nuk orientohet dot. E po, thamë, kështu e ka fillimi, sa të mësohet. Mirëpo edhe më vonë ajo dukej e menduar dhe e murrëtyer në fytyrë më keq se murlani në ditë të dhjetorit. Le përralla që s'kujtohet t'i rrëfente nipit, po edhe përgjigjet i kishte të kursyera.

— Si e kalove sot? — i thashë një ditë duke i hedhur dorën lehtë-lehtë në qafë. — Çelu, çelu pak, të shkretën, se nuk të kanë humbur lopët në mal, — e ngacmova me të mirë.

— Lopën e vëçin, t'u bëftë halla, di vetë si t'i ruaj e si t'i kullot, po ti do të bëje mirë ta lidhje më shkurt atë mëzin tënd, se lamë nam në mes të qytetit, — ma ktheu ajo.

* * *

— E, që thua ti nipçe, pardje doli më vonë se ju. «Ika, hallë», më tha pasi kullufiti bukën, dy vezë dhe pak mjaltë që kishte mbetur në kavanozin që solla nga fshati. «Ku e ke çantën, të keqen halla?» e pyeta, kur e pashë se ishte masát. «Kemi punë sot», foli në të dalë dhe theri tutje në qytet. Bëra punët e mëngjesit, i rregullova dhe krevatin. Era e bishtave të cigareve po më shponte hundën.

— Pse, edhe duhan pi shejtani? — pyeta hallën.

— Dale, dale, se të çlodh halla ty! — tha me sytë ngulur në qilim. — Duhani nuk është gjë fare. Aty si nga dreka bie zilja. Kur hap derën, shoh dy burra që prisnin te pragu e në mes tyre Selami. Më panë e i pashë nga koka te këmbët. Yt bir seç më bënte me shenja.

— Shtëpia e Zaçe Bandillit? — pyeti më i moshuari.

— Po, — iu përgjigja me kokën lart. — Urdhëroni brenda! — i ftova si në shtëpinë time.

— Zaça, këtu është? — pyeti tjetri.

— Jo, t'u bëftë nëna. Kthehet vonë nga puna, — i sqarova. Vura re se të dy sikur u përtypën.

— Ç'bëri me Zaçen, ç'bëri me nënën. Ia themi dhe le ta kopsitin vetë, ëmë e bir, — tha i moshuari.

— Ky djalë, ta marrësh vesh ti, nëne, sot na ka bërë një dëm të madh, në serrat e luleve, me kuajt e karrocave. I trembi ata me teneqe e

stapinj e nuk kanë lënë vazo pa thyer. Gjashtë muaj punë na duhet tani ta kthejmë siç ishte. E pa vetë ky shoku i këshillit të qytetit e nuk kam çfarë të shtoj, — iu drejtua pikë e vrer atij më të riut.

«Korba unë», thashë me vete. Dëme të mëdha, gjashtë muaj punë, vazo të thyera!

— I thoni Zaçes të vijë andej nga ne pasnesër se kjo punë nuk do të mbetet me kaq, — tundi gishtin ai i këshillit dhe të dy zbritën shkallëve. Asnjë raki nuk i qerasi dot halla. E humba fare. E t'i kthehem djalit pastaj. Vetëm fshesa e shtëpisë mbeti pa përdorur. Më pas e ula tallazin, se m'u duk që u prek shumë. Krojti pak kokën e rrëzën e veshit, i mori nur fytyra dhe më tha:

— O hallë! Unë u gënjeva me ata kuajt. Doja të bëja pak hipizëm. Hallë, moj hallë, sa e mira je ti! Nuk do t'i tregosh babit për atë që na ngjau, se na piu e zeza të dy, më bëri ortak me fajn diali. Dhe atij muhabeti halla i vuri një gur e një plis. Nuk të rrëfeva, se më erdhi keq për djalin. Po tani do t'i zbraz të gjitha, nuk i mbaj dot më.

— Pse, ke të tjera? — pyeta.

Para një jave, që thua ti Zace, halla pati fatin të njihet me përgjegjësin e bllokut të lagjes suaj. Shpirt njeriu ishte.

— Këtë djalë, — tha ai, — e kemi zënë duke thyer xhamat e sahateve të ujit në shkallë. «Mos e ngatërron me ndonjë tjetër, more bir! Nuk kemi asi djali ne», i dal krah, të lehtësoj një çikëz Selamin që rrinte si pulë e lagur.

— A ka plackë këtu? — shqeu me gisht qepallat ai i bllokut dhe syri filxhan i ndriti.

E luta të vinte brenda, po nuk ishte gjë që bëhej.

— Për herë të parë shihemi, moj nëne. Më vjen keq që u njohëm kështu. I thuaj dy fjalë Zages, — më porositi kur u largua.

Filluan përsëri lutjet, betë e rrufetë. se do bëhej djalë i urtë. E besova. Nuk kaluan disa ditë nga kjo që të rrëfeva. kur bie zilja sërish. Një goxha polic te dera me një burrë as plak as të ri.

— Jam punëtori i policisë, kurse ky është shoku Muntaz, kryetari i frontit i lagjes sonë, — më tha ai.

— Qofshi shëndoshë! — u them duke i rrokur për qafe. Ata sikur u stepën.

— Mos banon këtu një djalë me emrin Selam? — pyeti punëtori i policisë. «Këtu, të keqen nëna. Ç'e doni?» fola me buzë e qiellzë të tharë nga merak. Ata shikuan njëri-tjetrin. I pari foli ai kryetari i frontit: «Selami, që thua ti, nëne. ka pirë në klub dhe është rrahur me dy të tjerë. Bënë berihaj të madh mbrëmë. Kjo nuk ju nderon.»

— Qenka bërë macja të pijë uthull, i themi ne andej nga fshati.


— Me uthull nuk besoj të bënte ato zullume që bëri. — ma preu Muntazi.

Mua sikur ma dha me thikë në brinjë dhe s'di si nuk thirra.

Halla tregonte e vetëkush e di se si ishte bërë në fytyrë! E pashë se edhe asaj po i vinte keq.

— Po më e madhja qe kur më erdhën mësuesit e tij nga shkolla, — vazhdoi halla me sytë përdhe e givsmë zëri.

— Kemi ardhur të themi se Selami nuk po vjen në rregull! Ka bërë gjithato mungesa në



mësime, — e mori fjalën një mësuese. Unë e gjora e dija se djali shkante në punë, siç më tha para një jave. Ata punën e kishin pas një muaji. E po të më gënjente dhe mua, këtë s'ia pata borxh, ndaj po e zbraz thesin, — tha ajo me inat.

* * *

Të nesërmen u ngrit më herët se ditët e tjera. Bëri palë plaçkat dhe diçka po rregullonte në korridor. Ime shoqe kishte ikur me kohë në punë. U ngrita me të shpejtë, se më pëlqente ta pija kafën me hallën. Pas dhjetë minutash filxhanët lëshonin avull të nxehtë mbi tavolinë.

— Pse u ngrite kaq herët, hallë? — pyeta ëmbël duke gjerbur kafën.

— Po bëhem gati të iki, të keqen halla. Erdha, ndenja, u çmallëm. Tani, me leje...

— U, u, u! Ç'është ajo fjalë! — e ndërpreva në çast. — Ne akoma nuk jemi çmallur. Nuk kemi pasur as kohë... Pastaj, pa më dëftyer një përrallë? Nuk e kishim fjalën kështu, — i thashë duke i rënë krahëve si dikur.

Mirëpo nuk u zbut gjëkund. Si u mendua pak, puliti sytë, rrufiti kafën e buzëqeshi befas. Pastaj dorën tërë rreshka ma vuri butë mbi gju dhe vazhdoi:

— Ke të drejtë. Dunet të rrëfeja një përrallë. A ta nis tashti? Na ishte njëherë një burrë e një grua që jetonin në fshat...

— Mos vdeksh kurrë, hallë! — i them, pa ia ndarë sytë asaj fytyre aq të dashur e me rrudha pleqërie. Vështrimet na u kryqëzuan. Bebëzat e syve të saj sepse m'u dukën më të vogla e sikur fshihnin dinakëri.

... — E që thua ti, nipçe, ata jetonin mirë, me punën e hallet e tyre. Kishin ara, pemë, bagëti, si tërë fshati. Pa kishin dhe një kalë të bukur kërr, si ata që mbanin sulovarët dikur. Kujdes

të madh bënin për kalin. Përnatë i hidhnin të hante gjethe, pak tagji, bar kasolleje, kripë Vlore e ujë bore. Kur theu dimri e po zvogëlohej nata, zahiresë i erdhi fundi. Po arat me hasëll jeshilonin. Çdo ditë e kullosnin për kapistre, herë burri e herë gruaja. «Ta lëshojmë të kullosë sipas qejfit», i thotë një ditë së shoqes. Më mirë ta mbajmë për kapistre, se kushedi harbohët nga hasëlli, i ishte përgjigjur ajo. «Ta lëshojmë, ta lëshojmë, se më vjen keq», u lut i shoqi. Dhe ashtu bënë. Dita zmadhohu drejt beharit e hasëlli rritu. Kali po vazhdonte si në lëmë. Erdhi e u shëndosh sa i shëndrishte qimja si sedefe. Hasëlli që në prag të beharit po gjysmohej nga kali. «Drutë e dimrit po na lënë shëndënë, more burrë», i thotë një ditë e shoqja të zot të shtëpisë. «Kalin pse e kemi! Zëre t'i vëmë samarin, tha i shoqi, dhe, po s'ta solla vesh e bisht me dru, mos më thëncin burrë.»

Niset gruaja të zërë kërrin. Po ku të afronte ai! E ndoqi sa e ndoqi për së gjati arës. Pastaj iu fut kryq e tërthor. Sa i afrohej tre-katër çapa, niste vrapin e ri kërrin, sa të bënte zarar mendja. Kur u lodh e u kapit gruaja, thirri të shoqin. E po të dy bashkë e kishin më të lehtë. U ndanë duke i zënë prita në vende të ndryshme. Nuk qe e mundur. Duke ecur revan në hasëllin e ngritur, e shtroi me këmbë dhe e bëri lëmazhde. Burrë e grua, të kapitur, thirrën lagjen, kali kaptoi arat e të zot dhe, si i tërbuar, mori fshanë. Nuk zihej, se kishte kullotur pa stap, si Selami yt. Ta thotë shkoqur halla, ndaj dua të iki, se nuk i kap dot kuaj të tillë. U plaka, nipçe!

Në çast m'u errën sytë. U kapërdiva dhe m'u bë se kisha përtypur një gorricë të papjekur.

Pastaj e mblodha shpejt veten nga sulmi shpartallues e i befasishëm.

— Ti, hallë, nuk do ikësh, — i them me zë të butë e krejt të ndryshuar. — E di pse? Pas dy javësh ne do të shkojmë në shtëpinë e re, në lagjen tjetër. Atje do të jemi më mirë, më gjerë, — ndërrova muhabet, me shpresë t'i ndryshoja mendjen.

— A t'u bëftë halla, t'u bëftë! Sa nipçe i mirë je! Ke qejf që halla të njohë dhe të zgjedhurit e lagjes tjetër? Jo, të keqen halla, mjaft i kam dhe këta që njoha këtu... — U ngrit, më puthi në të dy faqet e, duke marrë bohçen, më tha: — Mirupjekshim, nipçe!

TA MENDOJMË...

— Shahin, jepe fjalën, mos u mendo shumë, — i thoshte xha Hajroja moshatarit të vet.

Shahini kishte kërrusur kokën dhe gërmonte dheun me një copë shkop.

— Po e dha fjalën Shahini, e mban.

— Ti, Jaho, flet si për pasnesër. Cili është ai që i thotë vetes burrë dhe nuk e mban? — ndërhyri në mes të muhabetit Tahiri.

— Kot rropatet gjatë. Se, në fund të fundit, të rinjtë i kanë ujdísur vetë telat... — foli Kamberi.

— Hë! Si thua? Apo të ka shkrepur të bësh një mundje me krushkun e ri? — nanuriti fjalën përsëri Hajroja.

— Mirë e ke. I ke pasur qejf ato mundjet, Shahin, — ia pati Zyferi.

— E, i kam pasur ca qejf, po bashkë nuk jemi rrokur ndonjëherë, se ti rri larg e jep vetëm këshilla. Bën mirë të vish kur të ndeshem sonte dhe me krushkun e ri, — përfundoi Shahini.

Në fytyrat e të gjithëve u ndez një buzëqeshje e lehtë duke kujtuar ngjarjen e tridhjetë e ca viteve të shkuara. Që atëherë nën urën e fshatit ka rrjedhur shumë ujë, po ndodhia nuk u harrua.



Fshati ynë ngriti të parën kooperativë bujqësore në rreth dhe ne domosdo krenoheshim. Na e prishte pak vetëm Shahini, që s'pranoi të futej. Atij i tha njëherë goja jo dhe jo. E lutëm e iu falën miqtë e shokët. Nuk qe e thënë. I folën fëmijët e gruaja, Nuk u njom. Më pas i thanë të merrte tredynymshin ku të donte të mbante dhentë më të mira, sipas statutit. Atij i hipën kacabuntë më keq. «Pse, hall prone kam unë? Jo, or jo! Nuk dua të më barazoni me Muratin e me një takëm si ai që s'ia kanë thënë kurrë për punë. «Dhe kur e sqaruan se si do të matej e do të vlerësohej puna, ai nuk u bind. Mirëpo kush të linte të rrije vetëm? Kjo ishte punë që nuk bëhej. Kësisoj, në shtëpinë e Shahinit kumbisën radhazi shokët, miqtë, të deleguarit. Një palë iknin, vinin të tjerë, nga fshati, nga lokaliteti e rrethi.

— Kooperativa u bë. Ç'keni me mua? Kur

të më mbushet mendja, do të hyj, — përgjigjej i zoti i shtëpisë, para e pas rakisë.

Një natë iu mblodhën në shtëpi miq e shokë, të vjetër e të rinj. Hajroja, kryetari i lokalitetit, dukej më i sikletosuri. Bënte nga bënte dhe te kooperativa e çonte fjalën.

— Hë! Si thoni, more shokë! Njolloset fshati se nuk hyri një familje në kooperativë? Jo, kurrrë! Këto fjalë m'i ka thënë edhe i deleguari i rrethit. Pse po i luteni kaq shumë, më pyeti, pse krijoni përshtypjen se s'bëni dot pa të?

«Qenka burrë i zgjuar», mendoi Shahini.

— Apo nuk është i fortë, — vazhdonte të fliste Hajroja.

Shahini kishte vënë bërnylin në gju, dorën në mjekër e vetëm dëgjonte.

— Vërtet, a është i fortë? — pyeti Shahini për t'u siguruar.

— Ka për borxh të rrëzojë ariun... — ia pati ai.

— Po të jetë si thotë Hajroja, e bëjmë kështu. Të rrokemi njëherë si burrat rë mes të fshatit. Po më munda, hallall i qoftë, e vura firmën. Po fitova, mos më çaprrathitni më... — propozoi Shahini.

Në konak ra heshtja, secili mendohej për fatin e ndeshjes. Shahinit nuk i dilte njeri përpara për mundje. Kishte fituar me moshatarët e vet në fshat e në nahije. Sa herë ishte rrokur me barinj që vinin për verim bagëtish në male, i kishte vënë me shpatulla në barin e bjeshkëve të Lenies. Ishte rrokur me myzeqarë, me vllahë e barinj nga Saranda. Bëmat e tij kishin kaluar gojë më gojë. Dhe bagëtitë e Shahinit hanin vetëm barin e larë.

Njëri thoshte se Shahini kishte palosur një bari me nam nga filan fshat, tjetri ia priste se të mundurit nga Shahini nuk numëroheshin.

— Punë që s'bëhet, — foli ngadalë një mik i largët që u ndodh te Shahini.

— Pse s'u bëka?

— I deleguari është ca më i moshuar se Shahini. Apo keni qejf të lërë ndonjë eshtër këtu e t'u mbetet nami si fshat? — u hodh sërish miku i largët.

Të gjithë kthyen sytë nga Hajroja. Edhe ai mendohej. Pastaj ngriti kokën e foli.

— I deleguari i parë, Petroja, nuk vjen më. E kërkuan kryetar kooperative në Shpat. Tani na ka ardhur një tjetër. Është më i imët se Petroja, do t'i themi njëherë nesër, do t'i themi. Po na dëgjoi, rrokuni, — tundte kokën me gjithë kapelë kryetari i lokalitetit.

*

*

*

Në mes të fshatit po mblidheshin njerëzit për të zgjedhur kryesinë dhe kryetarin e kooperativës së sapokrijuar. Së fundi, kryetari i lokalitetit, Hajroja, me një mesoburrë, veshur me tuta blu, një kapelë meshini e me kollare, dolën në një vend të lartë. Kënga u pre, bisedat pushuan dhe sytë u drejtuan andej.

— Para se të fillojmë nga zgjedhjet, kemi një sherr për të ndarë. Në kooperativë ka mbetur pa hyrë vetëm Shahini. I kërkua të mos ndahet nga shokët, po na ka vënë një kusht: kërkon një mundje me të deleguarin.



— Ky miku, po e bëri kabull, le të urdhërojnë, — u drejtua Shahini nga i deleguari.

— Është turp për fshatin tonë.

— Shahini të deleguarin e hedh me gishtin e vogël.

— Shahini ka thyer brinjë... Ka mundur arinë... — dëgjoheshin zëra. I deleguari bëri dy hapa përpara dhe i foli me zë të lartë. «Eja!» Zhurmë e mbytur në turmë. Disa po hapnin vend në mes të sheshit.

— Po i hëngrën brirët, le t'i kruajë, — u dëgjua një zë nga turma.

I deleguari hoqi kapelën, shallin dhe i vuri në një gur të lartë. Shpiu mirë e mirë gjymtyrët sikur po bënte nxemje dhe mori për nga sheshi i duelit. Hajroja dha sinjalin e ndeshjes. Ajo nisi me vrull. Një palë nxitnin të deleguarin, të tjerë Shahinin.

— T'u bëfsha! Nguli mirë këmbët. Po fitove ti, as unë nuk futem, se për mua kishte firmosur gruaja, — i foli Zyferi si afër veshit.

— Vëri xhengën.

— Stërkëmbësin, — dëgjoheshin zëra.

Shahini iu derdh të deleguarit dhe u përpoq ta kapte afër belit. Kundërshtari i dredhoi me sukses. Shahini kreu një kapje tjetër, sa të gjithë menduan se i deleguari u dorëzua. Po nuk ndodhi tamam ashtu. Ai papritur e mbërtheu për qafe me ata krahët si morsetë metalike dhe e shtrëngoi fort. Në fillim Shahinit i ngjau sikur po ia tërhiqnin damarët e trupit e po ia shtrydhnin në gropë të qafës. Bërrylat e duart e të deleguarit, të ngatërruara si mos më keq, po ia përdridhnin qafën. Dha e mori t'i shpëtonte, qe e pamundur. Nuk i

shqitej nga qafa i deleguari. Sytë po i kërcenin jashtë vendit. Iu mblodh gjaku në kokë, sa i dukej se do të pëlciste nga çasti në çast. Ndjeu se forcat po e linin. Ustai, pas këtyre shtrëngimeve, i bëri avazin tjetër: e shtriu me shpatulla në sheshin e fshatit. Shpërthyen urratë.

— Unë them të ndeshen edhe një herë, — foli me zë të lartë Zyferi.

Ai digjej për fitoren e Shahinit. Ashtu u bë. Ku prishte qejf i deleguari!

Shahini u betua me vete të mos ia lëshonte më qafën. Kujtonte sa e sa kundërshtarë kishte palosur në fshat, në mal e në meratë ku dimëronte bagëtitë. Në shumë raste fitoren e kishte siguruar te kthesa e menjëhershme, së cilës ia kishte marrë dorën. Provoi dhe me të deleguarin, po nuk i eci. Nuk rrëkëllehej kollaj ai. Edhe përdorimi i stërkëmbësit nuk i solli gjë. «Të paktën të binim gomaçaz» mendonte Shahini. Sekondat e minutat po kalonin mes një barazimi forcash. Shahini bëri përpjekjen e fundit. Shtrëngoi krahët, duart e dhëmbët, për të marrë forca, hapi pak këmbët e bëri një anim të rëndë nga e majta dhe rrengun mendoj t'ia bënte nga e djathta. Mirëpo tamam atë çast ndjeu një shtrëngim të fortë, sa po i merrej fryma. Këmbët sepse iu ngritën në hava. Malet përreth u rrotulluan e u rrotulluan e pastaj ndaluan. Kur liroi duart, Shahini u gjend me kurriz mbi bar. Kundërshtari përsipër po i merrte frymën. Ashtu, shtrirë, sepse i shkuan sytë te polici i lokalitetit: Ai rrinte më këmbë e pushkën e gjatë nuk e hiqte nga krahu. Kur e plandosi rrafsh me sheshin, kundërshtari liroi duart dhe u ngrit duke u shkundur. Përsëri duartrokitje e urra.

Pa u ngritur ende i munduri, polici i lokalitetit e zbrazi tri herë pushkën e gjatë, me urdhër të kryetar Hajros. Këto të shtëna njoftuan se edhe anëtari i fundit hyri në kooperativë. Më pas njerëzia u njoh me statutin e rregulloren, u bënë edhe zgjedhjet.

— Na urdhëroni nga shtëpia, kështu siç jeni, — tha Shahini duke u drejtuar nga i deleguari, kur përfundoi mbledhja. Sa ishin përreth, shikonin njëri-tjetrin.

— Të falemi nderit! Këta shokët le të vijnë, se unë...

— Shokët këtu i kam. Sonte të dua ty në shtëpi, — këmbënguli Shahini.

— Mos ke qejf të ndesheni dhe në raki? — ngacmoi Hajroja.

— Ndeshjen e bëme njëherë.

— A, a, a! Sot ra në usta Shahini! — foli jo pa gjemba Jahoja.

— Shahinin e paskeni të fortë, — nisi të flasë i deleguari. I rrahu krahët kundërshtarit dhe vazhdoi: — Unë do të vija me qejf, po duhet të kthehem shpejt në qytet, se mbasdite i bëj stërvitje ekipit të mundjes. Sivjet jemi në kategorinë e parë dhe na duhet shumë punë.

Shahini në fillim shqeu sytë. Buzëqeshi hidhur, u vrenjt në fytyrë dhe iu kthye Hajros.

— Ky qe i deleguari?

— Pse, më të mirë e doje ti? — ia ktheu Hajroja duke qeshur.

— Atëherë, ma bëre me hile. Të pjell gjithnjë kungulli që mban mbi supe, — i foli Shahini Hajros.

— Pse, sportistët nuk shkojnë të deleguar? — ia ktheu ai.

* * *

— Hë! Si do të bësh? Jepe fjalën, — e nxi-
ste Zyferi. — Mos i lërë miqtë varur duke pritur
ditë e natë përgjigjen tënde.

— Salushe! — iu drejtua Hajroja së shoqes
së Shahinit, që kaloi aty afër. — Ik në shtëpi e
shtro velenxat, qilimat e batanijet më të mira,
se sot Shahini do të rroket me krushkun e ri.

E shoqja ia nguli sytë Shahinit dhe po priste
urdhër nga ai. Fytyra e saj rrëfente një gëzim
të singertë.

— Po, po, — tha Shahini, — do ndeshemi,
po s'di ç'të bëj, ta lë krushkun të më mundë, që
t'i bëhet qejfi, apo ta fitoj vetë? Ma ndani dot
këtë mendje?

ME LEJE?!

Në fshatin tonë janë pesë Jaçe, por ai i
Japarakëve dallon mbi të tjerët. Burrë shtatgjatë,
i drejtë, i mbushur e me shëndetin grurë. Me-
gjithëse mban mbi kurriz mbi një gjysmë she-
kulli, moshën nuk e tregon. Jaçja nuk prashit
kurrë para vetes dhe di t'i vërë mirë jastëk fja-
lës. Kur merrte rrugën jashtë fshatit, dilte i rre-
gullt, i pastër, qimja nuk i ngjitej në trup. Se
Jaçja ynë, ç'është e vërteta, del shpesh. Jo se
është nga ata që korren ku nuk mbillen, po ja,
ka qejf të njohë e të njihet. Dhe kudo që shkonte,
e gjente muhabetin në gju dhe më tej do ta çonte

gajtan. Sapo ulej e uronte në sofër të mikut, çdo gjë përreth i dukej se ndriçonte.

Po ziafeti do edhe shokë e ai me ca përpjekje gjeti dhe dy të tjerë po nga fshati ynë. Kësisoj, të tre, çdo vit përmbysnin shishe e domixhana me raki në fshatrat fqinjë, Brinjas, Fikas e Thërmias, se atë kohë në fshatin tonë rrushi e frutat vazhdonin të bëheshin reçel, pekmez e rehani, sipas traditës. Kur u fut rakia, shumë vetë thanë «ku paskemi qenë», «kemi humbur kohën kot», «rakia qenka bota». Doemos në këtë fushë Jaçja kishte dhënë ndihmesën e vet si usta i rakisë që pati pirë me opingë e me kutinë e duhanit buzë për buzë.

Për të pirë e për gostira Jaçja të nderonte, qe kripa e muhabetit, lezeti i tryezës. Pak nga pak ai kishte arritur të përpunonte një kod të tij dhe ta kishte ënda ta dëgjoje. Gjumi i dilte vonë e, kur nisej në punë, hapte gojën çark, ndërsa sytë i kthente nga qielli, sa hidhte kazmën e shatit e parë. «Njeriu, more i dashur, dhe katërqind copa të bëhet, nuk i kryen dot të gjitha. Ta zëmë, u nis mik. Po pse, kollaj të duket? Duhet ta ngasësh gotën dhe bisedën, t'ua dish sërën mezeve e bukës e këngës, ehu, sa ka zanati!

Për punë miku e miqësie ai nuk i peshonte arrat pa i shkundur. Atë mëngjes e pati stisur të shkonte deri në Fikas, në gostinë e Sami Qepujkës. Pa sosur mirë mendimin, në derë u dha e bija, Selimeja. I ati i hodhi një sy nga koka te thonjtë e këmbës. «Sa shpejt u rrit shejtania. Do m'i sjellë një palë miq ndonjë ditë», mendoi aty për aty Jaçja. Në dorë mbante një fletushkë, tamam si ftesë dasme. Sytë i xixëlluan si të ma-

çokut në errësirë dhe nga emocioni nuk po fliste dot. E bija iu bind shenjës së tij. Ftesë dasme, fejese apo gosti për ndonjë gëzim?

Ajo nuk vinte as nga Fikasi, Thürmiasi apo Brinjasi a ndonjë fshat tjetër, ku Jaçja kishte rrethin e miqësisë e të shoqërisë. Sa e mori në dorë, gëzimi iu pre dhe ai filloi të kruante kokën. Qe një thirrje e organizatës së frontit për fushatën e korrjes së grurit.

— Për kë ta dhanë këtë? — e pycti të bijën.

— Po për ty, o babi... — ia ktheu ajo.

Kur bisedohej për të zgjedhur Agimin kryetar kooperative, në fshat zienin fjalë nga më të ndryshmet. Dhe kandari i mendimeve luhatej vazhdimisht sa poshtë lart. Në sherrin që u hap për këtë punë, Jaçja nuk mori pjesë. Në kësi rastesh, siç thoshte ai, është më mirë të blesh sesa të she-sësh dhe njeriu i zgjuar e mban gjuhën me dhëmbë. Dhe sa mirë që nuk e prishi gojën, se vërtet atë zgjodhën kryetar. Agimi filloi t'u vinte hakut atyre të blegtorisë që ishin mësuar të livadhisnin pas qejfit. Ndaluan therjet e sforcuara dhe thyerjet e këmbëve të bagëtisë të shtunave, siç ishte bërë zakon, fshehjet e pjelljeve binjake, shtimi i qumështit me metodën klasike një nga dhia e dy nga vija. Deri këtu Jaçja tha: «I lumtë. Tani na erdhi kryetari që na duhej.» Po kur kryesia mendoi t'i ndërronte klimën brigadier Shahinit, fytyra e Jaçes u pezmatua seriozisht, se s'i besohej të gjente burrë tjetër aq bujar, sa për çdo gjysmë litre raki që i sillte nga gostitë, t'i falte si shpërblim nga një ditë e gjysmë pune. Gjen brigadier tjetër t'i kuptojë vuajtjet e dollibashit aq mirë? Brigadieri i ri nuk lëshonte pa gjëkund,

se nuk e dinte lezetin e rakisë. Jaçes s'i mbeti shteg tjetër vecse të përpiqte pallën me brigadierin. Dhe fushë beteje u bë një arë me misër hamullor, ku bëhej edhe analiza e brigadës.

«Me leje...!? — foli Jacia atëherë. Pastaj bëri një nga ato hvriet që dinte ai për të kapur fillin e diskutimit e më pas u hodh dreitnëdrejt te dhëmballa e prishur. Edhe pse thika i priste vetëm në niërën anë, kusur nuk la. Brigada do vot. do organizim. kontroll. ulërinte ai. Brigadier i ri u bë prush në fyturë. Me brigadierët ose duhej ta mbaie grurë, ose, kur të picej situata, t'ua vije kokën në gërshërë. Le të shihte dhe krvetari se atij nuk i mungonte guximi për të kritikuar të metat.

Kur i futesh një punë, duhet këmbëngulje dhe Jacia nuk e nga ata që prapësohej.

— Me leje...!? Si mendoni ju, shokë, i merr dot pesëdhjetë ditë punë në muaj Rakoja, që është dyzet kile burrë? Unë kam munguar, dhe ky më ngjini me ditë punë. Posi, ore, nosi! Pse, more shokë, kështu lëshohen ditët e punës? — gjëmoi Jacia.

U ngritën më pas shokët dhe i thanë se mos e ngatërronte me brigadier Shahinin. Ai e bëri veshin të shurdhër.

— Me leje...!? — u dëgjua zëri i tij kur po analizoheshin dy letra anonime, nër sqarimin e të cilave kishte ardhur edhe një shok nga rrethi. — Ju të qendrës jeni vetë të menciëm. Problemet janë këto që thuhet në letra. S'dihet kush i ka shkruar, kush nuk i ka shkruar, — e la si të turbullt Jacia.

— Me leje...!? — foli me zë të qartë,

të fortë e melodioz, kur u bë edhe analiza e punës për tufëzat e arëzat. Edhe pse i thanë se po kërkonte qimen në perpeq, se fajin e kishte gjithë brigada, ku që dhe ai brenda, Jaçja nuk ra më



kurriz. Edhe kur u analizua problemi i disipli-
nës, nuk mbeti pa folur. Të gjitha shtigjet e fja-
lës së tij të nxirrnin te puna e dobët e brigadierit.

*

*

*

Letra si ftesë dasme nuk e grishte të ngrinte
dolli me pesë shëndete. Ajo i thoshte të bëhej gati
për të korrur me krahë të lehtë plot pesë dynymë
grurë. «Ja, kjo nuk më pati shkuar në mendje!»
vazhdonte të bluante me të tijën. «Të korr unë
pesë dynymë grurë! Pesë dynymë nuk i kam korr-
ur gjithsej që kur erdha nga ushria e deri sot.
Dhe për dhjetë ditë, pale! . . . »

Sikleti që e zuri tani papritur, e nervozoi.
Filloi të lëvizte nga qoshja në qoshe. U mërzit,
sa po u rrinte njerëzve të tij me një pëllëmbë
hundë. Nuk guxonte njeri t'i fliste. Kjo gjendje
vazhdoi ndonjë orë. Papritur u çel, qeshi vesh
më vesh e tundi kokën. Dukej se, për fatin e mirë
të shtëpisë, i kishte qëndruar miza mbi rigon.

Të nesërmen, kur ra çanga e alarmit, aty
rrotull orës tre Jaçja ynë u hodh në këmbë, u
rrua taze, u dezinfektua me raki të fortë mani,
u vesh e u pispillos dhe doli nga shtëpia. Kështu,
pa zënë ende agimi majat e maleve, në vagullim
të ditës së re, ai kaloi Qafën e Thërrmuar dhe theri
tutje nahijes. Se çfarë bëri andej, ajo është punë e
tij. Nja dy ditë thanë se ishte dukur në Fikas.
Të tjerë i binin hasha, thoshin se ishte në Thër-
mias. Xha Bejkushi betohej për kokën e nipave e
mbesave se e kishte parë Jaçe Japarakun në Brinjas,

duke shirë grurë me një makinë «Tomorrica». «E njoha menjëherë. I thira, po nuk erdhi. M'u fsheh pas kavaletave», betohej e përgjërohej xha Bejkushi.

Kur erdhi në fshat Jaçja, gruri ishte korrur. Nuk po u zinte besë syve. Aty më parë gruri korrej deri në gusht.

E njoftuan me firmë të vinte edhe në mbledhjen e brigadës. «Dhe mblidh mendtë e jepu xhevap njerëzisë», i foli e shoqja. «Hesapin ia jap vetes» foli burrërisht Jaçja.

— Me leje...!? — u dëgjua një zë i fortë. Jaçes ia bëri zemra tëng, se këtë hyrje e përdorte vetë. — Të na thotë Jaçja, ku ka qenë këto ditë? — pyeti folësi.

— Me leje...!? Unë nuk merakosem ku ka qenë, po kush ia korri ato pesë dynymët që i caktoi Fronti? — i zuri frymën një i ri. Jaçes iu tha pështyma në gojë. Mali i Komjanit iu duk se po lëvizte nga vendi.

— Me leje...!? — foli xha Bejkushi. — Mos e mundoni kot! Po të mos kishte qenë ai në shirje, Brinjasi nuk do ta rrokte planin sivjet. Si luan ka punuar atie. Ka ardhur dhe një letër këtu në fshat. — përfundoi buzagaz diskutanti. Ai kishte hall të vërtetonte se ato që kishte parë e folur para njerëzisë, ishin të sakta.

— Me leje...!? — foli një tjetër. Si u ngrit më këmbë, nuk po ngutej për të folur. Mori frymë thellë, përëndoi sytë e pastaj vazhdoi: — Po pse duhej të punonte andej e jo këtej, Pse, pak makina shirëse kemi këtu?

— Me leje...!? Unë them që kavaletat tek Arat e Cjapit t'i shijë Jaçja. E vendosim në grykë

të makinës dy turne bashkë, — foli një tjetër.

— Me leje...!? — u dëgjua një zë. — Shkopi që bëhet i gjithë helaq, nuk ke ku e zë, ndaj duhet shpëlarë i gjithë...

— Me leje...!? Me leje...!? — dëgjonte zëra të fortë e të dobët, sikur vinin nga fundi i një pusi, edhe kur brigadieri me dy shokë e ngritën nga kashta.

— Me leje? — i tha edhe mamia e fshatit duke i rrasur në hundë një shuk pambuku ngjyer me amoniak, për ta sjellë në vete.



Ç'KE, O REXHO, QË RËNKON?...

Rexho Shereti atë buzëmbremje erdhi rrotull kopshtit që kishte pranë shtëpisë e pastaj u

ul në një stol të sajuar prej dërrase, një anë e të cilit ishte mbërthyer në kërcurin e manit të moçëm. «Të jetë ky man më i vjetër se mbiemri im?» i vetëtiu aty për aty një mendim. Pastaj ngriti sytë lart dhe u çudit kur pa se frutat e tij për dy-tre ditë mund të piqeshin. Behari kishte shkelur shumë shpejt. Rexhua bënte ç'bënte dhe thithte tymin e duhanit që digjej dalëngadalë në çibukun prej bushi në formë çizmeje.

— U nda nga tufa dhe mori poshtë, nga shtëpia e Sherretit, — u dëgjua një zë i hollë dhe i kthjellët. Ishte bariu i lopëve të lagjes që po i përgjigjej dikujt.

«Hë, të ka faj! Nga shtëpia e Sherretit thotë edhe lopari i lagjes. Jo, or jo! Nuk të lënë të qetë. Ja, shtëpinë e kam plot, me radio e televizor, asgjë s'më mungon, po ç'e do! Nuk po i gëzohej si duhet. Se ç'më gërmic një lëmsh këtu përbrenda, e si një maçok i tërbuar po më zë frymën. Sherrtari njëri, Sherreti tjetri. Fillon dita me Sherrtari e ngryset me Sherrtari. Edhe bariu i lopëve, pale! Jo. Kjo nuk durohet. Duhet ndërruar e sikterisur ky djall mbiemër. Se dhe nuk tingëllon mirë, more vëlla. Fjala, po nuk të mbushi gojën kur e flet dhe veshin kur e dëgjon, nuk përfillet, nuk zë vend. Ti je në kulmin e seriozitetit, duke folur faqe njerëzisë, ta zëmë. Mjafton të dëgjosh «siç e tha edhe Sherreti, mirë e ka sot ky Sherreti, ose «Sherreti ynë sot nxori mjaltë nga goja», e çdo gjë zhvlerësohet.

Krisi kanati i portës së jashtme. Rexhua u përmend. E shoqja i tha se darka ishte gati, por ai nuk luajti nga vendi.

— Ç'ke që mendohesh? — e pyet ajo. —

Ç'të ka gjetur?

— Po më shqetëson ky mbiemri. Nuk durohet.

— Unë nuk ta solla me vete, — u përgjigj ajo pak si me të qeshur.

— Si mund ta shkul këtë rënxallë të keqe? Mund ta ndërrosh me gjyq, më kanë thënë, po nuk bën dobi, se fshati do të më thërresë njësoj si më përpara.

— Ai që e ka trupin të drejtë, nuk merakoset se i del hija e shtrembër, thoshte im atë, more burrë, — foli e shoqja duke hyrë në shtëpi.

— Unë them të gjejmë një mbiemër të ri, të pëlqyer... Babaxhani, për shembull, si të duket ty? Dhe pastaj një darkë të madhe, një gosti ku të thërresim tërë fshatin.

*

*

*

Njerëzit, në konak, ishin ulur sipas radhës që kishte caktuar i zoti i shtëpisë. Kur i mbushën gotat plot, Rexhua rrëmbeu të tijën dhe i uroi njerëzit kokë më kokë.

— Për gëzime të tilla ju ardhsha! — uroi ai duke e kthyer gotën me fund që t'u hapte rrugë. Njerëzit panë njëri-tjetrin si të çuditur. Nga shikimet e gjestet dukej sikur pyesnin: «Nuk gjeti fjalë tjetër ky»? Në raki ndoqën shembullin e të zotit të shtëpisë. Si u përcollën të gjithë e po merrnin frymë lirisht, foli Banushi.

— Po ruajte raste të tilla, zor të piqemi këtë shekull në ndonjë gosti, — ngriti zërin ai.

— Pikës i ke rënë, Banush. Nga fshati ynë

nuk e ka ndërruar njeri mbiemrin, — ia priti Bektashi.

— Mos flisni kështu kaq të sigurt, shokë! Nuk i dihet. Ja, u mërzit robi me të dhe kërkon ta heqë qafe, — e mori fjalën Zenuni. Vërtet, të tre që folën, ishin të rinj. mustaqja sapo dirsur, ama fjala u dëgjohej. Pas tyre, me gotën në dorë, u ngrit Zakja.

— E dini, more shokë, se për urim sot me zor i gjetkam fjalët? Dhe kush? Unë që kam krvesuar krushqitë në kushedi sa dasma. — Ai u drejtua sa nga Rexhua, sa nga nierëzia. Puliti sytë, ngriti më lart të djathtën me gjithë gotë dhe uroi:

— Rexhos t'i vimë për gëzime. Sebepe si ky i sotmi në fshat nuk kemi pasur. Kanë të drejtë të rinjtë. Po këtë të sotmin, ama them ta festojmë mirë. Qeni i kallajxhiut të lozë. Apo jo, çuna?

— Kalit i ka hiie shala, burrit i ka hije fjala, thuhei për të në fshatin tonë.

— Ohuuu! Tym, ore, tym do ta bëjmë! — pati zëra.

— Do ta diegim fare!

— Se janë dy sebepe bashkë, e nuk i thonë shaka, — tha Bektashi. Disa ngritën krvet. Një pjesë mendoheshin, të tierë vështronin Rexhon.

— Unë një sebeb kam, — tha i zoti i shtëpisë. — Unë kam thënë, more shokë e miq, dhe po e përsëriti pravë: Sot festoj me iu mbiemrin e ri, Babaxhani. Hajde, gëzuar! — uroi ai duke nxitur edhe të tierët të pasonin.

— Që thashë se janë dy sebepe, nuk fola kot, — vazhdoi me të tijën Bektashi. — Cilat janë,

do të thoni ju? Sebepe i parë është ndarja me mbiemrin Sherreti. Pse, shokë! Të lehtë e ka Rexhua ynë të ndahet nga ai mbiemër! Nuk e paskemi të lehtë ne, jo i zoti i shtëpisë. Po e ka mbajtur tërë jetën, more! Me atë ka lindur, me atë është rritur, është martuar.

— Drejt e ka Bektashi, — u hodh një i moshuar.

— Jo, jo! Unë një sebeb kam, — nguli këmbë Rexhua. Përsëri qetësi. Dëgjohej vetëm zhurma e ndonjë piruni të vetmuar.

— Hambarplot e sytë me lot mbete, o derëbardhë. Po mirë të thonë. Ndahu njëherë paq me mbiemrin që kishe. Tjetri kollaj është. Këtu jemi. Apo nuk ke qejf të na mbledhësh përsëri! — tha Banushi duke u lëpirë. Qeshën të gjithë. Uruan përsëri njëri-tjetrin dhe gotave të rakisë u doli fundi.

Ngadalë e ngadalë fjalët shtoheshin, rakia e mezet po pakësoheshin. Rexhua nuk priti më. Rrëmben gotën e filloi dollinë. Pi raki e këndo. Ia thoshte i zoti i shtëpisë, ia prisnin shokët. Pesë shëndete e një këngë u vendos rregull i asaj nate. Ende hesapi nuk ishte ndarë. Përcillnin mbiemrin e vjetër e uronin ardhjen e Babaxhanit të ri. Dhe Rexhua vazhdonte me sukses dollinë. Njeriu, kur pi, ndien më shumë siguri. Pa flet serbes e me kompetencë. Edhe ai që pa pirë belbëzon, aty bëhet bilbil.

— Ky mbiemri im biçim nofke do të ketë mbetur, se nuk e kemi pasur hak. Ndonjë budalla e lëshoi kot, ose për inat, dhe të tjerët e mbajtën në gojë. Dhe kësisoj u përtyp deri në ditët tona. Po sot, ama, ma mori të keqen, — foli Rexhua

dhe gotën nuk e lëshoi nga dora. Më pas ua bëri «bromp» të gjithëve, se edhe mezet taze sapo kishin mbushur sërish tryezën.

— Cilin ke lënë pa thirrur në këtë ziafet, o Rexho? — pyeti qetë-qetë Zakja. Ai vetë ishte nga lagjja e sipërme e fshatit.

— Ç'është ajo fjalë? Të gjithë i kam thirrur. Burrë për derë, me gojë e me plloskë.

— E di ku ta pata fjalën? — ia pret Zakja. — Cili nga prindët tanë, gjysh stërgjysh ishte budallai që tha nofkën i pari dhe cilët ishin budallenjtë që e mbajtën në gojë? — Konaku nuk pipëtinte, pritej përgjigje. Rexhua luajti nga vendi po pastaj u kujtua që ai ishte zoti i konakut dhe i tryezës.

«Në vend të nxehem unë e t'u kërkoj hesap, po nxehet Zakja. Mirë e ka! I lumtë! Kur e mbajta kaq gjatë mbi kurriz unë!»

— Konkretisht, ku e ke ankimin? — ndërhyri Bektashi me sy gjysmë të mbyllur. — Duam budallanë ne...

— Po, ai që i tha i pari, budalla ka qenë. Bile kaluar budallait. Ai... — deshi të vazhdonte i zoti i shtëpisë, po nuk e lanë.

— Unë them mos e quajmë budalla. Le që nuk e dimë cili ka qenë. E dyta, kur fliste fjalë budallenjsh, pse zuri vend dhe nuk e shkuli as yt gjysh as yt atë? Tani dole ti më i fortë! Na, more! — foli Qemali..

— Dihen ato, shoku Qemal, dihen. Im gjysh u përpoq, po nuk arriti...

E mori prapë fjalën Zakja.

— Njëherë e një kohë dhe yt gjysh ngriti një ziafet të madh për të ndërruar llogarin. Ftoi

të gjithë fshatarët. Po nuk e la me kaq. Në krye të konakut vuri bejlerët e Këmbëlugës dhe i sajdisi si jo më mirë. «Neve na rruat mehrabaja, se bakllavatë i ha dynjaja», thanë fshatarët tanë atëherë. Vajti një sherr e shamata që nuk ishte parë gjëkund. Ku kulloste dot beu me harbutnë. «Kur të shohësh qyqe të kuqe, kalë jeshil dhe bej me mend, do të ndërrohet llagapi yt», i thanë fshatarët atëherë tët gjyshi. Dhe vërtet, ai s'arriti gjë tjetër veçse të shtonte një bisht nga Sherri në Sherreti.

Ngjyrat në fytyrën e të zotit të shtëpisë u ndërruan disa herë, nga e kuqja në të verdhë e nga e verdha në të kuqe. Si krojti me forcë majën e hundës, ai u mbush thellë me frymë, foli gjithë duf.

— Që ma ka me inat Bektashi, këtë e dija. Po që të njëjtën mendje paskësh edhe Zakja me Qemalin, këtë e mësova sonte, — foli me zë të lartë Rexhua. Në konak ra qetësi e madhe. Më tej i zoti i shtëpisë vazhdoi... — Se iu nuk e dini që para tre vjetësh këtij Qemali që shihni këtu, i kam bërë procesverbale. Pa u gjykua dhe u dënua me gjobë. Atë inat mban ky...

— Këtë e dimë. Unë e kam gjykuar çështjen. Qemali mund të ketë shumë të meta, po inat nuk mban. Po të ishte ashtu, as me mua nuk do të fliste, — tha Fatmiri që ishte ndihmësgjyqtar.

— Po me mua, ç'të kruhet kurrizi? — mori zjarr Bektashi. — E çfarë inat paskam unë me ty? — Sytë dhe fytyra kuqaloshë i xixëllonin nga rakia dhe tregonin se ishte gati t'i thoshte sherrit «lepe».

— Ngaqë bleva televizor para teje, — ia pati të ngrohtë përgjigjen i zoti i shtëpisë.

Gjendja tani nuk po i ngjante aspak asaj të fillimit. Njëri e hidhte e tjetri e priste. Zakja kujtonte grindjen në dasmën e Asimesë, zënkën në gostinë e Aliut dhe sherrin në mbledhjen e fshatit për dëmet në bujqësi. «E ky Rexhua, gjynah mos qoftë, kudo e nxirrte kokën nga pak», mendonte Zakja. Sa herë ndodhte ndonjë zënkë e rrëmujë te dyqani, njerëzia pyesnin: «A ishte Rexhua aty?»... «Epo, qenkeni kënaqur!», shtonin pastaj, kur merrnin vesh se Sherreti ishte ndodhur në krye të detyrës. Zakja, njëherë, e mori mënjanë dhe e këshilloi të ishte më i përmbajtur.

— Kur më pëlqejnë hudhurat mua, s'kam gjale se të djegin ty», i ishte përgjigjur Rexhua. Që atëherë marrëdhëniet e tyre mbetën të ftohta.

Tani tërë konaku dhe muhabeti i ngjanin lojës së turasë. Në mes të kësaj loje ndodhej i zoti i shtëpisë. Edhe pse po i kërciste kurrizi nga shamia në formë topuzi, që luhet në lojën e turasë, ai nuk po kapte fillin që i duhej. Vetëm djali i dajës së Rexhos dukej se deri tani ishte jashtë kësaj loje. Ai kishte ardhur që nga Shtyllasi për të marrë pjesë në gosti.

— Ore Rexho! — u dëgjua zëri i tij. — Nuk kam pjekurinë e moshës sate, po një gjë e di. Nuk bën kështu njeriu në shtëpinë e tij. Na turpërove... — ai deshi të shtonte edhe diçka tjetër, po Rexhua ia preu:

— Në shtëpinë time jam, në fund të fundit. I mblodha sonte këtu dhe do t'ua numëroj të gjitha, — filloi të ngrinte zërin i zoti i shtëpisë. — Pastaj, o çun, a nuk jam dhe unë nip i Shame-tit? A nuk jam unë nip i tyt eti? Fol, more, të

folçin në rrëzë të veshit, — vazhdoi ai dhe sytë nuk po ia ndante djalit të dajës.

— Meqë e do, po ta them, — ia pati flakë për flakë djali i dajës. — E pyetën njëherë mushkën: cilin ke baba? Kam dajë kalin, tha. Sonte, kështu po e bën edhe zotrote...

I zoti i shtëpisë u bë dem i tërbuar. Nuk i mbahej pusia gjëkund. Nuk pushoi as kur i erdhi pranë e shoqja, shpirt njeriu. Pesë fjalë në një donte t'i nxirrte prej goje. Mbushej me frymë sa mund të pëlciste. Dhe qe e pamundur ta zbrisnin nga fiku. Njerëzia nuk po ia ndanin sytë e s'dinin ç'të bënin. Zakja nuk priti më. U ngrit më këmbë.

— Dëgjoni, more shokë! Dhe ti, ore Rexho! Të mirit, ka thënë ai i lashti, i tepron edhe gjysma e mendjes. Të ligut nuk i mjafton as ajo që ka. Shtati boçke e mendja loçke, mbete o Sherret... Çohuni, more shokë, se u bëmë vonë.

Të tjerët, si duket, atë sinjal kishin pritur. Rexhua mbeti si i ngurosur. Sytë i kishin dalë jashtë qeskave dhe i dukeshin si të brumbullit.

— Natën e mirë, Sherret!

— Mbetsh me shëndet, Sherret!

— Daleni, more shokë! Çfarë bëni kështu? Ne ia pimë rakinë dhe po i shajmë katandinë, — foli Qemali.

— Ma bëfsh gjumin të ëmbël, Sherret! — vazhdoi një tjetër.

— Sherret ishte e Sherret mbeti, dëm i shkoi dhe zaifeti! — foli dikush në errësirë, dhe ky qe bishti i dytë që fitoi Rexhua në atë gosti të madhe.

PLEQËTË E FSHATIT TIM

Pa kaluar plakat me marsin allaturka, pleqëtë e fshatit tim nuk para dalin jashtë strofkave, se ia kanë frikën si të ftohtit dhe dimrit, ashtu dhe pabesisë së pranverës së hershme. Ama, sa çel gjembi e deri sa rrëzon fletët dushku, aty te mani i Fiqos i ke. Herë-herë, kur shtrëngon vapa e korrikut, ngjiten pak më lart, nën hijen e arrës së madhe pranë zdrukthtarisë. Aty hapin radion, lexojnë gazetën e lozin gurëshkronjazi.

Në fillim pyesin njëri-tjetrin për gjumin. Sa e si fjete, sa herë u ngrite. Gjumit të Yzeirit i thonë «gjumi i të drejtit». Pagjumësinë e Selfos e lidhin me gjuetinë që s'po i ecën mbarë, për shkak të zagarëve, se njërin e ka qorr e tjetrin shurdh. Pastaj, nisin shpjegimet për ilaçet, tensionin, mëlçinë e zemrën e për organe të tjera, me njohuri të sakta fiziologjike. Ndonjëri, pastaj, si me kujdes, t'han e bisedës e tjerr te zhvillimet e sotme botërore. Aq do Suloja. Nga kjo anë ai i mban veshët pipëz. Kot nuk i ka dalë dhe nami se «për problemet e politikës së jashtme të than piten.» Ç'është e vërteta, faqen e katërt e lexon vazhdimisht.

— Polakët e hungarezët i kishin shpërndarë partitë komuniste dhe do formokan parti të tjera, — foli Musai.

— A të kripsha trutë! Me mangësi mbete tërë jetën për politikën, o derëbardhë! — i kthehet Suloja. — Se mos kanë pasur ndonjëherë parti të vërteta!

— More Resul! — i drejtohet njëri ish-krye-

tarit të lokalitetit. — Pse nuk kanë duk fare këto qeveritë e komshinjve, allahile?

— Nuk më thoni, o shokëni, u bë ndonjë grusht shteti mbrëmë andej nga Amerika Latine? E kisha të prishur atë djall radio, — foli një plak i lagjes së sipërme.

— Si thua ti, Vesel? Po të ishte Taipi në Bolivi, a do t'i kalonin dot ata të drogës? — Taipi ka qenë denbabaden rojtar pyjesh. Tani ul kokën dhe qesh nën mustaqe.

— Po ai qerrata Izrael, deri kur do të vazhdojë t'i mbajë tokat e palestinezëve? — pyet e pret përgjigje një tjetër. Dhe kështu, muhabeti kafshon muhabetin, përgjigjja zë përgjigjen.

— Ah, të kishim tani një ujë të flohtë... — psherëtin ndonjëri me mllef.

— Ta mban të ngjitesh deri te stani i Cufes? Aty të pret... — ia kthen Nekja, se ai e ka gjykimin brisk e gjuhën shpatë. Po të mos jetë ai midis shokësh, shter muhabeti si uji në gusht.

— Kur u bë furra e bukës, ti, Neke, i hodhe ca shqelma, — e ngacmoi një mëngjes shoku i vet. Nekja nuk përgjigjet. Sytë i mban përdhe. Si mendohet pak, i kthehet:

— Shqelma mushke ishin ato të Asimit. Harruat ju, kur u bë kopshti e çerdhja, çfarë bëri? Nuk e çonte që nuk e çonte vajzën e vetme në kopsht!...

— Hatixhen, thuaj, more Neke, Hatixhen. Po pyete sot që e bija merr rrogë nga kopshti si edukatore? Ky duhej therur nga qafa, more... Ka qenë me një kofin koncepte... — Asimi kruan kokën, ngre kapelën prapa saj. e çon përsëri në vend. Kujton diçka e thotë:



— Se ju jo... Harruat ç'bëtë për elektrikun? S'e futim në shtëpi, e ndez shejtani... T'i tregosh këto, duhet një natë e gjatë dhjetori pranë zjarrit në oxhakun e Shahinit, me rakinë e Musait përpara...

— Po të kesh qejf, mblidhemi në oxhakun

tënd. Mos e bëj si Veseli, që u thotë të tjerëve: «Rakia e byrazerit tim nuk të zë edhe sikur një vedër të pish. Te shtëpia ime, një gotë, ta bën kokën kade!» — Veseli nuk i përgjigjet, vetëm tund kokën.

— Ah, more shokëni! Sa ka ky fshati ynë, aq të mira qofshin. T'i mbledhësh ato të gjitha, imthi e thërrimthi, ma do mendja, bluan një vit mirë e bukur mulliri i Hostenit, — u kthehet Veseli.

— Ama, kur ishim të rinj, e kemi tundur... Ju kujtohet puna me grumbullimet? — pyet Musai.

— He, more dhe ti! Punove pesë ditë dhe të duket se le nam.

— Harrove Reformën Agrare?... — hidhet Taipi.

— Po krijimin e kooperativës?

— Ti, Neke, na e drodhe atëherë, — i drejtohet Suloja si me diplomaci.

— Ke qenë arra gungë e fshatit...

— Jo, jo! Gur që thyeje çekanin...

— Ju, more shokë. keni të drejtë, — ua pret fjalën Nekja. — Keni të drejtë, se asniëri nga ju nuk ka qenë Neke as dhe një orë. Të ishit ashtu dhe të kishit mendjen time, pa llafoseshim pastaj.

— Mua më duket se atëherë punohej më shumë, — flet Veseli. Deri ditën që doli në pension ai ka qenë brigadier i arave. — Fasulet që merrnim në misër, tani s'i marrin as kur e mbjellin veç.

— Po rrushtë në pjergulla? Sa jepnin atëherë!...

— Po ftonjtë?

— Dhe sheqeri ishte më i ëmbël atëherë,
— flet Jaupi, i përmalluar.

— Mjaft, mjaft, për kokën tuaj! — u pret
fjalën në mes Nekja. — Mjaft, se e bëmë më keq
se ai derëmbylluri Belul Gjeraqina.

— Po që merrnim drithë sa për tre-katër
muaj bukë dhe kusurin e blinim nga shteti, pse
s'e përmendni? Nga balli i kopesë në blegtori
merrnim sa merr bariu i ftujave sot... Doni dhe
të tjera? — i shpoi Nekja.

Këto fakte i detyrojnë të ulen këmbëkryq
në tokë e t'i kthehen kohës së sotme.

Nga fshati ngjitet me vonesë Resuli. Ata
s'kanë kohë ta pyesin si e qysh, se ai hyn menjë-
herë në temë.

— Mbrëmë na u bë thirrje të japim kontri-
butin tonë me sa mundemi për aksionin e ndër-
timit të ujësjellësit të fshatit. Flisni! — u drejtohet
shokëve.

Ata zënë e mendohen. Ndonjëri tymos duha-
nin, tjetri ka vënë gishtat në tëmtha e duket sikur
do të thotë: «Erdhi dhe kjo ditë që ujët e malit
ta bëjmë zap e ta sjellim aty ku duam ne.»

— S'do na vuajë xhani për ujë të ftohtë.

— More, mirë, po kush do ta sjellë?

— Ne të gjithë.

— Ne jemi pleq, pensionistë, s'na vë njeri
në hesap.

— Sa të mundemi, — tha Resuli.

— Na duhet një përgjegjës.

— Ja tek kemi Sulon. Ia ka marrë dorën.

— Më mirë Musanë, — propozon një tjetër.

— Unë them Neken. Në jetën e tij nuk ka qenë kurrë përgjegjës. Pastaj, edhe çekanë e lot mirë, — propozoi një tjetër.

— Të lumtë!

— Qoftë e bërë!

— Ta gëzojë! — dëgjohen zëra.

Nekja njëherë habitet. Më pas bëhet serioz e gjoksin e nxjerr përpara. Ngrihet në këmbë.

— Bobo! Të zestë ne! Vumë karrocën përpara kuajve, — flet me gjemba Suloja.

Nekja e shikon vëngër. Në faqen e malit përkarshi duken njerëzit që po ngjiten me tuba në krahë te vepra e marrjes së ujit.

— Hajde, çuna! Forca të shkojmë dhe ne atje! A ma latë në dorë? A më zgjodhët vetë? Dhe anko-huni tani e tutje, po të doni, se nuk ju zë gjumi në darkë. . .

UA TREGOJ UNË ATYRE!

Kush shkoi në Ftonjar dhe mbeti pa një rro-zgë prapa? Asnjë. Po pate bisht, ta heqin, po s'pate, ta ngjitin. . .

Edhe mua, si zyrtar. një ditë do të më vinte radha të shkoja atje. Nuk doja të më zinin gafil e të bëhesha gazi i botës. Disa më thanë mos merakosesh shumë, se ata të Ftonjarit nuk vënë kapelën pa gjetur kokë. Po qyfyre për Ftonjarin a kishte vallë? U kënaqa kur zbulova se në Ftonjar njëri, dikur, kishte lyer shtëpinë nga jashtë me. . . salcë kosi në vend të gëlqeres. Gëzim më të madh ndjeva kur mësova se kishin dashur të ndal-

nin erën e Grykës së Çakallit. Zbulimet e reja ia njoftova gjithë gëzim edhe Latifit, mikut tim.

— Je kënaqur para kohe, byrazer! — tha pasi më dëgjoi me vëmendje e buzagaz. — Shtëpinë me salcë kosi e leu hoxha i Ftonjarit, se e ngisnin fshatarët. Gëlqere nuk kishte atëherë. «Lyeje si të themi ne dhe shtëpia jote do të dallojë nga larg. Do të duket më e mirë se sarajet e bejlerëve», i thanë ata. Dhe hoxha u bind. Mirëpo natën salcën e lëpinë qentë e macet e fshatit dhe shtëpia e hoxhës mbeti ashtu siç ishte.

— Ajo batanija për erën e Grykës së Çakallit nuk më duket e pakët. Do t'ua kyç gojën në vend, po më erdhi radha e sëra... — vazhdova më tej, kur pashë se fisheku i parë më shkoi bosh.

— Ashtu është. Në Ftonjar ka ndodhur. Batanijet e velenxat i vunë bejlerët në Grykën e Çakallit. I nxitën ftonjarakët. Rrobën e madhe e qepën dhe e vunë yzmeqarët, aty afër mbrëmjes, kur nuk frynte erë.

Të nesërmen, rrobës që do të priste murlanin e malit nuk iu gjet as nami, as nishani. «E mori era, se mungonin batanijet e velenxat e hoxhës», thanë ftonjarakët atëherë. E kuptove se me cilët ke të bësh? — më sqaroi Latifi.

*

*

*

Një ditë të bukur vjeshte më thirri në zyrë shefi dhe më tha: «Merr makinën time dhe nis drejt e në Ftonjar. Kanë një diskutim të gjerë për pronën. Qëndro ca ditë andej. Futu ca ditë

andej. Futu në debate dhe mos harro të përgatitësh një material për shokun Avdulla, zëvendëskryetarin, që do të vijë më pas për të bërë konkluzionet. . . » Dihet, urdhri i shefit nuk diskutohet. Kisha marrë me vete dhe ekonomistin e bankës bujqësore. «Në Rremas!» — i them shoferit. Ai është fshati më i largët i kooperativës së bashkuar të Ftonjarit. Mendoja se që më mirë ta zija nga anët, pastaj të përparoja drejt mesit. Kësisoj do ta kisha më lehtë.

Vrapin e lamë në arë, atje ku punohet e prodhohet. Qe koha kur vilej misri, dhe rrushi përpiqet t'ia kalojë ngjyrës së artë të gjetheve të çermëdellit e lofatës. Mendova të fillonim diskutimin që aty dhe drejt e në temë.

U fola për rritjen e forcimin e pronës, për ruajtjen e administrimin e saj. «Hemorragji të brendshme të ekonomisë» e quajta dëmtimin e saj. Dhe kjo fjali e marrë hua diku më duket se ngjiti. Disa hapnin sytë. Të tjerë qeshnin nën buzë. Ndërsa një pjesë, me sytë ulur, gërmicnin tokën me shkop. Kur s'kisha më ç'të thosha, i lashë rrugë masës. Pyetje nuk pati. Këtij fakti i dhashë rëndësi. I paskam sqaruar mirë, thashë me vete. E mori fjalën një djalë i ri. Vura re se flokët i kishte të drejtë, bojë kashte dhe fytyrën pikaloshë. Dukej sikur pjesën mbi supë e kishte të ndryshkur. «Mbarë do na shkojë», mendova, duke ia bërë me sy ekonomistit të bankës bujqësore. Diskutanti u hodh në një sulm parimor kundër shpërdorimeve, dëmtimeve e qëndrimeve të huaja. Zjarr lëshonte fjala e tij. Pastaj e mori fjalën një e re. Dhe ajo vazhdoi për rëndësinë e problemit. Dhe i treti, i katërti, po ashtu. . . Hedh sytë

nga ekonomisti i bankës bujqësore, duke ia bërë me shenjë, demek: «bukuri». Ai u vrenjt në fytyrë.

— Hë, ke ndonjë gjë për të shtuar? — i them.

— Po kritikohen veprimet, e njerzit nuk po zihen me gojë fare. Kush dëmton? Pse dëmton, çfarë dëmton?.. Të na i zbërthejnë shokët.. — ia pati njeriu i financës.

— Hë, vërtet! Këtu më qëndroni, — ndërhyra me zë të lartë.

— Do t'i zbërthejmë e t'i bëjmë fije-fije! — foli një kooperativist buzëgaz. U ndie një kor murmuritjesh. Një lopë aty afër buluriti sa mundi dhe një gomar iu përgjigj përkarshi. Prita sa u ul zhurma dhe ia ktheva atij birkos që sapo diskutoi.

— Ti, more bandill, do të bëje mirë të diskutoje konkretisht, — këmbëngula me forcë unë.

— E dashkan konkretisht! A ia themi konkretisht, more shokëni? — pyeti brigadën.

— Ouuu! Në vend, ta marrë vesh mirë, bile!

— Meqë e dashkan, thuajua! — dëgjova zëra.

— I sheh ato parcelat përtej përroit? — m'u drejtua me dorë.

— Shiko ku i kanë futur lopët. Në mes të misrit.

— Ka shumë të drejtë Yzeiri. Neve po na ngordhin kafshët në rrathët e arës, ata venë e i lëshojnë sallma në misër. Jo, shokë! Kjo nuk lejohet, — u hodh një tjetër.

Prite tani që u ndez, sa mirë do të shkojë, mendoja.

— E shikoni vetë konkretisht, — m'u drejtua

një e re. Kur mora vesh se ajo brigadë ashtu e bënte gjithnjë, më hipi gjaku në kokë. E si u dëmtoka prona kështu? Po ne, çfarë bëjmë? Çfarë qëndrim duhet mbajtur? Kishin një orë që flisnim kundër indiferentizmit. Duhej kapur momenti.

— Çohu! — i them ekonomistit të bankës bujqësore. — Çfarë pret? Kush do të vijë me ne? — pyeta masën. — Hajde! Shkunduni!..

— Atje e ke të gjithë brigadën, — më tha një e re duke më shikuar drejt në sy.

— Nuk përzihemi në punët e njëri-tjetrit, — foli një burrë.

Vrapin e lamë drejt përroit. U hodhëm përtej e me një frymë u ndodhëm në arat që po dëmtoheshin.


— Çfarë bëni kështu, ju nxefshin krahët? — u fola tërë inat njerëzve, në vend të përshëndetjes. Fola ç'më erdhi në mend. Në dhé i futa të gjallë. Gjékundi nuk i vura fre gojës.

— Ore, ti, mik, se nuk të njohim, — m'u drejtua një mesoburrë, — përtypi mirë ato fjalë e mos e lësho gojën veresie, — ma preu në kërcu.

Po me atë inat që më kishte hipur vazhdova edhe më tej.

— Pse, veç brigadave të tjera qënkeni ju? Kush ju lë kështu ju, more! — ngrita zërin në qiell, sa oshëtinte mali e shkëmbi përballë. Sokëllimat e mia me siguri dëgjoheshin deri në brigadën fqinje, ku ruajtja e pronës ishte model.

— Ku i keni futur lopët? Pse e dëmtoni misrin? — vazhdova t'ua shtrëngoja vidhat. Asnjë nuk lëvizti të nxirrte bagëtinë nga misri. Kjo më xhindosi më keq. Madje fytyrat po u çelleshin e një buzëqeshje e lehtë u lodronte në sy e buzë.



— Ne, — foli një mesoburrë, — parcelat po i kullotim sipas planit. Ti ç'ke që bërtet?

— Brigadat e tjera të Ftonjarit lënë kokën për pronën. Vetëm ju po na nxini faqen.

— Lëri ata të Ftonjarit në punën e tyre, për kokën tënde! — ma preu fjalën një i ri, biçim mendjemadhi.

— Urdhëro sonte në kryesinë e Ftonjarit dhe përgjigju, — ndërhyri në favorin tim ekonomisti i bankës bujqësore.

— Jo, kësmet qoftë, se këtu jemi në Mollas dhe foragjeret tona i dimë vetë si t'i kullandrisim... — ngriti zërin dhe të qeshurën shafran e mbante në buzë.

Po shikoja, malet, kodrat e shkëmbinjtë përreth. Hodha sytë nga kooperativistët, pastaj nga ekonomisti.

— Edhe pse i ardhur nga një rreth fqinj, ti nuk u kurseve. Na ke ndihmuar konkretisht, — foli një e re.

Ftonjarët andej matanë përroit ishin ngritur të gjithë në këmbë. Dhe qeshnin a s'qeshnin! Kështu e mbylla shërbimin tim të parë. Kot nuk thonë se dy të shkara këmbësh janë më mirë se një e shkarë gjuhe. Më kishin nxjerrë nokaut pa e ndier fare, mua dhe seksionin me gjithë shef.

*

*

*

Koha kalonte dhe kjo plagë tek unë po vinte dregëz. Ama, të them të vërtetën, përbrenda më vlonte një gulç i patreguar, aq sa me dëshirën

time nuk doja të shkelja kurrë në Ftonjar. Mirëpo një ditë shefi më hoqi mënjanë e më tha:

— Do të shoqërosh deri në Ftonjar këtë shokun e dikasterit, Baftjar quhet. Ka disa probleme për të shqyrtuar atje. Mbaroni punë dhe kthehuni, — ishte porosia më e re e tij.

Në fillim me një makinë të bonifikimit e më pas më këmbë, po i afrohemim gjithnjë e më shumë Ftonjarit.

— Më kanë thënë se këta ftonjarët janë ca qibarë, e prekan shumë lart, — nisi bisedën punonjësi i dikasterit.

— Merre si ta marrësh, — ia ktheva shkurt e të paqëruar përgjigjen.

— Le të tjerat, po paskan qejf t'i vënë në lojë njerëzit, — vazhdoi ai. Kur dëgjova këto fjalë, më dogji. Mos e ka marrë vesh ndodhinë time dhe dashka muhabet tani? Kështu më shkoi një mendje. Mirëpo, nga sa doli më vonë, ai s'dinte gjë.

— Do të rrimë nja dy-tri ditë, — foli pasi kishim bërë pak rrugë më këmbë.

— Sa të doni ju. Po e desh puna e po të keni qejf, edhe një javë, — e vura nën hijen e rignonit shokun e dikasterit.

— Na paskan bërë një letër anonime bandillët e Ftonjarit. Pa e sqaruar atë, nuk shkulem nga vendi. Mirë është të zbulojmë letërshkruesin... — Nuk m'u duk detyrë e lehtë e doja ta këshilloja të shikonte nëse problemi që ngrihej qe i vërtetë, po pastaj mendova se nuk më takonte mua t'i jepja mend shokut të dikasterit. Kësisoj, nuk i hyra në hise.

— Kam ca metoda që do t'i luaj nga fiqiri,

— vazhdoi më tej Baftjari. Pohova me kokë tepër kureshtar për thelbin e metodave që kishin të bënin me fiqirin e fshatit. Ai vazhdoi:

— Do ta kullojmë mirë punën, ë?

— Duhet pasur kujdes, — e kujtova mikun, — se këta nuk ta përtojnë.

— Kam dëgjuar, kam dëgjuar! Po këtu do jemi... Do ta marrin vesh se me kë kanë të bëjnë. Kur të më kujtojnë, flokët përpjetë si teli do t'u ngrihen. Ua tregoj unë atyre! — foli me vendosmëri shoku i digasterit. Fjala sillte fjalën dhe këmbët na çuan në qendër të Ftonjarit. I tregova zyrat, dyqanet, furrën, objektet sociale. Ende nuk dija për çfarë bënte fjalë letra e ku i rrihte çekani shokut Baftjar.

— I hedhim një sy dyqanit të tregtisë? Furnizimi i popullit është çështja më e rëndësishme sot për sot, — më tha kur po kapërcenim pragun. Shitësja e re ndërpreu punën dhe u afrua te banaku, ku kishim vënë bërrylat. Gjashtë-shtatë veta që ishin brenda, kthyen kokat nga ne.

— Hë! Po si je? Si dole me planin e xhiros muajin e kaluar? A i kënaq nga pak këta bashkëfshatarët? — ngriti zërin Baftjari sa të dëgjonin të gjithë. Pa marrë ende përgjigje, vazhdoi:

— Po aty nën banak pse mban mallra? — e sulmoi me zë të ndryshuar, ku përzihej dinakëri e siguri. Shitësja u bë lulëkuq në fytyrë. Krojti pa vetdije tëmthin, ngriti flokët dhe u mat të fliste. Mirëpo nuk arriti, se të dy u rrethuan nga ftonjarakët.

— Si mund të akuzosh tjetrin kot? — e pyeti një i ri.

— Kush jua paska dhënë këtë informatë? — e sulmoi një i moshuar.

— Ashtu mendova, — u përgjigj Baftjari duke shikuar sa nga dera e nga tavani.

— Atëherë, mos thuaj çfarë mendon, por mendo çfarë thua, të keqen xhaxhai... — e këshilloi një më plak.

— I marshi të keqen çupës sonë. E kemi të mirë, ndaj e propozuam edhe këshilltare, — tha një mesogrua.

Na mbetej të gjenim se bep e të dilnim nga dyqani. Shoku i dikasterit turfullonte nga inati.

— Ç'pate që iu sule? — e pyeta kur qe jashtë.

— Letra, — më tha, pa shtuar asnjë fjalë më tej. Këmbët po na çonin në drejtim të kryesisë.

Pa u përshëndetur mirë me kryetarin, Baftjari iu fut punës vendçe. Nuk la gjë pa kontrolluar, me plane mujore, javore apo ditore, programe apo plane masash. Tek e shihja të zhytur në punë ashtu, kujtova premtimin që më pati thënë rrugës.

Më së fundi shoku i dikasterit i ngriti sytë.

— Në tridhjetë brigadierë vctëm pesë janë shoqe. Ç'emër i vini kësaj ju, shoku kryetar? Patriarkalizëm, konservatorizëm, apo të dyja së bashku, në mos edhe ndonjë të tretë. Nënvlëftësim për femrat, për zotësitë e tyre... — Ai tani ishte hedhur në një sulm frontal për problemet e emancipimit dhe kryetari i Ftonjarit qe i detyruar të priste rrebeshet.

— Pse kaq pak brigadiere, kur forcat kryesore i keni femra? — e mbërtheu shoku i dikasterit.

— A nuk më thua, shoku Baftjar, andej nga po vjen ti, sa skuadra volejboli, basketboli e atletike keni me femra?

— Me dhjetëra, të disa kategorive. Po ju këtu...

— Jo, desha të di a keni ndonjë trajner apo përgjegjës ekipi shoqe? Unë për vete, gjer tani, nuk di as edhe një për be... po ndofta e kam gabim.

Shoku Baftiar u hutua dhe s'po gjente fjalët.

— Ne këtu në Ftonjar qenkemi më përpara nga ju, se, së paku, i kemi pesë a gjashtë, — e përfundoi diskutimin e vet kryetari.

«Këtu, kur të flasësh një herë, duhet të përcillesh dy herë», kujtova një shprehje të Latifit për Ftonjarin.

* * *

— Çudi! Asnjë nga ato problemet që ngrihen në letrën anonime nuk po më del. Jam marrë me shumë verifikime, kam gjithë atë përvojë. Do mbledhim Frontin, — tha, pasi u mundua pak.

— Pse? — e pyeta me gjysmë zëri.

— Aty do t'i kullojmë problemet, — tha shoku Baftjar.

Të nesërmen salla ku do të bëhej mbledhja e Frontit, ishte e mbushur plot e përplot. Sikletin më të madh e kishte Zikja, kryetari i Frontit. Herë hidhte sytë nga salla e herë nga tavolina ku do të rrinte presidiumi. Si numëroi me mend, iu drejtua disa të rinjve.

— Ka ca mungesa, o çuna. Ç'është kështu? Mungon Tana, Rakibeja, Neslia e Qeramudini.

— Qeramudini kishte miq, — foli një i ri.
— Shko e i thuaj të vijë me gjithë miq këtu,
— urdhëroi Zikja.

Djaloshi nuk e zgjati. U lëshua në pikë të vrapit andej nga i thanë. Shoku Baftjar nxori një letër dhe po e shikonte me kujdes të veçantë. Me sa dukej, do të qe ajo anonimja. S'vonoj shumë dhe në sallë u fut Qeramudini me gjithë miqtë nga Mollasi. Zikja i dha fjalën shokut Baftjar. Ai bëri një hyrje të shkurtër, pa letër. Pastaj, me merakun e një duhanxhiu që pi vetëm të dredhur, hapi një fletë fletoreje të palosur me katërsh dhe filloi leximin.

*Ftonjari mbeti nga fundi,
Pemë e rrush nuk ka gjëkund,
Disiplina ka rënë fare,
Ikin miq e në pazare.*

*Ju s'e dini, more aman,
Po të futesh në dyqan,
Të blesh mall për merak,
Do ta gjesh nën banak.*

*Qe të dobët si ngahera,
Ka rrezik t'i marrë era,
Dhe një ditë do shohim n'arë
Në vend të tyre të zënë gomarë.*

*Këtu e kanë në dorë
Ca kryetarë konservatorë,
Ikën nam e ikën ndere,
Ka pak shoqe brigadiere.*

*Dhe më shumë do të shihni
Në vend vetë, po të vini!*

Kur mbaroi Baftjari së lexuari a së recituari, merre si ta marrësh, sallën për një çast e pushtoi një qetësi e madhe. As miza nuk pipëtinte. Më pas nisën komentet.

— Ama, bejte qenka, jo shaka! — e zbrazi i pari një meso burrë.

— Drejt e ke, o Qani! Paska probleme ajo! — vazhdoi një tjetër.

— Pooo! Për probleme, deri aty e kthehu, — pasoi një tjetër.

— Mbaroi dhe muaji i letërsisë, ta marrë djalli. Do ta kisha recituar para popullit me talentet e reja, — foli përgjegjësi i vatrës së kulturës.

— Hë! Çfarë çuçurisni ju aty? Urdhëroni në mejdan, po deshët fjalën, — ndërhyri Zikja.

— Asnjë nga ato probleme që shkruhen aty nuk qëndron, — foli Qamili nga presidiumi.

Zikja i hodhi një shikim pak të ashpër.

— Po, po, mirë e ka Qamili, more shokë. Mua më çudit një gjë tjetër, — e mori fjalën një e re.

— Ne kemi problem ujitjen, kemi probleme ruajtjen e tokës, teleferikun. Kemi dërguar letra në rreth e në dikaster, por, ama, përgjigjja na vonon. Për letrën anonime nuk ia përtuat fare!

Si shpjegohet kjo?

— Hedh një budalla gurin në pus dhe u desh të mblidhej tërë fshati ta nxirrte, — e përfundoi diskutimin Qamili.

— Ore shokëni! Do gjetur dora, them unë, — u dëgjua një zë nga salla.

— E ç'e duam atë pulastren? — u përgjigj një tjetër.

— Si e ku ta gjejmë? — pyeti ai fytyrëndryshkuri, që kisha njohur para një viti në Rre-mas.

— Mbase na e gjen ndonjë mësues. Atij të gjuhës, them se i vjen ndorësh, — foli dikush. U bë pak zhurmë. Fjala, si duket, nuk zuri vend mirë. Shoku Baftjar vetëm shënonte në bllok. Herë pas here hidhte sytë nga diskutantët e nxiste njerëzit të thoshin hapur mendimet. Kishte për-vojë ai.

— Unë them se do ta ketë shkruar Hatja, — foli një i ri andej nga fundi. Hajde të dëgjoje pastaj ata që u ngritën në mbrojtje të pastërtisë së Hates.

— Më duket se po e bëjmë si ajo loja e kungulleshkave, me këto të uruara letra anonime! — foli një grua. — Kush e ka bërë letrën, në është burrë, të dalë këtu, në mos po e vendosim që sot e tutje të mos mblidhemi më për letra pa emër.

— Me leje? — u dëgjua një zë i trashë e jo fort i qartë. Të gjithë kthyen kokat andej. Më këmbë ishte ngritur miku i Qeramudinit nga Mollasi.

— Ti, more shok, mbaj vendin! Hallet tona i zgjidhim vetë ne, — ndërhyri njëri nga presi-diumi. Baftjari bëri me dorë të mos e ndërpriste diskutantin. Shenja e tij u zbërtheu gjuhën miqve nga Mollasi.

— Jua tregoj unë se kush e shkroi letrën, veç mos na vononi shumë, se na u ftohën mezet e turpi ju mbetet juve. Apo nuk kishte një raki

mani të fortë Qeramudini!... — Pastaj miku ndali pak, e ngau lemza, u mbush me frymë dhe vazhdoi:

— Letra ka ardhur nga Mollasi, kooperativa fqinje e rrethit tuaj. Disa herë na keni dërguar të deleguar nga rrethi juaj në Mollasin tonë. Ju ishim borxhlinj që vjet. E di ai shoku që rri afër të deleguarit kryesor...

Mua po më mbulonin djersët.

— Borxhin që kishim, jua kthyem me të rrethit e të dikasterit, — konkludoi ai shoku i Mollasit dhe vështrimin e treti tek unë.

Në fillim njerëzia u habitën, pastaj filluan të qeshnin. Të gjithëve iu kujtua ajo ngjarja ime e vitit të kaluar. S'po gjeja vend ku të fute-sha.

— Na e shlyet me kamatë kësaj here, more miq! — foli një nga salla.

— Jua pagim borxh! Do të përpiqemi t'jua kthejmë, — i siguroi kryetari. Për habinë e të deleguarit, njerëzit po shpërndaheshin.

— Konkluzionet, — bërtiti ai.

— Sa i përfunduar, — ia priti Zikja. — Kur gabon i mençuri, çuditet budallai! — e mbylli ai mbledhjen.

Kur na treguan sërish se nga lind dielli në Ftonjar, mua dhe shokut Baftjar po na bënë sytë tre e nga tre. Rrugës, tek po ktheheshin të heshtur, më tingullonin në vesh fjalët e shokut Baftjar: «Ua tregoj unë atyre.»

QENAMI

Për dosjet e kuadrove të shëndetësisë Qenami ka merak të veçantë. I merr në duar, i rrotullon, u fshin pluhurin, i pastron, i pasuron. Ja! Tani ka në dorë dosjen e doktor Zejnullahut. E ka bërë zakon, së pari t'u shkojë dorën përsipër, kanë, s'kanë pluhur mbi kapakët. I rrotullon ngadalë e, si ua gjen anën, zgjidh fiongon. Fotografia e doktorit ka dalë përgjysmë nga xhepi në anën e brendshme të kapakut të dosjes. «E, Zeno! Pse nuk m'i ndan sytë nga duart? Mos kam ndonjë sëmundje lëkure? Jo, byrazer. jo! Sa të dal në pension, nuk bëhem pacienti yt unë», i flet ai dermatologut. Pastaj vazhdon kërkimin në togun e letrave mbi tryezë. Merr njërën prej tyre dhe i drejtohet fotografisë. «Urdhëro, Zeno! Merrre, për ty është». Pastaj fillon e lexon me zë të ulët, duke imituar doktorin. «U kritikua ashpër për një qeros. Kjo është njëlloj si të shpërndash farën e hithsit me dorën tënde. Ndaj, të bëftë mirë fleta me qeros. Zeno! Si, ore si? Vetë e zbulove, vetë e mjekove? Problemin e shtrojmë ndryshe. Nuk duhej ta kishe lejuar të hynte, more xhan», fliste me vete Qenami, duke lidhur fiongon e dosjes.

Kërkimi vazhdonte. Në dorë tani mban dosjen e Zarifit, mjekut pediatër. «Hë, Zarif, si po ia kalon? Vetëm të ankohesh di ti! «Jam vetëm. Kam punë paradite e mbasdite. Kam ngarkesë të madhe, ç'bën kuadri?» Mbetë duke qarë si zog dimri.

Kuadrin mos e zër në gojë se të ha buba. Kuadri ka punë me letrat që vijnë nga poshtë. Ku është ajo jotja? Ja, e gjeta. Ai i komunikoi tërë solemnitet fotografisë: «Në dyqanin e fruta-zarzavateve është folur keq për doktorin e femijëve.» Jo, po ta marrësh vesh! Kështu është kur i ha shyta dhe i nxjerr me brirë. E mbajç me shëndet! Se, në fund të fundit, ky është fakt. Bëj punë me njerëzinë që të mos flasin keq në dyqan. «Si e lidhi fiongon dhe e vuri dosjen në vend, mori atë të përgjegjëses së qendrës shëndetësore në Arrëz.

«Tungjatjeta, Myrvete! Të lumtë! Jo, po ta dimë. Qenami shikon me syze të zeza, thonë disa. Posi, posi, bëj gabime ti dhe prit të t'i mbuloj unë». Mori letrën format dhe e lexoi për të tretën herë. «Myrvete Sevetja si 10-mujor ka zhvilluar 400 tema me kursin «Nëna dhe femija». Sikur nuk i erdhi mirë që po i dilte e dalluar. Treqind ditë, katërqind biseda. Do parë kjo punë... Mori një shënim tjetër nga tryeza.

«Nga Krekëza njoftohemi nga burime të sigurta se treguesit e sëmundshmërisë së grave shtatzëna i dha me telefon centralisti i fshatit. mbasi mamia kishte ikur në orarin e punës të mblidhte kocimare për raki. «Për raki! — ngriti zërin Qenami. Pa dale pak, si ia besove këtë informacion sekret centralistit të fshatit? Si? Nuk u bë ndonjë e keqe se problemet e sëmundshmërisë së grave i di dhe një më tepër. Po është burrë, moj derdimene, është burrë... Merr vesh ti, apo jo?

Kështu, një e nga një, letrat e shkruara gje-

tën dosjet e tyre. Ato i pranuan pa bërë zë fare. «I thonë karakteristikë! Peshoje, pa lëshojë!» thoshte Qenami sa herë i vinte radha për të diskutuar. Kandari i punonte bukuri. Mbjaj e fut letra në dosje, erdhën u frynë e u rënduan, sa nuk mbaje dot në sjetull dy së bashku.




Për të mbledhur, Qenami kishte ndodhur shatë e jo qyrek. Donte të dinte me çdo kusht çfarë ndodh në qytet, në fshat e kudo. Kush erdhi e kush iku? Ku qëndroi? Me cilin u shoqërua? Çfarë i thanë njëri-tjetrit? Ku e kaluan kohën e lirë e me se u morën? Me një fjalë, për këto punë, ai donte të dinte se ku e ka synë pleshti. Këtë zakon të vjetër nuk qe në gjendje t'ia shëronte asnjë nga mjekët që mbante në dosje.

Në klubin kryesor Qenami e kishte bërë zakon të ulej vetëm në një tavolinë, prej nga shikoje pjesën më të madhe të qytetit. Përballë, në mur, lart mozaikut me pllaka, qëndronte një tablo me qiell, det e pisha të larta si ato të Divjakës. Nga dritaret e gjera të lokalit dukej mjaft mirë fasada e komitetit dhe dritarja e shokut Llazi. Kur donte të thoshte «jam i zënë», ai hapte një kanat. Po atë ditë për fat të dy kanatat e dritares qenë hapur e kjo do të thoshte se zyra po ajrorej dhe Llazi qe i lirë. Qenami rendi te miku i vet.

— Doktor Astriti më duket se po na lë pendët, — foli Llazi. Tjetri e shikoi si i etur drejt në

sy. Tymosi cigaren dhe shikimin e hodhi përtej.
— Përsëri e kërkuan? — pyeti Qenami.



— Po, po! U ka hedhur trutë e gomarit atyre të katedrës. Nuk i ndahen. E di ç'ke ti? Pa qëndisja edhe një herë . . . U bë çuni i Harunit të na dalë shkencëtar. ! Hë, moj botë! Nuk të vjen të pëlçasësh? Krahina e Gurthatës nuk ka nxjerrë njeri të ditur deri më sot . . . — turfullonte shoku Llazi.

— Tre mel e dy grurë ia bëra atë të flamosur karakteristikë. Tani, për besë, nuk ma mban më, — foli Qenami.

Nëpunësi i komitetit u duk se i vari turinjte.

— Të ka gjetur gjë deri tani? Sa është ky gjoks këtu, s'duhet të merakosesh hiç! — i dha zemër miku i tij, «i forti i komitetit».

— Më duket se po pëshpërisin. . .

— Hë! Mbetë pulë tërë jetën. Ku do të ankohen? Në komitet. Aty ka kush të mbron. . . — e qetësoi Llazi. Qenamit, megjithatë, po i dukej se po i nginjej me pilaf me gozhdë.

*

*

*

Pa kaluar dy orë, Qenami u takua me doktor Astritin. Pasi e lau me të puthura, i futi krahun dhe morën drejtimin për në klubin kryesor të qytetit, tamam në tavolinën e tij të preferuar.

— Ç'kemi ndonjë të re? — iu drejtua doktorit duke rrufitur kafën.

Astriti nuk foli.

— Dhe bën sikur nuk di gjë, pale! Të kanë kërkuar dokumentet. Ia gjete anën, ë? Do të bësh karrierë andej nga qendra.

Doktori mblodhi buzët e supet, sikur donte të thoshte «fol edhe një herë, të bindem vërtet.»

Qenami i shkeli syrin doktorit, pastaj vazhdoi:

— Edhe një herë tjetër t'i kërkuam, mirëpo atëherë patën një farë rezerve për atë shtrimin tënd në psikiatri...

— Kam qenë shtruar në neurologji, — protestoi Astriti.

— Njëloj është. Ç'bëri në psikiatri, ç'bëri ku thua ti.

Doktori u bë gëlqere në fytyrë e po vështronte Qenamën. Me dorën e vënë në mjekër ai dalloj se thellë bebëzave të Qenamit dukej diçka si e turbullt, e ftohtë akull. Astriti ndjeu në kokë një si peshë të rëndë. Tëmthat i dhimbnin e vetullat po i rëndoheshin. Pastaj, papritur, krahu i doktorit bëri një hark në ajër, u afrua te koka e Qenamit e pastaj menjëherë dredhoi. Grushti i fortë u përplas papritmas në tavolinë. Dy gotat e ujit dhe një filxhan kafeje u përmbysën.

— Po, po! Unë qenkam ai i sëmuri psikik që mendon e shkruan ti? Si i tillë, i kam nja dy fjalë me ty, po jo sot! — foli tërë inat doktori dhe u ngrit. Klientët e kamerierët panë Qenamën të dilte prej lokalit helm e pikë.

Të nesërmen mbasdite Qenami, me gotën përpara, po zhvishte një brinjë qengji në prani të ndihmësmjekut të qendrës sanitare. Qenami,

sa herë kthente gotën, nxirrte një rënkim të lehtë. Pastaj tundi kokën dhe nisi të fliste:

— Se ti, i dashur Yzedin, nuk e di kush ia dha shtëpinë Taullait. Kush ia nanureci të drejtën e studimit për elektronikë vajzës së Mithatit. Po Saurelin e ri që mori në park çuni i Qamilit, kush e rregulloi? Hë, de! Fol, të lutem! — Yzedini dëgjonte duke kafshuar gjysmën e vezës.

— Malon, me ngarkesë për Eksimagron, e di kush e nisi? Po dokumentet e Nexhos për jashtë shtetit, e di kush u bë sebeb të marrin rrugë? Hë, i dashur! Po ti nuk di dhe disa gjëra të tjera. Kush ia dha infermiere Salushes dekoratën? Po autorizimin për televizorin me ngjyra për Seften, kush e rregulloi deri në ministri? Po kush t'i di, thuaj...

Yzedini dëgjonte, hante, pinte dhe mendonte. «Si e ka hallin ky shefi ynë sot? Nuk e kam dëgjuar kurrë këtë avaz. Nuk po e marr vesh. Në shëndetësi punon, në zyrën e punës apo në seksionin e tregtisë?»

— O i dashur Yzedin! — foli ai me gjuhë të trashur.

— Urdhëro! — përgjigjet shoku i tryezës dhe i gotës.

— Po të më sulmojnë mua në ndonjë mbledhje, nga do të mbash ti?

— Qoftë larg, shoku Qenam! Kush guxon të të sulmojë ty? — dredhon Yzedini.

— Eee! Nuk e di ti, i dashur! I janë futur me rrënjë e degë asaj punës sime. Duan të ma lënë përgjegjësinë për disa gjëra dhe kujt? Mua që kam punuar si kalë... Që kam çuar në fund çdo punë...

— Ç'është e vërteta... — e merr fjalën përsëri Yzedini, — punët që duheshin nisur nga themeli, nuk i zije me dorë, jo. Qejf të madh kishe ato punë që kishin marrë rrugë. Ato të uruara i zë dhe i bitis mirë...

— Edhe ti, more Yzedin? Harrove që unë të mora në punë? Po të mos isha unë... — Yzedini nuk e dëgjoji deri në fund, u ngrit e doli përjashta, po një farë lehtësimi e ndiente, se ia kishte zbrazur atë që mendonte prej kohësh.

Pas një jave Yzedini iu afrua portierit të spitalit dhe e pyeti:

— Si i vajti filli Qenamit?

Ai u përgjigj:

— Lëre, lëre! Ishte me nam dhe u bë për nam, derëziu. Po dorëzon dosjet. Në zyrë e ke, po qe se të ka marrë malli.

MË SH TINË NË BRAZDË

— Mos e merrni me kaq tërsëllëm, të shkretën! Jemi njerëz, bile, disi më shumë, jemi kuadro. Po kuadri ka mamuz e njeriu i gjorë ka gjak. Ja, u nxeh gjaku, ku i dihet, pastaj e dini çfarë ndodh? Lesheli bëhet...

Kur m'u duk se asnjë s'po mallëngjehej, vazhdova më tutje. Fillova t'u kujtoja atë kohë kur sapo më kishin emëruar përgjegjës blektorie.

Prill qe, më duket. Në ditë të hallit ishte katandisur gjëja e gjallë që mora në dorëzim. Mishi m'u rrëqeth kur e pashë. M'u rrotulluan plaçkat e barkut. Mirëpo çdo problem e ka një rrugëzgjidhje. I vura punës gjoksin tim qosheli dhe pas një viti çdo gjë nisi të rrokullisej për së mbari. Qumështi filloi të mbushte jo më kovat, po bidonat e kazanët. Derrave sa s'po u pëlciste lëkura nga dhjamët. Viçat shtonin nga 300 gramë deri në gjysmë kile në ditë. Bile, edhe pulat, sa më shihnin mua, nisnin të kakarisnin të gëzuara. Si u arrit kjo mrekulli? Gjysma e meritës i përket gjyshit tim të ndjerë. Ai ka qenë blegtor me nam e këtë s'e them vetëm unë. Treqind ditë rrumbullak e milte lopën. Cjepët si gomerë i bënte. Kur isha kalama e i bija maçokut me lugë, ai shpesh më thoshte: «soja bëhet nga goja». Ja, këtë porosi mbaja mend prej tij dhe më doli për hajër fjala e të ndjerit gjysh. Apo nuk më bëhej qejfi kur më lavdëronin se i kisha ngjarë. Po kur më nxorën njëherë në gazetën lokale në fotografi mes dy lopësh! Nami im tani e kishte lënë prapa gjyshin.

Nuk thonë kot: «Të ardhte nga mos e pandefsh!» Dhe mua, papritur, nga s'e pandehja më erdhi. Sebeu u bënë qetë e punës. Jo se hëngra ndonjë bri prej tyre, jo, se asnjëherë nuk e kam zakon t'u dal përballë, as nuk u ndesha me ndonjë prej tyre si toreador. Larg qoftë!

Ç'është e vërteta, qetë e punës nuk i kam pasur qejf që në krye të herës. Isha razi të mbaja

në pëllëmbë të dorës atë gjë të gjallë, që jep prodhim. Më jep, të të jap... Kurse qeve? E pse t'u shtija atyre? Bile, më dukej se kot i mbanim. Për të mjelë jo, për të qethur jo, nuk japin as vezë, as mjaltë. Atëherë ç't'i donim?! Për të punuar tokën? Se pak traktorë ka SMT-ja? Isha munduar të bindja kryetarin, t'i hiqnim fare nga inventari, po s'pata sukses, se duhej vendimi i asamblesë. Kështu rodhi viti i parë. Në pranverë plasi sherri.

— Jusuf, duam tagji për qetë e punës, —
vinin zëra nga brigadat.

— Po u arriti krahu, u shtini dhe petulla, —
ua ktheja serbes-serbes. Mirëpo më në fund
më vunë detyrë të gjeja koncentrat dhe silazh.
Përgjegjës hesapi.

Dhashë e mora duke vrarë mendjen dhe më
në fund m'u duk se ia gjeta rrugëzgjdhjen kësaj
bezdie që më kishte kapur.

«Duhet dredhur edhe këtu nga pak, se drejt-
përdrejt as derri i egër nuk ia del», më vetëtiu me-
ndimi në kokë. U kujtova se më kishte tepruar
goxha byk, prandaj ua dhashë varda. Dy javë
s'patëm gjë tjetër në garazhd veç bykut.

— Ua thave zorrët me atë bykun e grurit.
Po shtjeru dhe një dorë njomishte të uruarave,
o Jusuf! — më tha pas ca ditësh zootekniku,
kur e kishte pikasur se për kashtën nuk isha i
kursyer.

— Me të thënë e kam, se byku e kashta
forcuakan kockën e ua bëkan muskujt litar. Ndaj
kam lakmuar. Po do ta kem parasysh, o xhan,
do ta kem. — i thashë, dhe këmbët, për çudi
nga kavaleta e gjysmuar e kashtës më çuan.
Sikur s'e dija unë se edhe Fetiut s'i bëhej vonë

për qetë e punës tani që po dilte i nderuar me plainin e leshit dhe të bulmetit.

Kisha vërejtur se qetë e punës kishin një zakon të mirë. Po të mos u shtije të hanin, nuk pëllisnin. E kalonin urinë me hidhërim e inat, ndryshe nga lopët. Po t'i lije ato pa ngrënë, të ngrinin nga gjumi në mes të natës. Pale derrat dhe pulat! Për mendimin tim, edhe aq, tepër e kishin për ato 15 a 20 ditë pune që bënin në vit.

— Qetë mund të përdoren edhe për transport me qerre, slita, o Jusuf! — më tha një ditë kryetari i kooperativës, tamam sikur të kishte kuptuar mendimin tim.

— Me ato rrugë që kemi ne, duhet helikopteri, — ia ktheva me plot gojën. Ai përëndoi njëherë sytë, ndërsa vështrimin e nguli nga mali përkarshi. Pastaj, me një zë që m'u duk se i doli nga hundët, ma priti:

— Nuk është më mirë t'ia fillojmë nga qerret, o Jusuf Lifetaj? — më pyeti.

Nuk e kuptova ku ma pati atë fjalë kryetari, ndaj e shtrydha rradaken ta gjeja. Pas pak ai u nis në drejtim të arave të malit dhe vetë mbeta i pasqaruar. Me qetë e punës, kuptohet, vazhdoja avazin e vjetër. Motin e dytë u katandisën mos më keq. Dukeshin si ca zgërdalla, ku mund të shtoje njohuritë për skeletin. Edhe këmbët mezi i ndërronin kur ecnin. Vetëm brirët nuk u kishin pësuar gjë. Ata qëndronin të paepur, aty ku kishin mbirë. Behari donte kohë të vinte. Moti nuk po mbante si e doja unë.

«Po të bjerë dëborë, qetë do të na lënë shëndë», dëgjohej ndonjë zë. Më zuri dhe mua frika.

«Po sikur, larg qoftë, të fillojnë e të na lënë amanetin vërtet? Si do të vejë filli im pastaj?»

Ky ishte vetëm një moment. Sa kujtoja veterinerin e zooteknikun, ndieja një farë lehtësi-mi. Se, në fund të fundit, çdo gjë ka radhë. Pas tyre do të përgjigjesha unë. Kësisoj i kisha ombrella. E kisha provuar qysh më përpara, kur na pati ngordhur ndonjë dele a dhi. Gjendej një diagnozë dhe ne shpëtonim për mrekulli. Vetëm një lloj sëmundjeje na e pati shpuar xhepin njëherë, një farë «kaheksi». Bagëtitë që na kishin lënë shëndenë nga ajo «sëmundje», nuk do t'i harroj kurrë. E përkthyer nga latinishtja, kjo sëmundje donte të thoshte «dobësi», «ushqim i keq», kujdes i pakët. Kur e kujtoja latinishten e atyre të kontrollit, më rrëqethej mishi. Megjithëse dita kishte kohë që ishte kthyer nga behari e nata ishte shkurtuar e lehtësuar shumë, ëndrrat nuk më linin rehat. Më ngritën havadan. Njëherë m'u bë sikur qetë më kishin vënë në mes të një sheshi dhe mundoheshin të më vrisnin. Në dorë m'u ndodh një cfurk i madh dhe një beze e kuqe e një parulle për shtimin e prodhimit. U mundova ta hidhja bezen, por, për dreq, ajo më ndiqte nga pas ngado që shkoja. Pas saj vinin qetë si të tërbuar. Brirët e qimet u vetëtinin. «Çudi! — thosha me vete. — Këtyre u paskan ardhur këmbët për bukuri». Kur u shëndoshën kaq shpejt?!» U mbrojta me trimëri e mundim një copë herë. Disa raste dhe i mashtrova me bezen e cfurkun. Pastaj kau i madh i qerres, që e thërrisnin Surrak, nuk e hëngri gënjeshtren time. Ai më ra drejtpërdrejt dhe m'i ngjeshi shpatullat në sheshin me bar. I futa një të bërtitur sa munda, me shpresë të më

dëgjonte ndonjë stallier e të më vinin në ndihmë. Për çudi m'u bë si zëri i sime shoqeje, Hamidesë.

— Ngrehu, se të kërkojnë ata të kontrollit punëtor-fshatar, — më thërriste ajo, duke më tërhequr jorganin. Nuk e zgjata. Fërkova sytë mi-



rë e mirë dhe u kënaqa që kisha qenë në ëndërr.

— Hajde, Jusuf, hajde! — më ftoi me një lloj përkëdheljeje njëri prej tyre.

— Jemi të autorizuar të kontrollojmë gjendjen e qeve të punës, — shtoi më i riu e më i paduruari. Më therën mu në lug të zemrës ato fjalë. Me xhaketën në dorë e flokët e pakrehur pas përlëshjes në ëndërr, u thashë:

— Pse të mos e fillojmë nga dhentë ose lopët. . .

E dija se atje mund t'i njomnin buzët.

— Jo, jo! Një herë tjetër andej. Sot kemi ardhur për qetë, — tha njëri nga ata.

«Po, or vëlla, po, nuk ke faj ti. Edhe unë, të isha në vendin tënd, që andej do ta zija», fola me vete. Pse të lodheshin për ato punë që shkonin sahat?

Pyetjet filluan me rrebesh: Koncentrati, remonti e dokumentet e pesha, planet sipas brigadave. . .

«U pa puna, — belbëzova. — Si e kanë zënë, as për tri ditë nuk mbarojnë». Për çdo pyetje donin përgjigje. Po ku gjendeshin përgjigjet për gjithë ato pyetje, more vëlla? Unë nuk kujtoja dot se sa vjeç ishte Gastarja, lopa rekordmene e kooperativës, e jo moshën e peshën e çdo kau, ushqimin e tij! Përgjigjet sa vinte bëheshin më të vështira. Mora kthesën. «Si urdhëron, ashtu ësh-të». «Po, keni të drejtë.» «Nuk e dija kështu». «S'na e kanë thënë specialistët, pa do ta bëja», flisja duke e shpërndarë përgjegjësinë me të dy duart, sa lart, sa poshtë. Ç'u kisha thënë unë, fillim e mbarim, i kënduan në mbledhjen e zgjeruar të kryesisë, pa lënë një majë gjilpëre.

Mbajta goxha fjalë para tyre, për t'i mallëngjyer e për t'i bërë më të logjikshëm. M'u duk se ia arrita qëllimit e po i bëja për vete. Shikova njëherë përreth. Të tërë më dukej sikur shikonin me tallje e keqardhje të përzier bashkë. Vetëm Veloja më buzëqeshte si më parë. Më vinte ta push-toja atë pendar të vjetër që më kishte kuptuar aq mirë.

— Duhet futur në brazdë, — tha ai. — Ky është ilaçi më i mirë.

Kë donin të futnin në brazdë? Pas pak e mora vesh se fjalën e kishin për mua. Prandaj buzëqeshte ai djall Velo.

Po jo, nuk mund të më telendisnin kështu, se isha kuadër dhe dinjiteti i kuadrove duhet ruajtur. Kisha shumë shpresë se kryetari do ta kundërshtonte këtë masë.

Kryetari i kooperativës u ngrit, vendosi qetësinë e foli ngadalë.

— Edhe unë jam dakord me mendimin që u shfaq këtu nga disa shokë, që shokun Latif ta dërgojmë ca kohë pendar, jo për gjë tjetër, po që të shohë konkretisht rezultatit e punës së vet, si përgjegjës i blegtorisë.

Ditën e parë i bëra a nuk i bëra katër orë punë, se aty nga dreka penda ime mbeti fare. Të tjerat kishin gajatur me kohë që në mëngjes, ndaj pendarët i kishin lëshuar t'i kullotnin hergjele nëpër mezhda. Shokët e mi më vështronin tek nxitja qetë me thirrje entuziaste. Më dukej se edhe qetë gajaseshin së qeshuri me këpucët e mia.

— Jepi, o Jusuf, jepi! I thonë prill dhe kemi përpara rrumbullak dhe shtatë orë ditë. Nuk

mbahet mend kur është gdhirë. Kanë fuqi qetë e tu, se i ke ushqyer mirë, me tagji... — ndjeva zërin e Velos.

— Mos e ngitni dreqin, mos e ngitni, se as ne nuk jemi të qëruar! Kujtohemi t'i ushqejmë ditën, që i zëmë në parmendë, — ia priti tjetri. Dhe kështu mua vazhdonin të më kafshonin nga pak në vesh a ku të mundnin.

Druri që hëngra në mbledhje, nuk ishte gjë hiç para atij që po më jepnin në brigadë. Kritika e tyre qe si puna e atij shiut që bie me të butë e të qull në palcë. Apo nuk kishin kohë? Aty më kishin kur të donin. Njëri e hidhte e tjetri e prishte si t'ia donte e bardha zemër. As çerekun e ditëve të punës s'e arrita atë pranverë. Kisha dëgjuar të thoshin «të zëntë buka e kaut!», po nuk e kisha besuar, më dukej se u përkiste kohëve të kaluara.

Ah, sikur të kujtohen të më propozojnë edhe një herë përgjegjës blegtorie. Kështu ëndërroja një mëngjes herët duke kullotur qetë. Atë çast kaloi kryetari.

— Ç'thonë qetë? — më pyeti.

— Thonë se, kur të kërcet kurrizi, të vinë mendtë më shpejt! — ia ktheva unë duke i shkuar pranë.

E dija se duhanin ai e ndizte më të rrallë e kurrë nuk e pinte në mëngjes, megjithatë i zgjarta kutinë. E mori dhe u ndjeva i lehtësuar.

KONSULTIMI

Në auditor ishin të trembëdhjetë. Thonë se ky numër është ters. Patëm firo të mëdha si grup, pa arritëm këtu. Tani që po vinte fundi i vitit të dytë, mund të mbeteshim edhe më pak, se të nesërmen kishim provim.

— Mira, Beni dhe Tefta, — tha me gjysmë zëri pedagogu. Të tre u ngritën në këmbë. Shikuan një çast si të shastisur, pastaj u ulën.

— Ju të tre, — tha pedagogu me fjalë të shkoqura, — për nesër mos u bëni merak fare. Lëndën do ta merrni si buka që hahet. Po deshët, m'i jepni që tani librezat t'jua firmoj. — Si gjithmonë ishte i qetë, i përpiktë, pa shumë fjalë.

— Po ne të tjerët? — pyeti Pajtimi.

— Do t'ju jap sa të më jepni, — tha plot gojën.

— Ne nuk kërkojmë gjë tjetër, — foli me kurajë Bakushja. Shikimet tona qortuese nuk qenë plotësisht dakord me ato që nxori Bakushja nga goja.

— Ta merrni vesh ju, vetëm për tre studentë nuk kam pasur ndërhrve. Ju jeni vetë të mençëm. Kujt t'ia prish e kujt t'ia ndreq! Këta që nuk zunë njeri për xhakete, e kanë më lehtë, — e përfundoi konsultimin pedagogu ynë.

*

* *

Në auditor ra qetësi e madhe. Asnjë nuk po luante nga vendi. Dukej se diçka e rëndësishme

kishte mbetur pa u thënë. I pari filloi të rrotullohej Peroja. Ai na ishte mburrur se e kishte kaparosur lëndën prej kohësh me anë të Nashos, mik i tij dhe shok i profesorit. Qenë ndodhur të dy fare rastësisht në një ziafet andej nga Karburnara. Ishin bërë pendë e fortë. Fjala kishte sjellë fjalën dhe në dollinë e tretë, u morën vesh edhe për Peron. «Shënoje në bllok, më qafsh... E di ti...» e pati porositur Nashoja atëherë. «Pedagogu ynë kurrë nuk ua prish sevdallinjve të rakisë», kishte deklaruar Peroja duke e kapitur kapelën mbi sy.

Merita qe nga një fshat bregdetar. Te kushëriri i saj bujtte dhe pushonte në verë familja e pedagogut. Merita u qetësua vetëm atëherë kur arriti të ngrinte havadan kushëririn me gjithë bashkëshorten e tij për t'i bërë një vizitë miqësore pedagogut në shtëpi. E siguruan se përbri emrit të saj në bllok kishte dy pluse me të kuqe.

Gramozi i kishte dërguar pedagogut një person të rëndësishëm që punonte në komitet. Gazi u interesua të dinte ç'mendim kishte profesori për të. «Dobët, — tha, — dobët! Në matematikë nuk di as rregullin e treshit. Nuk nxjerr dot as rrënjën katrore». «Po ti, çfarë i the?», nuk ia ndante pyetjet Gazi. «E çfarë t'i thosha? Shtyje dhe këtë radhë. Se mos do të bëhet dentist e do të merret me nxjerrjen e rrënjëve», i thashë. Pedagogut i kishte pëlqyer humori dhe kishte buzëqeshur.

Pranë Gramozit rrinte Eqeremi. Sa herë jepeshin leksione, ai nxirrte bllokun dhe mbante shënime. «I lumtë, kështu duhet», mund të thotë secili. Po çfarë shkruante, se? Emrat e sho-

këve që përmendte rastësisht pedagogu dhe vendet ku punonin. Pastaj Eqka, kështu i thërrisnin shkurt, nuk të falte. Nëse ndonjëri arrinte të bënte pemën gjenealogjike të familjes me rrënjë e degë, Eqka ynë kishte për borxh që ta zbukuronte me gjethe e lule, deri te kushërinjtë e shtatë. Pedagogut, pastaj, i ziheshin disa lloj pritash dhe në një rën prej tyre do të gjunjëzohej. Ndjaj tani i qeshte a nuk i qeshte buza.

Stil të veçantë kishte Kiçoja. Ai i dinte çdo pedagogu rrobaqepësin që preferonte, berberin, doktorin apo këpucarin. Pedagogu shkonte të merrte kostumin e ri. Pas fjalëve të ëmbla «me shëndet», vinte porosia: «Kam atë Kiçon e Mitros atje te ti. Kujdes, ë!» Po të shpëtonte nga rrobaqepësi, nuk i ndahej berberi. Si duke shkundur pecetën e duke hequr qime edhe atje ku s'kishte, i fliste në vesh, sikur e përkëdhelte: «Kujdes Kiçon e Mitros, ë?».

Teles, studentit të grupit tonë, nuk ia bënte syri tërt gjëkund, se kishte xhaxha Ferkon që... Vitin e kaluar, kur po likujdonin pjesën e parë të lëndës, Telja nuk u paraqit fare. E humbi klasën, thamë ne. Kurse atë pasdite xhaxha Ferkoja u takua me pedagogun e lëndës te pesëmbëdhjetëkatëshi, me një listë provimi taze, me stilograf e bojë, i gatshëm për të marrë veçmas në provim Telen. Mirëpo, tamam në datën dhe orën e caktuar, ndodhi diçka e paparashikuar. Telja ia kishte mbathur për në plazh, kështu pedagogu mori në provim xhaxha Ferkon. «Mirë t'i bëhej! Le ta shikojë sa vuan i nipi», kishte thënë për këtë heroizëm të xhaxhait Telja. Xha-

xha Ferkoja e kishte marrë povimin. «Po tani si do t'ia bëj?» pyeste shokët Telja.

— Sa të kesh xhaxhanë gjallë, mos e vra mendjen...

— Jo, Salë vëllai, jo! Më duket se pedagogu e ka marrë vesh që ne e dimë të gjithë atë provimin e Ferkos dhe gjëkund nuk e afron të gjorin xhaxha.

*
* *
*

Pedagogu ynë, ç'është e vërteta, që në fillim kishte deklaruar solemnisht para nesh: «Kush më fut mik, e lashë top në vend». Disa thoshin se gjithçka varej nga gjendja e tij emocionale. Flitej se, gjasme, kur grindej me gruan, e pësonin gjithmonë tre vetë. Po t'i prishte qejfin i biri, Ksenofoni, linte dy vetë dhe, kur fitonte me Xhezon në shah, kalonin të gjithë. Mirëpo hajde e gjeje në ishte ndeshur me Xhezon apo jo. Këtë punë nuk e saktësonte dot as Kiqoja, as Eqka, që me shënimet e tyre mbushnin blloqe për miqtë e shokët e pedagogut.

Nga studentët e viteve më të larta kishim dëgjuar se pedagogut tonë i shkonin për shtat dy nofka: «Solucion i ngopur», dhe «karbon pa valenca», kuptimin e të cilave nuk arrinim ta zbërthenim të gjithë njëlloj. Këto bluanim në mendje atë paradite në konsultimin e fundit. Papritur, nga fundi i rreshtit të parë, u ngrit Festimi.

— Pedagog! Mua nuk më lë dot! — foli ai me zë të lartë.

— Asnjë nuk lë unë, djalë i mbarë. Notat negative i merrni vetë. Po pate mësuar, vërtet nuk të ngel dot, — e sqaroi pedagogu ynë me nofulla të shtrënguara.

— Edhe po nuk pata mësuar, unë do ta marr se s'bën. — vazhdoi serbes-serbes Festimi.

— Këtu ndryshon puna, — foli pedagogu. Sytë na u duk se po i perëndonte. Kështu rropatej sa herë kur i drejtohej arsenalit të kujtesës. Si duket, donte të fiksonte kush i pati ndërhyrë për të.

— A i morët të falat e Kasemit? — theu heshtjen papritur Festimi.

— Të cilit Kasem, more djalë? Pastaj, nuk ka ndonjë lidhje midis të falave që më vijjnë me okë dhe provimit të nesërm.

Festimi po bënte çmos ta fuste në temë pedagogun.

— Kasem Kulari, a ju kujtohet, profesor? — lëshoi pyetjen tjetër Festimi.

— E, pastaj?

— Kasemin e kam pasur pedagog në shkollën e mesme, — filloi të jepte shpjegim shoku ynë.

— Pedagog? Si, more, si? Kasemin pedagog? — pyeti me zë të ndryshuar, duke tundur dorën e kokën pedagogu ynë. Dukej se brenda ziente i tëri.

— Pedagog e çfarë pedagogu, se! Ai ka kohë që jep mësim në shkollën e mesme të fshatit. Nga dora e tij vetëm unë pata fatin të vija në shkollën e lartë.

— Nuk është për t'u habitur, — u dëgjua zëri i pedagogut.

Historitë e Kasem Kularit nuk kishin të so-
sur. Ato qenë trashëguar brez pas brezi dhe ki-
shin hyrë në fondin e ndodhive të rralla.

Zakonisht pedagogët mbajnë mend studen-
tët shumë të mirë me mësim, ose shumë të do-
bët. Kasemi kishte qëlluar nga këta të fundit.
Ishte byk, po byk i hollë. Tamam me pedagogun
tonë i kishte ndodhur historia që përmendej. Sa
filloi të përgjigjej, në sallë ishte futur dekani. Bi-
sedoi me pedagogun mbi gjysmë ore. Të qeshur
vesh më vesh, folën për një takim a konferencë
ndërkombëtare, ku do të merrnin pjesë të dy. Kur
dekani shkoi në punën e vet, pedagogu u kthye
te provimi.

— Ku e lamë, Kasem? — pyeti studentin të-
rë gaz e hare pas bisedës me dekanin. Kasemi
po mblidhte letrat. Me të djathtën i zgjati tezën.
Libreza e notave qëndronte para pedagogut.

— Pse gjashtë, profesor? — kishte folur Ka-
semi me një zë të çelur e pak si lutës.

— Gjashtë dhe shumë e ke, — ia kishte pre-
rë shkurt pedagogu. Pasi u vu firma, Kasemi do-
li nga provimi pa u përgjigjur fare. Kur u kuj-
tua pedagogu, qe tepër vonë. Ta thërriste më
pas, Kasemi do t'i përgjigjej: «Ti, pedagog, pyet si
ma ke me shëndet gomarin që ngordhi vjet», ndaj
e kyçi. Nota ishte vënë. Vitin tjetër nuk pique-
shin më në provime. Pedagogu e mbylli, po mba-
hej Kasemi? Më vonë pastaj studentët vunë re
se miqësia midis tyre u forcua falë disa prodhi-
meve blegtorale që vinin nga fshati. Pedagogu
nxinte, po t'ia përmendje atë ngjarje.

— Brez pas brezi shkon tradita, profesor!
— theu përsëri heshtjen Festimi.

... — Brez, pas brezi, more djalë, brez pas brezi! Rrip pas rripi, thuaj, më mirë, — ngriti zërin pedagogu ynë. Flokët i ishin ngritur si tel përpjetë, sytë i skuqnin. Dukej shumë i shqetësuar.

«Azinus azinum fricat» ka thënë latini. Të gjithë ne hapëm sytë e prisnim çfarë do të nxirrte goja e pedagogut.

— Kjo, as më shumë e as më pak, do të thotë: «gomari gomarin fërkon» e përktheu ai sentencën e lashtë tepër nervoz. Sepse na u kujtua atë çast artikulli i një gazete me titull «Më jepni një të paaftë, t'ju kthej dyzet»!

ETHET E PEMËTARISË

Sefer Shkëmbi, kryetar i kooperativës bujqësore të Kodrasit, ato ditë u ndodh shumë i zënë me punë. Se mos ka qenë ndonjëherë i lirë ai! Bujqësia ashtu e ka në çdo kohë. «Dymbëdhjetë muaj viti, trembëdhjetë fushata bujqësia», thoshte shpesh kryetari.

Nëntori i atij viti erdhi shumë shpejt. Vresh-tave u qe skuqur e rralluar fleta. Anash tyre zverdhonte si ar gjethi i lofatës e cërmëdellit. Malet sapo kishin hedhur supeve e rrasur kryeve kësulata e bardha, nga Valamarja në Tomorr e sa të hante syri përtej. Mushti, pasi pati vuar në bute, ishte platitur e po kthehej në verë, për festat e nëntorit që po afronin. Gruri qe mbjellë e tani po zinte dhenë. Vjeshta e begatshme prem-tonte për një dimër të mbarë. Të gjitha këto të

jepnin një kënaqësi të veçantë. Të lehtësonin frymëmarrjen. Njerëzit kishin ndjenjën e haresë dhe të dukej se ishin gati t'ia thoshin këngës, shkurt muhabeti, ishin gati të hapnin të dyja kanatet e zemrës.

Këtë ndjenjë kishte dhe kryetar Seferi para fillimit të mbledhjes së përgjithshme. Ai ishte një burrë i ngjeshur dërdëng e me shëndetin grurë. Kryetari i Kodrasit e ka tepër të zhvilluar shqisën e të shijuarit, nuk do ta tepronim po të thoshim se natyra e kishte pajisur me cilësinë e rrallë të shijonte edhe me shqisat e tjera, si për shembull me sy e me veshë. Kur sheh se si e përshëndetin kooperativistët, shija i ndreqet sikur ka ngrënë një pjatë me mjaltë në patretur nga bletët e malit të Gribës. Pa le kur dëgjon shkarazi bisedat midis tyre: «Nuk ka burrë më të mirë se kryetari ynë...»

Njerëzia mbushën plot e përplot sallën e madhe të shtëpisë së kulturës, si para tre vjetësh, kur Seferi u zgjodh kryetar për të parën herë. Pa erdhi dhe nga rrethi një makinë e vogël e zbritën sekretari e agronomi i pemëtarisë i rrethit. «E nisa si të vogël por më del e madhe», mendonte Seferi. Sa mirë që ka ardhur vetë sekretari. Do të na përgëzojë për rezultatet që kemi arritur në bujqësi dhe në blegtori.

Dhe raporti që mbajti kësaj radhe, asaj ane shkonte. Krahasimet silleshin herë me përqindje e herë me shifra. Pemëtarisë shoku Seferi i ra shkurt, sepse, sipas shprehjes së tij, «nuk çalon gomari nga veshët». Këto fjalë pati thënë kryetari kur miratuan raportin në kryesi.

Nisën diskutimet. Si për inat, sukseset i kalo-

nin lehtë e, sikur ta kishin bërë me fjalë, vrapin e linin ose te vreshtat, ose te pemët frutore. Dinia, i pari, ngriti problemin se pjergullat qenë plakur e se kujdesi për to kishte rënë. «E po rrojtën pa u plakën!» ia ktheu kryetari. Mirëpo shakaja nuk ndezi fare. I dyti qëlloi vreshtat. «Janë rralluar, nuk japin prodhimin e parë dhe askush s'çan kokë t'i zëvendësojë».

I treti e mori fjalën Taipi. «Ata të brigadës së pemëtarisë kanë shumë pretendime. Duam forca pune, thotë Shuaipi, duam pleh, duam kutë uji. . . Një hektar vresht, sipas tij, dashka punë sa një hektar misër. Jo ore! Le të tjerat, po dashkan patronazh për çdo rrënjë molle e çdo rrënjë arre! Pa shihni njëherë se mos duan dhe pallto të madhe a gunë natën në dimër dhe kafe aty pas mëngjesit. Mirë e ka kryetari ynë, kur thotë: «tokë u kemi dhënë, ujë, ajër e diell kanë sa të duash. Le të prodhojnë, kush i ndalon?»

Shoku Sefer ishte ngrysur si mali i Komjanit kur e rrethojnë retë. Romuzet e Taipit nuk duroheshin, por çfarë t'i bënte kur ato fjalë i kishte thënë vetë faqe brigadës? Pas tij fjalën e kërkoi Asimeja. Hajde të futeshe në gojë të saj.

«A kemi pasur më parë pemëtari, vëllezër e motra? Kemi pasur. Bukur fort. Kush merrej me të? Të gjithë. . . Tani të gjitha ia kemi lënë në kurriz brigadier Shuaipit. Dhe ai mbeti duke u ankuar. Dashka forca të reja dhe me arsim të mesëm, pale! Dashka dhe pompa, dhe ilaçe. Kërkoka dhe kafshë ngarkese dhe qerre! Jo, po mos do dhe një mur me kaçka përfund çdo blloku! — Plasi e qeshura në turmë. Asimeja vazhdoi: — Pjergullat kanë mbirë ku u ka dashur qejfi. Kush

i ndalon të mbijnë edhe sot e t'i shtrijnë rrënjët e degët nga t'u vijë më mbarë?

Fjalën e kërkoi agronomi i kooperativës, Estrefi. Kryetari i hodhi një vështrim si dackë, po, pasi këmbëu një buzëqeshje me sekretarin, ndryshoi fytyrë ngadalë. «Hej, djallo-punë! Keq të ndërhysh, keq të mos ndërhysh! Këta të rrethit sot e paskan graduar në zero», mendonte kryetari.

— Kryetari ynë, shokë, ka të drejtë, — e nisi diskutimin ai. U ndie një pëshpërimë proteste në turmë. Ai vazhdoi: — Kot kërkohmë blloqe me mollë, me dardha e më the e të thashë. — Agronomin e rrethit nuk po e mbante vendi për fjalët që po nxirrte kolegu i vet. Mani, more shokë, është më i zgjuari, vazhdonte agronomi. Pse do të thoni ju? Ai çel më vonë se të gjitha pemët dhe frutat i pjek i pari. Që këndeje ka dalë ajo fjala e urtë e popullit se, «po nuk çeli mani, nuk heq xhyben Osmani». Ai nuk do spërkatur e krasitur. Po hurma, shokë, që të mbush me prodhim që vitin e tretë. Asnjë sëmundje e dëmtues nuk i afrohet. Nuk do as pompë as ilaçe. Kuintalë pa hesap. Agronomi i ri diskutonte me zë të lartë, duke bërë gjeste me duar. Njerëzia filloi të gumëzhijë e të qeshë nën buzë.

— Ndaloni këto shaka me thepa, po ju them! Ç'kemi e çfarë nuk kemi midis nesh, pse t'i dijë populli? — u nxeh e foli kryetar Seferi.

Mirëpo agronomi nuk desh t'ia dinte fare.

— Ta merrni vesh ju, unë kam dalë si piperi mbi pilaf për punën e pemëtarisë. Tani ta shtrojmë në popull, — vazhdoi ai.

— Atë që e kam thënë, unë nuk e tërheq.

Ashtu de! — foli Seferi dhe në fytyrë u bë lulëkuq.

— Ti, shoku kryetar, thua «presim kumbullat, se po i bëjnë hije kungullit», — iu kthye Estrefi kryetarit urtë e butë. . . — Dëgjoni, more shokë! Në pemëtari, po të shtiu përdhe miza, nuk të ngre as bualli. Prodhojmë e hamë pak, se kaq na kanë lënë, thonë disa. Po ne, ç'do t'u lëmë të tjerëve? — tha agronomi.

— Edhe ne kemi faj, se nuk arritëm të bindim kryesinë, — foli një shoqe e brigadës së pemëtarisë.

— Ti mirë e ke, më paç uratën, — i ndërhyri një i moshuar, — po mendja i mbushet atij që ka mendje, — pasoi fjalën ai.

Si u bë më tej e më tutje, atje qoftë e atje u rrëfeftë.

*
* *

Seferi ndjeu një zbrazëti të madhe në zemër. Qiellza iu tha fare. Gjuha iu trash e i dukej shuall. Goja iu hidhërua sikur të paskësh ngrënë shafran e pelin me lugë. Mijëra gjilpëra, me kokë e pa kokë, iu duk se e shponin ngado. Ndihej i kapitur sikur të kishte bërë një gjumë të rënduar pas fushatës. Diskutimi i fundit e kishte shkallmuar krejt. I bëhej sikur po e zbritnin me zor nga shala e po e hipnin në samarin e një gomari. Hej drejt! Ëndrra me sy hapur! U shkund. E mblodhi veten. Nga kjo ëndërr e çastit e zgjoi diskutimi i një kooperative të moshuar.

— Kryetarit tonë, shokë, i fle balta në çizme.

Për bujqësinë e blegtorinë, ne me plot ia pimë dollinë. — Seferit, në çast po i përmirësohej shija. . . — Për pemëtarinë, ne të moshuarit, mbetëm dyfek me çark. . . Po të na marrin për dore të rinjtë, nuk e kemi zor të ecim, — foli ai dhe u ul. Dhe ashtu vendosën.

AMA, TË NJOHUR!

Puna bëhet me njerëz. Njeriu duhet njohur. Po deshe që punët të shkojnë mbarë, duhet t'u paraprish problemeve, se, kur del dielli, të gjithë e dinë nga bie lindja. Mençuri i thonë kur di të orientohesh para lindjes së tij. Tani, jo se më vjen mirë dhe më gudeliset krenaria, por unë i njoh njerëzit, kam përvojë. Kam pranuar më mirë të më thonë qerrata se budalla. Edhe pse nuk e sosa arsimin e mesëm pedagogjik, nga psikologjia fitova mjaft. Kjo shkencë më është dashur orë e çast. Pa të dhënat e ndihmën e saj, do të mbetesh akoma tek ura. Në fillim kisha një punë të thjeshtë. I shpija pula mencës kur na vinin miq e të ftuar. Kjo më ra për pjesë.

Koha më dilte dhe më tepronte. Mirëpo kjo tepricë më duket se u bë shkak që të ndërroja edhe punën. Më hëngri qafa këmborë dhe më vunë shalën mbi samar. U ngrita në përgjegjësi. Më çuan në degën e furnizim-shpërndarjes të kooperativës. Kështu e vendosi më në fund kryetari, pas një debati të gjatë me shokët e tij. «Për shkakthësi ai djalë të rrëmben plëndësin nga vorbja», kishte thënë më në fund kryetari. Dhe kjo i duhej

punës. Nuk është e lehtë të merresh me furnizim-shpërndarje. Kjo valle kaq e bukur, kur e heqin të tjerët, të duket shumë e lehtë, kur futesh vetë në të, ëhë!

Një brigadë kërkon pleh kimik, se iu sos ai që kishte marrë, stallieri ankohet se kripën e gurit ia ngrënkan pa qejf viçat, ndaj tani e tutje do kripë deti. Furrxhiu nuk pranon tepsi katrore, se është mësuar me të rrumbullakta. Barinj të e tufëzave duan këmborë e zile jashtë scrisë, përgjegjësit të vatrës së kulturës i qenka shpuar lëkura e... gajdes. Në punë e sipër kujtoja herë pas here fjalët e xhaxhait tim, ndjesë pastë: «Për punë miqsh e shokësh, unë më mirë mbyll syrin e dashit, se syrin tim». Këshillë e vlefshme. Andej nga qyteti, kur doja të mbaroja punë, çoku dërgoja ndonjë gjë, si, fjala bie, raki, arra, fasule a mjaltë. Doemos shpenzoja, po edhe pa gjë nuk mbetesha.

Sidoqoftë me kryetar Fehmiun merreshim vesh, se disa zullume, doja s'doja, i kryeja me urdhër të tij, dhe ai si njeri i ndjeshëm e vinte dorën në zemër kur ata të kontroll-revizionit të rrethit më qëndisnin ndonjë gjobë. Mirëpo vitin e kaluar, kur u bë analiza vjetore për dhënie llogari e zgjedhje, kryetari doli nga mbledhja kooperativist i thjeshtë.

Për kryetarin e ri na dilnin shumë pikëpyetje. Se ca gjëra dihen. Të punosh dhe të kalosh mirë, duhet të dish të përshtatesh. Duhet të hedhësh këmbët sipas daulles e valles. Çfarë ka qejf kryetari? Sportin? Po ç'loj sporti? Ë? Me cilën skuadër është? Mos ka për zemër rakinë apo gjuetinë?

Të riut nuk po ia gjenim këmbëzat gjëkund. Sa të thosha se e kisha grurë me të, një detyrë

të mos plotësoje, të përplaste në qoshen tjetër dhe rrezik të të paloste ruli. Apo të hapej që t'i gjeje shijen! Dhe përgjigjet me pyetje i bënte. Kësisoj, megjithëse më i ri se Fehmiu, na dha huq. Rrinim në përgjim për të hetuar se me kë do t'i piquej ylli. Me disa kuadro nga ne sikur ishte parë hëna jashtë, siç thonë plakat e fshatit tonë.

«Tani si do t'ia bëjë, i shkreti. Kryetari i ri nuk e vënka rakinë në buzë», flisnin njerëzit midis tyre me zë të lartë që t'i dëgjoja. Po edhe unë e dija taktikën që duhej ndjekur. I duheshin marrë krahët, ja kjo që e gjitha. Dhe sa më herët, aq më mirë.

Këto mendoja tek qëndroja në kabinën e ZIS-it të kooperativës. Udhëtoja nga Saranda drejt rrethit, kooperativës, shtëpisë sime. Shkurt ishte. Ktheheshim tërë krenari, se kishim përfunduar riparimin kapital të makinës. Në Lukovë vura re se shiteshin agrume në një barakë. Mora çeskën e plastmasit dhe vrapin e lashë atje. Limonat më pëlqyen shumë. «Me siguri edhe kryetarit do t'i pëlqejnë», thashë me vete. Nisa menjëherë shoferin të merrte një arkë të madhe. E mbushëm plot dhe mori jo pak, por nja pesëmbëdhjetë kilogramë të mirë. Pagova dhe u nisëm. Gjatë rrugës mendohesha se si do t'ia jepja kryetarit. Kur arritëm në vend, kjo punë m'u duk fort e kollajshme. Në fillim i raportova si shkoi puna me riparimin e makinës dhe rruga, pastaj, si me lezet, dola në korridor, mora arkën me limona dhe e vendosa midis kasafortës së tij dhe tryezës, duke lëshuar edhe një rënkim të lehtë.

— Çfarë ke në atë arkë? Pjesët e këmbimit të makinës? — pyeti ai e m'u duk se po më qante hallin.

— Hë! Ca limonë. I shtrydhni në fasule, u çoni edhe ndonjë kokërr kalamanëve, — thashë duke shkundur duart. Dëgjova një «mirë, mirë» dhe gjaku po më shkrihej. Kur po delja nga dera, më pyeti:

— Të kopshtit i ke këta limonët?

— Rri, më qafsh, o kryetar! As në kooperativë e as në rreth nuk bëhen këta, po për ju do t'i gjenim ku të ndodheshin, — mora zjarr së mbari.

— Të lumtë, Pete! Kështu sikur të thërresin me përkëdheli, apo jo? — pyeti me sy gjysmë të mbyllur e bebëza të zvogëluara si majë gjilpëre.

— Po, po! Pete më thërresin të gjithë, — iu përgjigja i kënaqur se kishte thelluar procesin e njohjes e ishte futur në të holla.

Pas një gjysmë ore shefja e kuadrit, Rukija, njoftoi për një mbledhje të shkurtër e urgjente në sallën e kryesisë. Si i raportuan se nuk mungonte asnjëri, hyri nga paradhoma dhe kryetari.

— Rukije! Ku je? — thirri me forcë sapo hyri. — Ndajua shokëve e shoqeve ato që të thashë, — foli dhe pastaj u ul.

Rukija u fut te zyra e kryetarit dhe doli prej andej me një frutiere të mbushur me limonë. Filloi të qeraste secilin me nga katër kokrra. Në sallë, megjithëse ishin mbi tridhjetë vetë, duke përfshirë rojat e gatishmërisë luftarake dhe punonjësit e PT, nuk ndihej asnjë zhurmë.

— A ka më, Rukije? — pyeti kryetari.

— Arka dhe nja pesë kokrra, — u përgjigj ajo nga zyra.

— Mirë! Arkën jepja Petes. Limonat m'i lër mbi tavolinë, se do t'i shtrydh në fasule, — tha. Pasi u mendua pak, çoi sytë nga tavani dhe va-

zhdoi: — Sot Petja na solli makinën nga riparimi kapital. Ka qenë në Sarandë, që ta dini ju. E, që t'i shkojë mirë makina, secilit i ka sjellë nga katër kokrra limonë. Se katër rrota ka edhe ZIS-i. Punë të mbarë makina, gëzuar edhe ju shokë e shoqe! — uroi kryetari dhe e mbylli mbledhjen.

Ama, të njohur!

EH, KËTA FËMIJËT E QYTETIT, MOJ MOTRANI...

Atë të shtunë mbasdite rrota e rastësisë e solli që katër çifte të ndodheshin për një urim te Sadushi. Në krye të tavolinës qëndronte çifti më me stazh. Burri kishte një fytyrë bollobaçe të bardhë. Nën gushë palat i vareshin si r Rathë. E shoqja duhej ta kishte parë diellin dhjetë a dymbëdhjetë vjet më vonë. Ishte e vetëdijshme për hiret dhe pozitën e saj. Pranë doktorit me të shoqen që ulur çifti tjetër. Burri punonte bojaxhi në komunale. Turpin e kishte lënë diku bashkë me pompën e kominoshet, se aty u shtri si në shtëpinë e vet. E shoqja, pa u ulur mirë, filloi bisedën nën zë me gruan e doktorit. Afër meje që një edukatore kopshti që m'u prezantua si gruaja e Sytkiut, duke bërë shenjë nga burri përkrah saj. Rrotull karrigeve tona luante vajza 6-7-vjeçe e bojaxhiut, me djalin e Sytkiut dhe vajzën e Sadushit, pothuajse moshatare. Sikletin më të madh nga kjo vizitë dukej se e kishte e zonja e shtëpisë, pastaj unë dhe im shoq, si njerëz të ardhur nga fshati.

Si kaloi pak kohë, gratë filluan t'i lëshojnë më shumë ujë mullirit. Pastaj, si pa kuptuar, tema kaloi tek edukimi i fëmijëve. Vogëlushët vunë duart mbi supet e të rriturve dhe dëgjonin.

— Intelekti duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me moralin dhe ndërgjegjen, — dha një mendim e shoqja e doktorit.

Gruaja e Sytkiut pohoi me kokë. E shoqja e doktorit po i hynte në pjesë në fushën ku ajo e ndiente veten zot.

— Edukimi sot është një problem kompleks, — foli edukatorja duke ngritur zërin, — por, kur arrihen rezultate, njeriu ndien kënaqësi.

— Për edukatë që po u jepni! — foli duke tundur kokën poshtë e lart bojaxhiu.

— O mami, mami! Ç'do të thotë e leu mirë qerren? — pyeti vajza e Sadushit.

— Hë, de! Jepi përgjigje, të lutem! — i foli Sadushi së shoqes.

— Atë punë mund ta bësh dhe vetë, — iu kthye ajo.

— Kjo është detyrë e nënës, në radhë të parë, — vazhdoi Sadushi.

— Se ç'do të thotë e leu mirë qerren, moj vajzë, më mirë e di ai xhaxhi, — e mori fjalën edukatorja e kopshtit duke treguar me dorë bojaxhiun. Bojaxhiu kruante me nervozizëm thonjtë, sikur aty do të gjente fjalën që i duhej. Hiqej akull e brenda ziente.

— Mami im e di më mirë se babi, — foli vajza e bojaxhiut. Ajo e pyet gjithmonë babin kur kthehet natën vonë, me pompë në kurriz: «A e leu mirë qerren?» Apo jo, mami? — u hodh vajza, e gëzuar, duke kujtuar se e nxori nga sikleti

të atin. Ai mendohej, sikur t'i kishte humbur sprucatori i vetëm i pompës.

E shoqja e bojaxhiut u mbush me frymë e, pasi rrahu me nervozizëm dyshemenë me shputën e z bathur. filloi t'i bënte fresk fytyrës me një karton të zhgarravitur.

— Një pëllëmbë piçiruke dhe e bëri të kuqet deri në rrënjë të flokut. — u hodh e shoqja e doktorit. Më tej pasoi një heshtje bezdisëse që s'dihej kush do të merrte guximin ta prishte duke gjetur një shteg të volitshëm. Tamam në ato kohë djali i Sytkiut pyeti:

— Ku e merr lejen mami jonë, o babi? — Fëmijët e ndiejnë shpejt zemërimin e prindërve, ndaj bëjnë çmos t'i shohin të gëzuar.

— Te drejtori. — foli jo pa qortim Sytkiu. Edukatorja lëvizi kokën, shtrëngoi nofullat dhe me shikimin e saj donte t'i shtrëngonte vidhat të birit. Vogëlushi, që nuk kuptoi gjë, vazhdoi pa të keq.

— Mami ynë, o babi, kësaj here lejen e mori te xhaxhi doktori.

— E shoqja e doktorit i hodhi një vështrim inatcor të shoqit. Gjendja u rëndua dhe zjarri mund të ndizej me një shkëndië.

— Miri, o babi, do të bëhet me siguri artist. — foli vajza e Sadushit. — Sa mirë që tema e bisedës po ndryshohej. Do na dëgjonin veshët fjalë për artin, për filma, muzikë, teatër...

— A e pe, xhaxhi doktori, si bënte dje? — iu drejtua të parit të tavolinës. . . — «Më dhemb këtu! Plasa nga koka! Më merren mendtë. Nuk qëndroj dot». Tamam si e pati mësuar mami. Si thua? Do ta çojmë për artist Mirin, o babi? — thellonte pyetjet gozhdë e bija.



— Turpi, moj motrani, bën rojë te dera e nderit, — tha me një psherëtimë të gjatë e shoqja e bojaxhiut pa u kuptuar qartë se kujt po i qante hallin. Sadushi u përpoq të ndërronte temën e bisedës me shumë kujdes.

— Po të mos e kishte lojtur aq mirë ai, a do kishte marrë raport mami, o xhaxhi doktori? — vazhdoi avazin vajza e Sadushit. Mbetej përdorimi i ndonjë dacke, po pas tërë kësaj bisede edukative Sadushi e pa me vënd të shtrëngonte vetëm nofullat.

— Mjaft tani. Na mërzi me këmbënguljen tënde, si mushka, — iu lëshua së bijës i zoti i shtëpisë.

— Babi, o babi! — u gjallërua djali i Sytkiut sapo dëgjoji fjalën mushkë. — Si i do mushka drutë? — pyeti me zë të lartë. Sytkiu krojti fort kokën, anoi qafën pak maitas e duart i nderi përpara. Nga pamja dukej sikur po thoshte «E po, fëmijë! Nuk ke ç'i bën!»

— E di teta edukatorja, — foli vajza e bojaxhiut. sikur t'i kishte pëshpëritur njeri në vesh. — Një ditë ajo po hante mollë. Në dhomë hyri teta drejtoresha. Ajo i fshehu menjëherë. Kur e pyetëm ne, tha: «Ashtu i do mushka drutë». Akoma nuk na ka treguar ndonjë përrallë me mushkën, drutë dhe plakën shtrigë, siç na ka premtuar, — cicëronte me gojën brisk vogëlushja.

— Nga edukata e madhe, moj xhane, — e përkëdheli vajzën bojaxhiu.

Edukatores, që para pak minutash nuk i mbannte goja arra gjëkund, tani iu ngjiti gjuha pas qiellzës. E kyçi.

— Dhe unë vrisja mendjen ku i mësojnë fjalët

dhe shprehjet e këqija... — shfryu e zonja e shtëpisë.

Kujtova menjëherë tim vjehërr në fshat, që thotë «se çdo gjë që ka një fillim, ka edhe fundin e vet». Tamam fundi i këtij urimi na doli trëndafil me gjemba.

— Të na falni! Ne duhet të ikim! — foli teta edukatorja pasi nduku lehtë me bërryl krahun e të shoqit.

— Kjo nuk bëhet! — foli i alarmuar i zoti i shtëpisë.

— Po ju çfarë e patët? Dhurata në prag të vitit të ri mori dhe doktori me të shoqen, — foli bojaxhiu, duke u ngritur.

Për urtësi në muhabet, ky njeri m'u duk se fluturonte me një fije bari.

— S'mbeti çift pa dhurata, — tha im shoq. E, pastaj, duke qeshur shtoi. — Epo, ç'janë dhe këta fëmijët e qytetit!

A E KENI PARË MISTRINË TIME?

Shtëpia e tij ngrihej dykatëshe me ballkonin e dalë nga jugperëndimi. Ajo ishte më e reja në fshat. Përpara, pak majtas, ishin dy gropa të mëdha. Ato e dinin sa baltë u përdor për ndërtimin e shtëpisë së re. Pemët rreth e rrotull tyre nuk ishin dëmtuar fare nga ndërtime. Nën një gështenjë të moçme rrinte kotollaç një goxha murro plot pleshta që lëngonte nga mërzia.

Kamber Dalipi atë natë kishte gostinë e

shtëpisë. Ustallarët jabanxhinj «i ngrysën gur e baltë dhe e gdhinë shtëpinë dykatëshe», thoshin në fshat. «E ka me hak ta djegë Kamberi. Ia ngritën konakët sa hap e mbyll sytë», përgjigjeshin të tjerë.

Kati i parë i ndërtesës së sapopërfunduar ishte rregulluar për të pritur miq. «Oh, moj oda me tavan/ lumja ti çfarë miku mban», u ka kënduar populli atyre. Oda e Kamberit, pa tavan, brenda katër mureve, mbante jo një, po mbi njëzet miq, shokë e të afërm të tij.

Vendet e para në konak ishin ndarë midis të zotit të shtëpisë e Nures, kryeustait. Kamberi dukej më i kërrusur se zakonisht. Kokën e mbante pak ulur. Mbi ballë, në brazdat e zhveshura nga flokët, dalloheshin bulëza të imta djerse. Në oxhak valonte zjarri bubulak me kërcëla mareje e shqopë.

Usta Nurja, në qoshen tjetër, rrinte më i përngrehur se Kamberi. Turpin e druajtjen dukej se i kishte varur në një makaze bashkë me trastën me vegla dhe ishte shtruar si në shtëpinë e vet. Dukej se i kishte shkelur të pesëdhjetat. Ai që nuk e njihte, bënte be e rrufe se ky njeri s'kishte vënë asnjë gur në këtë bina. Pas Nures rrinte ustai më i moshuar i grupit, Sefedini. Kishte një trup si kërcu lisi e duar të ashpra të fuqishme. Në fjalë ishte më i kursyeri. Më tutje kishin ndenjor disa të rinj, dy nga të cilët ishin mûratorë.

— U lumshin duart ustallarëve! Të tjerëve ua shpërblefshim në gëzime! — rroku gotën e rakisë e uroi Kamberi.

— I gëzofshi e i trashëgofshi! — u dëgjua zëri i fortë i usta Nures. Zjarri në oxhak bubullonte, urimet vazhdonin. Ato herë i drejtoheshin të zotit të shtëpisë e herë kryeustait. Rakia e fortë po ndizte zjarre të reja përbrenda secilit. Uro, pi raki e këndo, nisi kjo natë. Kur erdhën urimet nga tri-katër herë rrotull e rrotull, Kamberi nisi dollinë. Apo nuk e ka zanat ai! Për dolli e këngë e merrnin në lagje për të parë muhabeti, e jo tani në shtëpinë e tij! Fjalët i puthiste më mirë se gurët e qosheve të shtëpisë së re.

— Për kryeustanë ta pimë, — uroi ai, duke ngritur gjithë sa ishin për shëndetin e usta Nures.

Në fillim gostiarët ishin pak si të druajtur. Ishte faza e diplomacisë, «pije ti, ta pijë dhe pritësi»; «mos lër njeri pa e pirë». Kësaj faze në fshatin tonë ia kanë ngjitur «faza e dhelprës». Po piu i zoti i shtëpisë, miku e shoku nuk ia përton. Sa vinte e të gjithë po bëheshin më të vrullshëm, më xhevapllinj. Po kalohej pa u ndier në fazën e dytë, që nga ne i thonë «faza e kaposhit».

— Asnjë të mos e mbushë së dyti gotën, pa pirë me fund shëndenë e usta Nures. Pak shëndete me qokë kemi sonte, — foli xhaxhai i Kamberit, pritës i dollisë. Gotat e mbushura me raki rrushi u kulluan në çast. Sofrat e shtruara atë natë mbanin mbi mbulesë ç'prodhonte blegtorja, pemët, bleta dhe hardhia. Njerëzit pinin dhe këndonin. Kamberit po i shtoheshin bulat e djersës në ballë e bebëzat e syve i zvogëloheshin. Usta Nurja, nga

qejfi, hoqi peliçen prej mëshini e i ktheu kurrizin oxhakut. Sefedinit, si duket, nuk i kishte hyrë ende rakia në tërë të mbërthyerat. Rrinte akoma nursëz.

*

*

Sefedini kujtoi si nisi kjo punë. Para dy javësh i erdhi në shtëpi Nurja. Ai nuk i kërkoi as borxh, as t'i kryente mblesëri për ndonjë djalë a vajzë të vonuar në fshat. Nuk i kërkoi as ndonjë myshteri për të shitur a blerë lopë, mëshqerrë, a kafshë samari. Pasi ia bënë eshtrat kapule një kaposhi e i gjetën fundin një poçi, mysafiri e zgjidhi gojën. «Kam ardhur për një punë, po dua të mos ma bësh fjalën dy.» I zoti i shtëpisë dëgjonte. «Duam të të marrim usta të qoshes te një miku im në Grunjas. Do të bëjë një palë konakë». Sefedini bie në të thella. Përpara i del brigadieri, kryetari, shokët. Pastaj nuk e di me cilin do punojë. Ka apo nuk ka leje Nurja për punë private? Po ai miku i Grunjasit? Ka apo nuk ka leje për ndërtim brenda vijës së verdhë? «Ka ligje për këto punë», i thotë mikut i vuajturi Sefedin. Nurja e siguroi ustanë e qoshes se vetëm fjala e tij pritej e gjithçka që në rregull.

Pas dy ditësh Sefedini e poqi mendjen. «Do të bëj një rrugë e dy punë. I mbaroj shtëpinë Kamberit, u mësoj edhe katër çunave zanatin. Pastaj, namin kam për të bërë. Pajto e ndërto. Ngrysu gur e baltë e zgjohu në shtëpi të re. «Po sikur të

mos ia thonë fare?» i vinte një mendim ogurzi. Njërin e kishin hequr nga blegtoria se kishte humbur dhitë, tjetri nuk kapërcen dot klasën e tetë dy vjet me rradhë, i biri i Tafilit i kishte nja dy



dërrasa mangët, po për punën s'ia përtonte. Malon po e kishte djalin e mikut. Sefedini kthente shëndetet e mendohej. Tani shtëpia ishte ngritur në këmbë dhe ortakllëku me Nuren e kishte afruar më shumë. Kamberi vinte re se kryeustai sillej ashpër me shokët. Njërit i shembi mbi një metër gjatësi mur. Tjetrit, për një gur që qe vënë keq, ia prishi murin deri në brezin tjetër. Pastaj i keqej Malos, baltaxhiut. Dha e mori i gjori Kamber t'ia gjente tragën nxehjes së kryeustait, por nuk qe e thënë. U desh ndihma e mbesës së tij dhjetëvjeçare, Vjollcës, t'i shkoqiste ca gjëra.

— Gjyshi, ç'do të thotë *na i holloi zorrët me dhallë e fasule?* — e pyeti ajo. — Kështu tha dje usta Nurja. Kurse Sefedini recitonte duke punuar. U thoshte shokëve një vjershë që nuk e kam dëgjuar në shkollë. «O çekan, o faqezi, faqebardhë, moj mistri. . .»

Pas kësaj i zoti i shtëpisë e ndryshoi dorën në ushqim dhe ustallarët nuk po recitonin më vjersha. Bënin ndonjë shaka, fishkëllenin dhe çdo ditë i afroheshin çatisë. «Oburra, çuna! Dhe tri ditë leje ka kryetari i këshillit popullor të fshatit. T'i hedhim çatinë e të ikim se. . .» Sefedini, kur mori vesh se Nurja nuk kishte leje, u mërzit shumë. Dukej se atë inat ruante e nuk u çel as në gostinë e konakëve.

* * *

Mezet po gjysmoheshin e kënga sapo pushoi. Kamberit i vinte të thërriste: «Hani, more të babë-

zitur! Fryhuni tani me ç'keni përpara!». Tamam në atë kohë një vetëtimë e fortë çau errësirën tej e mbanë dhe fiku dritat për një çast. Një bubullimë e fuqishme e pasoi. Ja dha shiu si me grykë të gjumit. I ka vjeshta nganjëherë këto. Si kaloi vala e parë e stuhisë, muhabeti në konak vazhdonte. Kishte filluar dollinë kryeustai.

— Themeli të forta, o Kamber! T'i gëzoni! — uroi dollibashi. E donte një shëndet themeli, se mbante tërë atë bina. U dëgjua një kërcitje e fortë. Të gjithë heshtën. Çatia krisi prapë. Usta Nurja, me gotë në dorë, u hodhi një vështrim të gjithëve.

— Merr pjesë edhe konaku në gëzim, Kamber! — iu drejtua të zotit të shtëpisë. — Ne u bëmë shëndet themeleve, por i paska mbetur hatëri çatisë. Mos u mërzit, çati e Kamberit. Ta bën Nurja shëndetin ty. A më nderove? Pikë shiu nuk rodhe poshtë, pas këtij rrebeshi. Të lumtë! Edhe ty, oxhak, do të ta ngre një shëndet të fuqishëm, se ma tërheq atë tym aq bukur! Raki, Kamber, për kokën tënde, raki, se sonte u bë nami fare, — tha Nurja dhe e palosi me fund shëndetin e themeleve.

Brompet e gëzuara vinin e shkonin e kryqëzoheshin në të dy sofrat. Kryeustai vazhdonte dollinë. A ishin bërë a nuk ishin bërë nja pesë shëndete mbi themelet, kur u ndie përsëri një krismë në çati. Zërat pushuan menjëherë dhe të gjithë kthyen kokat andej nga erdhi zhurma.

— Kapiteni festen mbi sy! Nuk ka gjë. Zë vend ndonjë tra dhe baballëku, — i qetësoi gostiarët usta Sefedini. Fjala i zuri vend si gur qo-

sheje i skalitur mirë. Në tryezë kaloi një valë e re urimesh e shëndetesh.

— Thuajani njëherë, çuna! — foli kryeustai. U ndie një eeee e zgjatur e hollë, si e ndonjë piliçi që sapo ka filluar t'i thotë pulave ta llogaritin edhe atë. Ia mbajti një nga vendasit. Pa përfunduar mirë kënga e dollia, prapë u ndie një krismë tjetër më e fortë. Pasi edhe një e dytë. Të gjithë sa ishin nuk ia ndanin sytë vendit nga vinte zhurma. Usta Sefedini u ngrit në këmbë. Të rinjtë, me një të kërcyer, u ndodhën jashtë pragut. Më tej nuk patën kohë të këmbenin fjalë me njëri-tjetrin. Një faqe muri (aty ku kishte nderuar mistoria) e nxori shpejt e shpejt mullën nga ana e jashtme. Çatia e mënjanuar në atë drejtim po i lëshonte tjegullat breshëri. Pas pesë minutash tërë njerëzit dolën jashtë. Çati e dysheme u bënë bashkë e midis tyre rrinin viktimat e gostisë së pasur të Kamberit.

* * *

Në mëngjes Kamberin me familje e fëmijët dita e re i zuri në një kasolle plastmasi pranë një peme. Fshatarët shikonin e nuk flisnin. Erdhi dhe Rrema, kryetari i këshillit.

— I zgjate shumë ato pushime në llixha. Të ishe këtu, nuk do t'i ndodhte kjo hata Kamberit, — foli njëri nga fshatarët.

— Po ju, ku i psonisët këta ustallarë? — ia ktheu ai tërë inat. — Ku janë tani? A ua dhe paratë? — pyeti Kamberin.

— Vetëm kaparin, — foli i zoti i shtëpisë, i brengosur dhe i papërqendruar.

— Sikur kanë ardhur të marrin dhe pjesën tjetër, — foli një mesoburrë.

— Hë! Mirë se të vijnë! Ata ustallarë, pa çekan e pa sqeparë, po nuk i bëra baltaxhinj, mos më thirrshin në emër, — u betua Rrema.

Pas mureve të shtëpisë së shembur u dëgjua një zhurmë. Dikush punonte me kazmë. Kur shkuan atje, panë usta Nuren. Ishte kërrusur e diçka kërkonte, duke luajtur gurët. Sa pa njerëzit, u duk sikur u përmend e, pa ngritur kokën, pyeti:

— Mos kini parë mistrinë time? — Ai kërkonte, vazhdimisht kërkonte. As që i bëhej vonë se po e shikonte tërë fshati.

— Me siguri kaparin e ka pasur në trastën e veglave, — tha Rrema.

FLETËT E DAFINAVE DHE ATO TË HITHRAVE

Deri sa Hairi po porosiste me ngut që jo vetëm asnjëri s'duhej të mungonte në mbledhje, por edhe të visheshin më mirë se për dasma e gosti, diç do të ishte. Siç u mësua më vonë, do të vinin edhe njerëz nga shtypi, radioja e bile televizioni.

Qëllimi nuk dihej mirë, dhe Hairi nuk donte të zbulonte. Mbase vinin për të regjistruar ndonjë koncert ose grupin folklorik, a mbase interesoheshin për furnizimin e tyre me perime e bulmet nga arëzat e tufëzat. Këto biseda me hamendesime

vazhduan derisa erdhi ora e mbledhjes në një nga sallat e shtëpisë së kulturës.



Hairi, sa verifikoi se shumica kishin ardhur, zuri vend në presidium, i ndjekur nga katër anëtarët e tjerë të komisionit.

— Shokë e shoqe, — filloi fjalimin e tij Hairi. Të gjithë e dinin se si kryetar i komisionit të emulacionit socialist, ai qe brisk nga goja. — Sot mblidhemi të bëjmë bilancin e punës njëvjeçare. Kemi një shtet të madh: realizuam dhe tejkaluam planin e prodhimit të grurit. Në emër të komisionit të emulacionit socialist do të flas më vonë. Tani e mora fjalën sa për të çelur takimin. Siç e shihni, kemi dhe miq që duan të përhapin përvojën tonë. Ju bëj thirrje t'ua japim pa kursim e me bujari. Fjalën e keni ju. — Hairi u tërhoq me modesti prapa.

Menoja, pasi kroi pak zërin, u ngrit i pari.

— Merita kryesore i takon organizatës së frontit, — tha ai. — Ne, në radhë të parë, kemi siguruar unitetin duke e shikuar problemin në familje, në brigadë, në lagje dhe në fshat. Sigurimi i unitetit është çështje. . .

— Në kuintalët e grurit kanë pjesën e tyre edhe veteranët tanë të nderuar, — e ndërpreu Samiu. — Në daçi e merni direkt, në daçi indirekt. Indirekt, se ne me punën tonë kemi krijuar bindje të plota e të qëndrueshme për rëndësinë e grurit dhe të bukës. Ndërsa direkt, ka influencuar kjo e fundit. . .

— Të lumtë, kryetar! — e përgëzuan disa nga veteranët pjesëmarrës në takim.



— Mos harro që kemi mbushur edhe disa thasë me farë. . .

— Po të mos ishim ne, të skuadrës MKZ, as gjysma e prodhimit s'do ishte marrë, — tha Maqoja. — Se goja nuk bën zarar, por, po të binte zjarri? — ngriti zërin ai.

— Ouu! — u dëgjuan zëra.

— E bëri më keq se tersi i Pojanit, — foli një e re.

— Sa zjarre shuat, o shoku Maqo? — e pyeti një veteran.

— Asnjë! — u përgjigj Maqoja krenar. — Dhe këtu qëndron zotësia jonë. Nuk lamë të binte zjarr në grurë.

— Rezultati, more shokë, erdhi drejtpërsëdrejti nga puna e shoqatës shkencore të kooperativës. Pse, bëhet gruri pa shkencë? Mos përrallisni kot, ju lutem! — iu drejtua mbledhjes mësuesi i shkollës së mesme, Tefiku, me profesion agronom.

— Ah, lëre, lëre! Me ata dy-tre dynmë që mbillni me grurë në parcelat e shkollës, e ndritët ju të shoqatës shkencore! — foli aty për aty Qatipi.

— Mos e caprashitni kot, se nuk ka lezet.

Më vjen çudi si po harroni shoqatën e gjuetarëve sportivë. Nuk e luajnë as nëntshet e derri që po ju them. Vitin e kaluar ne vramë 72 lepuj të egër. E dini ju se sa grurë ha një lepur i egër? Nuk e dini! Ne kemi vrrarë 333 gugashë. E dini ju se çfarë bën gugashi me grurin? Jo, nuk e dini. Dhe nuk keni si ta dini. Sa mbillet, rritet, korret e bëhet kavaleta. shihet e futet në hambar. gugushi me grurë ushqehet. Ku do të hajë ai! Nuk del në pazar me lekë në dorë. Po pëllumbi i egër, thëllënza e

harabeli? Të gjitha këto... — Mirëpo nuk ishte e thënë që kryetari i shoqatës së gjuetarëve, Fetiu, të vazhdonte përhapjen e njohurive për ushqimin e shpendëve të egra, se brigadierin e ndërtimit s'po e mbante vendi.

— Pa ne të ndërtimit, shokë, gruri do të bëhej hashure. E ore, e! Hashure do të bëhej. Ai nuk do të bluhej, me trembëdhjetë për qind lagështirë, siç kemi arrirë sot. Dhe kjo i dedikohet punës sonë, se ne bëmë furrat, magazinat, mullinjtë...

— Ti po korr arat e të tjerëve, — e kritikoi Guriu. — Jemi ne të Ujërave, more shokë, ne që kemi qenë tërë kohën në pozicion luftarak. Drejtori ynë, vetëm kur binte shi ka vënë kollare. Ditët e tjera nuk dilte as në fshat e as në qytet, se i kërkonin ujë. A ju kujtohet se si u bë gruri tek ara e Koçolit? Të luante mendja. Ne të Ujërave jua dhamë ujin për të vaditur dy herë... — Dhe Guriu i Ujërave nuk do të kishte dalë nga rezervuarët e elektropompat po të mos e kishte marrë përsëri fjalën kryetari i emulacionit, Hairi, për ta orientuar.

— Të tërë kemi punuar. Asnjë nuk është pa pjesë. Ne të emulacionit socialist... — Mirëpo edhe Hairit ia ndau mes për mes fjalën një i paduruar.

— Po brigadierët ku janë, more shokë? — pyeti Samiu. Ku është Ibrahim, Hamiti, Verzikua, Gjylja? Kemi dëgjuar se janë brigadierë të mirë...

— Topi nuk e luan. Kanë edhe ata ca merita, — foli Fetiu.

— C'merita? Punën e tyre kanë bërë.

— Atëherë, si thoni? T'ua japim fjalën brigadierëve? — vazhdoi Hairi.

— Mirë u kujtove, — ia pritën nga salla. —
T'i dëgjojmë.

— Ata nuk mundën të vinin, — foli një e
re, — se po përgatiten për mbjelljet e vjeshtës.

— Pse, sot e gjetën? — pyeti Fetiu.

Diskutimet vazhduan gjatë. Pati kohë të piquej
milori në hell, të bëhej dhe kukureci. Pa erdhi
kulaçi i sapodalë nga furra dhe disa produkte të
tjera blegtorie e baxhoje. Hairi gjithmonë festat
e prodhimeve bujqësore sepse kishte qejf t'i bënte
me prodhime blegtorale. Pa u ngritën dolli për mi-
qtë e ardhur. U përgjigjën edhe ata me dolli
e me shëndete e ca më tej. Kur mbaroi dreka,
dielli po i afrohej perëndimit. Të zotët e shtëpisë
e miqtë po shijonin frutat kur u kthyen pendët
e qeve e pendarët nga arat ku kishte filluar mbje-
llja e grurit të ri.

Vitin tjetër analiza e grurit nuk u la kaq vonë.
U njoftua urgjent një mbledhje për të parë pro-
dhimin e vitit. Hairi kësaj here nuk kishte marrë
mundimin të njoftonte shokët e shtypit, të radios
e të televizionit. Për bela, u fol se aty rrotull ishte
parë një gazetar para dy ditësh. Megjithatë poro-
sitë ishin dhënë. «Po të jetë i «Hostenit», u ishte
drejtuar Hairi dy vetëve që mbaheshin për më
të shkathëtit e komisionit të emulacionit, ta merrni
e në fillim ta çoni në bllokun e fiqve, prej andej
te shalqinj të e pastaj në tufëzën e Sabiresë.

Mbledhjen, si gjithmonë, e çeli Hairi.

— Jemi mbledhur për të analizuar prodhimin e grurit. Mblidhemi dhe dalim përpara njëri-tjetrit me turp, shokë. Pale, e kini marrë vesh, plani nuk u realizua. Deficiti ishte aq i madh, sa dy a tri magazina nga ato që ndërton Muçoja, kanë mbetur bosh fare, pa asnjë kokërr.

Muçoja nuk mban pluhur mbi kurriz gjëkundi. Pulit sytë e ngrihet pa marrë leje.

— Nuk ke punë me Muçon ti, shoku Hair. Se as Muçoja nuk ka punë me grurin, as me plehun e as me makinat shirëse!... Depot i keni në rregull? Ç'doni më? Unë gurët dhe llaçin kam...

— Me planin e hashureve s'dimë, si do të jemi sivjet? — i shkeli bishtin keq brigadierit të ndërtimit Guriu i Ujërave.

— Ti, more xhan, bën llafe kot, — i del krah Muços Fetiu. — Sa herë kam dalë për gjah atyre anëve, shullëheshe në diell dhe asnjëherë s'e more mundimin të ujitje arën e Koçolit që u dogj në hënëz e nuk bëri grurë...

— Viti që sapo mbyllëm, nuk ka qenë i mbarë për grurin, — po i vinte kapakun bisedës shkencërisht mësuesi i shkollës së mesme.

— Or, ti, djalë! Përtypi pak ato fjalë! — tha kryetari i Frontit.

— Po për Bletëzën, me të cilën na ndan një përrua, si ishte ky vit? — e pyeti një veteran.

— Të na thotë Fetiu, si përgjegjës i grupit të shoqatës së gjuetarëve të fshatit tonë, sa grurë futën sivjet në hambar duke vrrarë lepuj, gugashe e shkurtëza? — pyeti Maçoja, si për të ndërruar midenë e muhabetit.

— Shoku Maço, ti mbaj vendin! Realizohet, nuk realizohet plani i grurit, ne me detyrat jemi

mirë. Sivjet ne kemi tejkaluar planin e gjuetisë së skileve. Grurin le ta shohin ata që e kanë zanat. . .

— Mos e ke fjalën për ne, veteranët? Ne, more byrazer, nuk kemi nge të mbajmë rrozga mbi kurriz në këtë moshë. Kush krijoi deficitin, le të përgjigjet. Kur ishim në moshën tuaj, ne. . .

— E dimë, e dimë, se ju merrnit nga shtatë-tetë kuintalë grurë për hektar, — ia pati mësuesi i shkollës së mesme.

— More, po ne harruam hallkën kryesore. . . — flet Muçoja i ndërtimit, duke u drejtuar me duar nga kryetari i Frontit. — E? Si që ajo puna e unitetit?

— Fronti merret me edukimin politik, jo me misër, as me grurë. . . Mos i ngatërro gjërat!

— Unë thashë fjalët e Menos, — u mbrojt ai.

— Meno! Ky nuk është hiç i qartë politikisht. Mërmërima dhe të qeshura në sallë. Përgjegjësisë asnjë nuk i dilte zot. Hairi kë'ë radhë dukej më i sikletosuri.

— Po rrahim ujë në havan, — u dëgjua i fortë dhe i kthjellët zëri i Maqos. — Ku janë brigadierët? Ibrahim, Shkëndija, Gjylja, Hamiti? Ata le të përgjigjen.

Nga fundi i sallës u ngrit Gjylja. Ajo ia pati ngadalë.

— Ne pandehëm se do të na harronit edhe sivjet, ashtu siç na harruat vitin e kaluar. . .

Për diskutime të tjera nuk pati nevojë dhe Hairi e quajti me vend ta mbyllte mbledhjen.

ÇELOJA MERRET ME METEOROLOGJI POPULLORE

Shkollën e lartë ai e mbaroi me shëndetin dërdëng, një metër e tetëdhjetë i gjatë, në moshën njëzet e tre vjeç. Punën si mësues i gjeografisë e zuri me zemër të thyer, se nuk e priste ta emëronin mësues në fshatin e tij. Në qytet kabineti pedagogjik digjej për mësues, shkolla të mesme plot. . . Le të tjerat, po nuk e linin rehat edhe bashkëfshatarët. «Pse u dashka shkollë për t'u treguar fëmijëve të fshatit se si gjendet rruga në pyll, ose si numërohen yjet? «Edhe e lehtë nuk është». «Bëje ti në ta mban!» ia kthente tjetri. Viti i parë i punës nuk solli asgjë të re. Çeloja ynë filloi të mendonte si t'ia linte shëndenë fshatit dhe shkollës. Ky u bë problemi numër një i jetës së tij.

«Bëj tutje sa të duash, po kush të transferon se? Dhe pastaj çfarë argumenti të renditësh? Po nuk u dallove në një drejtim, ku të llogarisin ata të qytetit? Një arsimtar nga rrethi kishte përfunduar në Akademi, sepse zbuloi dy varre të vjetra». Një shokun e tij, instrumentist, e kishin marrë në estradën profesioniste të qytetit. T'i futej edhe ai ndonjë vegle? Qe tepër vonë për të ushtruar një pasion që s'e kishte. Pastaj menjëherë i lindi një ide; një nga ato idera që vijnë papritur në çastet e larta të frymëzimit. Do t'i kushtohej shkencës, meteorologjisë popullore, fushë e pashkelur, me të cilën s'qe marrë njeri. «U vendos» tha Çeloja. «Marrja me këtë shkencë është jetike për të ardhmen time». Për një mësues të thjeshtë gjeografie s'kujtohej kush andej nga qendra, ama, kur të

bëhej fjalë për një kandidat shkencash në meteorologji, ndryshonte llogaria... Kur e mori vesh drejtori, në vend ta përgëzonte për nismën, i foli mbyturazi: Se mos rregullove shimatësin, flugerin apo barometrën e shkollës e të mbeti prapa puna shkencore... Pse nuk merresh me problemet e gjeografisë fizike të vendlindjes, krahinës, rrethit, të demografisë, të bimëve mjekësore?

Mirëpo Çeloja nuk u tërhoq. U betua me vetë: kur të mos ketë behar e dimër, kur të mos ketë ditë e natë, kur të zhduken retë e dielli, atëherë do të hiqte dorë nga pasioni i ri që i pushtoi çdo qelizë të trurit. «Pse kur thoshte gjyshi im pas tri ditësh ka shi, i dilte një me një? Nga e si e dinte? Me sa kishte dëgjuar, kishte plot njerëz të tjerë që merreshin me kohën. Këtu mbahu e mos luaj, se ç'është ka», i tha vetes ai. «Pse mjekësia e ka kthyer fytyrën nga mjekimet popullore? Pse është aq e dashur muzika popullore? Pse të mos bëhet e tillë edhe meteorologjia popullore?»

*
* *
*

E para e punës, duheshin intervistuar gjithë ata që merreshin me motin. Emrat e tyre i rreshtoi në një fletë të bllokut të ri. Sipas planit, të parin poqi xha Mitron.

— Çfarë shenjash duken përreth kur prishet koha? — e pyeti Çeloja.

Tjetri mblodhi buzët, rrudhi fytyrën dhe kokën e tundi poshtë e lart.

— Kur më ther mua kupa e gjurit, nuk e kam mendjen të shenjës. Asgjë nuk më hyn në sy

atëherë, — foli xha Mitroja. Vrulli i Çelos pësoi një goditje të rëndë, po për fat i erdhi në ndihmë Afëzi, perimerritësi i kooperativës. Domosdo atë e lidhte profesioni dhe, sikurse thoshte, kishte shpëtuar shtretërit e nxehtë nga ngricat e bryma kushedi sa herë.

— Para se të prishet koha, ulet mjegulla deri te shpella në malin e Tomorrit. Ja, deri atje te koritat. Kjo është...

— Pse e çon deri në Tomorr, more Afëz! Ne kemi shenjat e fshatit tonë. Po këndoi një bretkocë e vogël afër mbrëmjes te Ligata e Selimit, prite shiun. Është një me një...

Çeloja mbante shënime me zemër të ngazëllyer.

— Nuk është vetëm ajo, more Shefat, io! Kur fillon dimri e nuk gjendet gjëkund këmbë bretkoce, kush do të këndojë te Ligata e Selimit? — foli Kanani me argumente serioze. — Fshati ynë, bvrazer, shenjë krvesore të prishies së motit ka oshëtimin e lumit të Zerzelesë kur thyen qafën poshtë Shullërit të Konacit. — tha ai duke i vënë dorën mbi sup mësuesit. Shtë nuk ia ndante bllokut ku shkencëtari i ri mbante shënimet. Dhe Celoja do të mbledhte niëherë, pastaj do të zgjidhte. Kësisoj regjistronte çfarë dëgjonte.

— Kur prishet koha, moj motrani, mua më rekëtin vetëm syri i majtë, — foli Darekoja, një mesogrua.

— Mua, — tha një grua tjetër, — syri më rekëtin para se të hapet koha. E kam një me një, — kumtoi ajo duke u betuar.

Kjo e ngatërroi keq të gjorin Çelo, së pohanin gjëra të kundërta.

Ë pastaj nisën të përmendin me radhë këngën e kaposhit në darkë, larjen e fytyrës së maces me këmbë, erën e Grykës së Çakallit e më tej vazhduan me kulumbritë e ftonjtë. Sa më shumë lule e kokrra të bënin ato, aq më i ashpër do të ishte dimri. Nuk po i linin radhë njëri-tjetrit. Vetëm xha Zaneja me mjekrën mbështetur mbi bastun nuk e kishte hapur gojën. Pastaj... kjo do të jetë shtylla vertebrore e disertacionit të ardhshëm. Se... ja! Edhe buletinit meteorologjik që jepte radioja, shtypi e televizori, i dilte, po ndodhte dhe e kundërta. Disa, bile, u shprehën se spikeri, kur nuk i del parashikimi, nuk duket në televizor për tri net rresht. Kësisoj, Çeloja donte të orientonte bisedën te parashikimi i kohës në behar.

Kjo, sipas tij, kishte edhe rëndësi ekonomike, sidomos për bujqësinë.

— Goxha i mençëm na dole, more çun i Nazarit. Futi, futi në atë bllok të gjitha. Po kujdes se mos të lagen. E në behar, që the zotrote, shiu është i sigurt po u nxi e vetëtiu te Gropa e Tezes, — foli ai.

— Ku bie ky vend? — pyeti Çeloja me lapsin në erë.

— Kaq di e kaq them unë. Po t'u desh më tej, pyet mullixhi Hiqmetin në fshatin fqinj. Ai të sqaron më mirë. — Kaq tha xha Zaneja, duke e futur në merak mësuesin.

Në mbrëmje Çeloja nuk e kishte parashikuar motin e keq që e priste në shtëpi.

— More bir, — iu zbraz e ëma, — ç'ishin ato që dëgjoja sot andej nga dyqani i fshatit? Vëlonin muhabetet me bretkoca, me hënë të vjetër e të re e rekëtimat e syrit të Darekos, me kulumbri, mu-

rriza, thana e kumbulla të egra! Pse, me erën e Grykës së Çakallit e nxirjen e Gropës së Tezes do merrësh tani? — shkallëzoi sulmin ajo. Kur e pa se i biri ndryshoi në fytyrë dhe u tulli, e uli ca tallazin. . . — Pse, ç'u bëre ti, Mediu i Misrasit, që thotë se e di që në gusht si do bëjë vitin tjetër?

— Rrofsh, moj nënë, që më kujtove Mediun. E kisha harruar jashtë listës e planit tim për punën shkencore. Nesër atje më ke, — foli Çeloja i gëzuar, duke përzier shaka e seriozitet bashkë.

Të nesërmen vërtet ai mori rrugën për në Misras. E gjeti tamam atje ku i thanë, me një tog purteka përpara, duke bërë kofina. Si u përshëndet me mjeshtrin e kofinave, Çeloja doli atje ku i pikonte çatia. Kofinëbërësi e mati me sy nga koka te maja e këpucës. La thikën e purtekën, u shkund nga gjethet e lëvoret e mbetura në pantallona dhe po shpinte gjymtyrët.

— Ç'punë ke ti me kohën, more çun i Nazarit? Nuk ke as për të mbjellë as për të korrur, — e qortoi mësuesin.

Çeloja u çudit se ku e njihte! Pastaj u ul shtruar e i foli gjatë e gjerë se pse i duhej parashikimi i motit.

Meqë e paske kaq merak, mos humb kohë kot as me Hiqmet mullixhiun as me Kasëm e kallam kusur, po lëre vrapin në malin e Lenies, te Beqoja. Ai është bari dhe i di fundin kësaj pune dhe ty s'të mbetet veçse të hapësh sytë e të mbash shënime. Po s'të doli kështu si të thashë unë, eja më pështy, — tha së fundi Mediu.

Çeloja filloi përgatitjet për t'u ngjitur në malin e Lenies. Së pari, u vesh më trashë. Mori ushqij-

me të thata, radion, bllokun e shënimeve. Në Lenie nuk veron bagëtitë vetëm Beqoja. Aty vijnë barinj nga 5-6 rrethe dhe ai kishte rastin më të mirë t'i pyeste të gjithë. Nuk është kollaj të bëhesh shkencëtar. Me çfarë nuk lidhet kjo degë e shkencës, me bujqësi, blegtori, ndërtim, peshkim, aviacion. Duke ngjeshur ndërresat në çantë, Çeloja e ndiente si vezullonin para tij horizonte të reja.

Të shtunën në mëngjes herët filloi ngjitjen së bashku me brigadier Temen, i cili mori përsipër ta njihnte me Beqon. Më në fund e poqi edhe Beqon, ulur pranë zjarrit, me barinj e kafsharë të tjerë. Çeloja ia zbërtheu menjëherë qëllimin e vizitës.

— Dua të pasuroj nga pak shkencën, more Beqo! Të futim, bie fjala, parashikime me afat të gjatë të kohës, që t'u prijmë disa fushave.

Të gjithë po e dëgjonin me një buzëqeshje çapkëne në buzë.

— Kush të solli këndeje për këtë punë, më qafsh, dua ta di, — këmbënguli së fundi bariu.

— Mendimi ishte i Mediut të Misrasit, po ma do mendja se edhe Hiqmet mullixhiu e Kasëmi i perimeve te ti do më dërgonin, — foli mësuesi.

— Mirë, mirë! Meqë ardhke nga ata, nuk po të çoj më larg. Ama, një gjë ta kemi që tani. Po deshe të mësosh saktë shenjat lokale të motit, do të qëndrosh ca ditë këtu në mal me mua. Këto ditë numërohen muajt dhe do të shohim kohën për tërë vitin, — derdhi ujë në mullirin e mësuesit Beqoja.

Kjo përgjigje e kënaqi vizitorin e ri të atyre maleve, se iu duk baza më e rëndësishme, fakte të pakundërshtueshme, që do të pasuronin e betononin studimin.

Shpejt e shpejt barinjtë sajuan nga një shtrat

të thjeshtë shtruar e mbushur me bar e fier të thatë. Natën e parë Beqoja u tregua kyç pa çelës. Të nesërmen në mëngjes filloi të rrëfente për malet e kullotat afër e larg, si të donte t'i konkretizonte më mirë mësuesit me ato që kishte mësuar në shkollë, në libra e harta.

Në mëngjes Beqoja e pyeti:

— Do rrish këtu në stan, apo do vish me mua pas tufës?

— Pas tufës! — u tregua entuziast ai.

Gjithë ditën Çeloja ndoqi tufën e dhive në kullotë, nëpër ca rripa me shkurre e ferra e bar të butë. Beqoja kish merak mos i shpërndareshin dhitë për kërpudha nëpër pyll, prandaj ua preu atë anë me ndihmën e Çelos. Gjatë ditës ata biseduan gjatë e gjerë. Çeloja mori vesh sa fëmijë kishte Beqoja, ku punonin e ku mësonin, sa herë mileshin dhitë, ç'lloj bari pëlqenin, vetëm për motin nuk u ndie gjëkund.

Në mbrëmje, pas mjeljes së tretë të dhive, Beqoja doli nga stani e i erdhi përçark vathës. Çeloja e ndoqi pas. Shikonte horizontin e gjerë përreth, me qiell e yje. Pas lajmeve dëgjuan dhe buletin meteorologjik. Dha kohë të mirë e të qëndrueshme.

— Sonte unë do të fle jashtë, — deklaroi Beqoja, duke marrë velenxën e një gunë në krahë.

— Edhe unë, — e pasoi «shkencëtari», që nuk donte t'i ndahej asnjë hap.

Të nesërmen, po ashtu u nisën bashkë për të kullotur tufën.

— Ku bie vendi i quajtur Gropa e Tezes? — e ngacmoi mësuesi.

Bari nuk i përgjigjej.

— Po për mjegullën në Shpellën e Tomorrit ç'thuhet? Po për oshëtimën e lumit të Zerzelesë? Për vetëtimat e Shkallëzës, apo për rekëtimat e syrit të majtë të grave? — Çeloja vendosi të hapte vetë shtegun, se Beqoja e kishte marrë shtruar dhe as afrohej gjëkund. Po tani s'kishte çfarë të bënte, do të zbërthehej. Kështu mendonte mësuesi.

— Ne kemi shenja të tjera këtej, — dredhoi Beqoja me marifet dhe, kur e pyeti Çeloja cilat qenë, ai i tha se do t'i shihte kur t'u vinte sëra. Pas darke Çeloja bashkë me Temon po rregullonin vendin ku do të flinin, afër vathës. Po shtronin fier e bar të thatë. Beqoja i pa e ai u mendua pak. Tha:

— Sonte flini brenda, çuna, se natën kemi shi.

— Jo, nuk ka shi. Radioja dha kohë të mirë, — ia ktheu mësuesi.

— Mirë, si të doni! — u tha ai dhe vetë u fut në stan. Yjet e shumta tregonin se qielli sipër Lenies nuk kishte asnjë re dhe ata ia këputën gjumit si në shtatë pusët. S'di sa mund të qe ora kur gjëmime e vetëtima të forta nisën të çanin errësirën. Filloi një shi me perona. U zgjuan e hodhën gunat mbi shpinë. Velenxat e batanijet i mbuluan shpejt e shpejt me plastmasë dhe u vunë gurë përsipër që të mos i merrte era.

— Hape derën, Beqo! — i thirri Temoja.

Asnjë lëvizje brenda në stan.

— O Beqo, o Beqo!

Pasi thirrjet nuk arrinin, se i merrte era, Temoja vendosi t'i binte derës me grushta.

— Çfarë keni, more? Pse më zgjoni kaq herët? — pyeti nëpër gjumë e mbyturazi.

— Hape, se u bëmë ujë. Nuk e dëgjon shiun ti? — foli brigadieri.

— Jo, mor jo, nuk është shi. Vetë thatë se do të ketë kohë të mirë natën. . . — foli ngadalë, po derën nuk e hapte.

— Hape, more, se kemi dhe këtë mikun këtu, — i foli Temoja me zë pak më të ulët, me merak se mos dëgjonte Çeloja.

— Atij mikut tani tregoji Gropën e Tezes, nga fryn era e Grykës së Çakallit e si dëgjohet lumi i Zerzelesë. . . — i tha Beqoja. Kur u futën brenda, nuk kishin më vend të terur. Çeloja i pëshpëriti në vesh Temos se duhej të kthehej menjëherë në shtëpi për një punë urgjente. Mirë, tha Temoja, se dhe unë dua të zbres. Çeloja shkoi të përshëndetej me Beqon që po milte dhitë.

— Nga e gjete se mbrëmë do të binte shi? — e pyeti tërë kuriozitet e me të lutur.

Beqoja i bëri shenjë të afrohej e t'ia thoshte në vesh. Si duket, kish merak mos e dëgjonte Temoja.

— Do të prishej koha, se i hante prapanica cja-pit, — foli me zë të ulët dhe qeshi. . . — Të fala shumë të m'i bësh Mediut. Dhe më vjen keq që po ikën. Të kishe ndenjtur sa të numëroheshin muajt a të shikonim kohën në shpatullën e ndonjë ftujaku. Atëherë, plot do ta kishe mbushur atë të flamosur bllok që t'u lag mbrëmë, — i tha duke e përçafuar.

Mbas disa orësh udhëtimi arritën në Misras. Do ti, për fat të tyre, Mediun, Hiqmetin, Kasëmin e perimeve e shumë fshatarë të tjerë i gjetën së bashku. Ishin të gëzuar pas shiut që kish rënë e kish zbukuruar natyrën.

— E, si dole? — e pyeti Mediu. — Dinë shumë

barinjtë për motin. E parashikojnë me një stil tjetër... — e ndërkohë qeshte nën buzë.

— Ç'dreq stil, — protestoi Çeloja, — mua m'u duk me një dërrasë mangët.

Ata shikuan njëri-tjetrin sy më sy.

— Çorba e lirë të djeg buzët, more djalë, — foli një i moshuar.

— Një dërrasë, bën vaki, i mungon kujtdo, — foli Mediu. — Keq është kur mungon një dysHEME e tërë.

SHOKU I DEGËS NGA RRETHI

Nga GAZ-i që sapo u ndal përpara klubit të fshatit zbriti një djalë i ri. Pasi vështroi përreth, me hap të sigurt u drejtua nga roja operative e kooperativës. Nga larg dukej se i këmbyen disa fjalë midis tyre. I porsaardhuri paskësh tundur kokën dhe po kthehej ngadalë, si i menduar, te vendi ku kishte zbritur. Këto i pa mirë, të gjitha, nga dritarja e klubit të fshatit Hajdin Tepeleku. Hajdini vishet me xhaketë e pantallona shajaku kur rri në fshat, kurse, kur merr rrugën e qytetit, ndryshon formë.

Hajdini, ç'është e vërteta, ka mendimin se bën shumë për fshatin e tij. Sidomos merak të madh ka të futet në lidhje, të njihet e mundësisht të miqësohet me gjithë ata që vijnë në fshatin Murriz për ndonjë sebeb a me shërbim. Ja, edhe tani sa zbuloi një të porsaardhur, drejtoi trupin, doli nga klubi, ia nguli vështrimin në fytyrë edhe e uroi:

— Mirë se ardhe në fshatín tonë! — I dha dorën djalit të ri dhe e përqafoi sikur të njiheshin prej kohësh. Pas pak minutash të dy rrinin në tavolinën në fund të klubit. Hajdinit i qeshte tërë pjesa e trupit që i rrinte mbi tavolinë. Gëzimin që kishte sikur donte ta shpërndante në tërë tavolinat e tjera, me vështrimet e përshëndetjet që bënte.

*
* *

Rakia dhe kafet kishin ardhur përpara, sipas porosisë. Të dy kishin nisur një muhabet me zë të ulët, të ëmbël e të butë, si revani me gjalpë mali. Miku pohonte herë pas here me kokë, i qeshur që kishte gjetur një njeri aq mikpritës.

— Domethënë nga dega po vjen, ë?

— Nga dega...

— Po si e kam kryetarin? Shokët, si ia shpien? — vazhdonte Hajdini.

— Mirë! Top janë. Shëndet e të fala cilitdo që pyet për ta.

— Po ti... — shtembëroi pak buzët e drodhi dorën Hajdini, — kur ke filluar aty?

— Këto ditë. Këtu kam shërbimin e parë.

— Bukuri, bukuri! — vazhdoi Hajdini. Dukej që gëzonte i tëri. Duart i mbante të kryqëzuara mbi tavolinë. Sytë e mbyllur përgjysmë me bebëza të zvogëluara, i drejtonte herë pas here nga miku i ri. Apo nuk i zbërthente të tjerët në muhabet e sipër. «Çelës anglez», i pati thënë një mekanik i pikës së SMT-së. Nga kjo anë ia dinte vlerën vetes. Mirëpo sot nuk po i ndizte. Që punon

në degë, u mor vesh. Cili është, nga është? Pse të ketë ardhur në mes të shiut? Mirëpo këto nuk merren vesh aq kollaj e drejtpërdrejt. Këtij mikut i do prerë gjurma larg e larg. I vetëtiu aty për aty një mendim i hollë gjahtari. Ndërkohë porositi dhe dy dopjo të tjera. I porsaardhuri deshi të kundërshtonte. Hajdini e pikasi dhe e qetësoi, duke i treguar shiun përjashta që binte me grykë gjumi.

— E, që the ti, Murrizi është fshati më i bukur i krahinës, — filloi Hajdini.

— Kam dëgjuar!.. Muhabetarë, shakaxhinj, të këngës e të valles! Apo jo? — pyeti i ardhuri.

Hajdini i hapi mirë veshët. «Domethënë ky mi ku e ka studiuar me themel Murrizin, pa shkeli», mendoi.


— Ne nuk e bëjmë kollaj oxhakun buxhak. Dimë ti nderojmë miqtë. Parmbrëmë te Raufi kishte ardhur një mik nga krahina fqinje e Gorës. I zoti i shtëpisë thirri miq, shokë e të afërm. Pa krisi rakia e dollia me katërçind. Raufi la dollibash kushëririn e tij, Izetin. Ti nuk e njeh Izetin. Pa-pa-pa! Si ishte ai! Po do ta njohësh, do ta njohësh dhe do më kujtosh. E, që ta pata fjalën, dolli me njëzetinjë shëndete. Këngë e valle sa të duash... .

— Me një fjalë, e paskeni bërë tym te Raufi, ë? Bre, bre, bre! Po çfarë këngësh këndojnë në këto raste? — pyeti i porsaardhuri. Hajdini mbylli sytë një çast, ngriti kokën në tavan e po mendonte. «Ta kuptova, qerrata, ta kuptova! Këto të interesojnë ty.»

... — Ai gorari si ishte veshur? Me se kishte ardhur? Me makinë apo me kalë?

Hajdini u kapërdi sikur të hante një hurmë të pabërë. I kapi dorën të sapoardhurit, ia shtrëngoi pak e i mbylli synë.

— Të them të drejtën, mora vesh se erdhi me kalë. Si ishte i veshur, nuk e bëj dot nakel, se s'e kam parë akoma, — u përgjigj Hajdini si i zënë në faj.



— Pse, nuk ishe ti në gosti?

Hajdini nuk i ka qejf pyetjet fare. Krojti koken dhe foli.

— Jo, jo! Nuk isha.

— Ëhë!...

— E, që ta pata fjalën, miku ngri shëndete, Kësmeti prit. Pa u vu edhe një ligj që nga anët tona nuk ishte parë ndonjëherë. Të gjitha gotat me plot. Pas tre shëndetesh këngë e valle. — Hajdini pastaj ktheu gotën me fund. Bebet e syve i ishin zvogëluar, maja e hundës po merrte ngjyrë vishnje. — Dyllë, ore, dyllë u kishte shkuar muhabeti. Gorari kishte qenë merakli pas bujqësisë, tanët i kishin përsheshur fjalët për blegtorinë e tufëzat...

— A ndryshon shumë Gora nga veshjet, nga këngët e vallet me krahinën tuaj? — pyeti papritur i sapoardhuri.

«Unë po mundohem të pres gjurmët, ai më vjen rrotull me ato të flamosura pyetje. Të isha vetë në atë mbrëmje, pa do ta shikonin ata! Ç'e do? Nuk u ndodha aty. Se dhe me këngë ngjasin gjëra. Ngjasin dhe nga ato që i duhen degës...», po mendonte Hajdini. U kujtua se ai po priste përgjigje. Si u mbush me frymë, treti shikimin në tavan, u kthye pastaj nga punonjësi i degës dhe foli.

— Edhe gorarët mirë këndojnë..

— Me të thënë e ke edhe këtë? — e pyeti ai.

Jashtë shiu vazhdonte të binte. Pija po i ndihmonte të kapërcenin gjërat që nuk u pëlqenin, qofshin këto lëvdata, gënjeshtra apo pasaktësi që dilnin në muhabet e sipër.



Kishte kaluar mbi një orë që muhabeti i ëmbël vazhdonte fjollë. I porsaardhuri e ktheu me fund, lëshoi një ohohoho të zgjatur, pastaj mbylli sytë, uli vetullat kaleshe sikur po mundohej të kujtonte ndonjë ngjarje nga fëmijëria e hershme.

«Punë të ngatërruar kanë këta të degës», vriste mendjen atë çast Hajdini. Atë kohë ia shpejtoi bashkëbiseduesi:

— A e njeh një bari këtu në Murriz, një Xhevahir? Xhevahir, mbiemrin nuk ia di. . .

«Ja! Tani më duket se po i del koka. E paskan me blegtorinë kësaj here. Kot nuk thonë: «sa e bardhë është delja, aq të zeza ka»! I paska kokolepsur keq punët edhe Xhevua. Tani le t'ia ndiejë lezetin asaj kritikës për Hajdin Tepelekun! Se vallë unë qenkam njeri që nuk futem në shënjestër. Unë po ngatërroj fshaqin, e prishkam unitetin. He! He! Dhe për cilin, pa! Për mua që i njoh njerëzit me dhëmbë e dhëmballë. Di ku i kanë lugët, sa raki bëri secili e sa pastërma mori nga tufëzat. Di sa fasule mblodhën nga arëzat e ku e kanë furrikun pulat! Tani që e paske katrolosur, fol, po ta mbajti. Dhe në sytë e mendjes shpejt e shpejt i kaloi bariu bablok, me gunë e krrabë, me tufën përpara e fyellin në dorë.

— Xhevahirin e njoh mirë, që thua ti! E kemi në lagje.

— Më kanë thënë se ka dhi të mira, — tha punonjësi i rrethit.

— Jo, jo! Xhevahiri që po të them unë, ka dele.

— Për atë Xhevon e deleve më thuaj një herë tjetër çfarë ke, kësaj here mua më duhet ai i dhive, ai që këndon. . .

— Tërë Xhevahirët e fshatit tonë, more xhan, këndojnë. Po pa ma kullo punën ti për cilin nga Xhevahirët interesohesh, se ju të degës ndani qi-men më katërsh e jo mos sitni punën e dy Xhevahirëve. . . — foli Hajdini.

«Çfarë të ketë bërë, mare, shejtani! Apo nuk e kam kushëri të gruas! Të ketë humbur ndonjë dhi? Të ketë shkelur diku? Mos i ka dhënë ndonjërit keca nga dyjarët? Se ndodhi aty njëditëzaj. Mos ka thartuar qumështin në bidona! Nuk u marrka vesh ku i shtie dyfeku këtij të riut.» Dhe Hajdini ynë ku nuk e çonte mendjen.

— Xhevahiri i dhive, ta marrësh vesh ti, është bari për kokën e bariut. Njeri i shtruar, punëtor, pa fjalë, njerëzit si ai janë të rrallë në kooperativën tonë. Po ku e paska shkelur, more, firauni? — pyeti duke i shkelur syrin Hajdini.

Punonjësi i degës u mbështet me bërryl nga ana e bashkëbiseduesit. Hajdini afroi kokën me veshët pipëz.

— Çfarë gune mban Xhevahiri, larë apo të çilme? — e rremetisi me një pyetje tjetër ai i degës.

«Hej drej! Tek Xhevoja mbeti ky. Nuk po marr vesh ku i pikon çatia! Te dhitë a te njerëzit. Ku e ka hallin? Te fjalët e thëna në muhabete apo te këngët? Se edhe me këngë lëshohen ca rromuze ndonjëherë, që të bën zarar mendja», mendonte tërë merak Hajdini.

— Mora vesh se së shpejti keni 30-vjetorin e krijimit të kooperativës. Si venë përgatitjet për festë? — pyeti miku.

Hajdini hapi sytë dhe po e shikonte i trallisur. Nuk po orientohej se ku do të dilte ai me këto pyetje.

— Ai Xhevahiri, bariu i dhive, këndon mirë, hë? Po fyellit si i bie, më qafsh! — vazhdonte të pyeste punonjësi i degës.

— Fyellin e këngën e qan ai, po ku do të dalësh? Fol hapur, — e luti Hajdini.

— Në koncertin që do të jepet, mendojmë të jetë dhe Xhevahiri. Ndaj kam ardhur, ta dëgjoj. I dalluar me dhi, i dalluar në këngë... — fliste me entuziazëm i porsaardhuri.

— Ç'punë keni ju me koncertin? — rrudhi buzët Hajdin Tepeleku.

Këtë herë u habit i porsaardhuri.

— Si ç'punë kemi? Po ne të degës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve na e kanë ngarkuar si gjithmonë, — dha shkoqitje të hollësishme i porsaardhuri.

Hajdini sa nuk kërceu përpjetë. Ndjeu se po e shponin gjilpëra e fytyra i digjte nga bulëza të imta djerse. U ngrit.

— Ama nuk qenke i asaj degës tjetër ti?...

Gjithë ajo kohë tani po i dukej e humbur dhe i vinte ta shante të porsaardhurin me degë e me rrënjë e po ashtu dhe veten. Nga hutimi harroi t'i jepte dhe dorën punonjësit të sapoardhur nga rrethi. Doli jashtë duke turfulluar.

KU PUNON KY SHOKU?

Salla ku ishte mbledhur aktivi ekonomik për ndihmë fshatit, qe mbushur plot e përplot. Sa

dëgjoi emrin e vet nga shoku që drejtonte seancën, njeriu i kollarisur u ngrit nga vendi dhe me hap të sigurt ngjiti shkallët e podiumit. Pamja e re i shpalos përballë. Ja, rreshtat e parë, plateja, lozhat. Të gjitha karriget të zëna me këshilltarë, specialistë, punonjës, kuadro. Kishte të zgjedhur dhe të ftuar. Një fotograf e një telekronist lëviznin ngadalë për të zgjedhur pikat më të mira të marrjeve.

Dritat e sallës e të aparatit të xhirimit i krijuan një moment hutimi. Duke shpalosur letrat gjysmë format e duke drejtuar pak mikrofonin, arriti vonesën që i duhej për të tërhequr plotësisht vëmendjen e dëgjuesve. «Përvoja të nxjerr faqebardhë», mendonte atë çast njeriu i kollorisur. Pastaj filloi ligjëratën e vet me një deklaratë:

— Do t'i bie drejt e shkurt, shokë! Po ndalem në dy-tre probleme që mendoj se në rreth i kemi objektivisht e realisht. — Në sallë u ndien lëvizje karrigesh. U duk sikur njerëzve u ishte dhënë komanda të shpinin gjymtyrët. Njeriu i kollarisur hodhi sytë në tavanin e sallës së madhe, pastaj mbi letrat në podium. nga e djathta.

— Më mirë po flas pa letër fare. Problemet që do të ngre, janë të thjeshta dhe i kam të qarta, kristal. . .

— Mirë do të bësh! — u dëgjuan zëra nga presidiumi dhe salla.

— Të grumbullosh e të blesh çfarë prodhohet në fshat ose në kooperativë, nuk është një problem

i thjeshtë. Unë pyetjen e shtroj kështu: Së pari, a marrim çfarë ka tepër fshati? Së dyti, si i marrim ato që prodhon fshati dhe së treti e së fundi, çfarë merr fshati nga ne?

Në radhën e dytë të platesë ishin ulur pranë njëri-tjetrit Kiçoja këshilltari më i vjetër, dhe Avniu, këshilltari më i ri. Avniu e shtyn Kiçon dhe i flet me zë të ulët:

— E nisi mirë, po më pëlqen.

Diskutanti vazhdonte.

— Për analizën e këtij trinomi kompleks do të jap disa mendime konkrete. — Në sallë u ndien pëshpëritje admirimi. — Çfarë prodhohet në fshat, lipsen edhe në qytet. Rruga e furnizimit të qytetit kalon nga fshati, ka thënë një mendje e ndritur. Ndaj, me këtë rast, i jap një përgjigje të formës së prerë problemit se qytetit i takon të grumbullojë e të blejë nga fshati çdo gjë që i ofrohet. Kjo, shokë, është jo vetëm themelore, por edhe parimore. . . Për të argumentuar se është plotësisht kështu, nuk po ndalem. — Këtu njeriu i kollarisur bëri një pauzë, mori frymë thellë dhe hodhi vështrimin në sallë.

— Po a marrim ne çfarë ka fshati? Ja! Kjo pyetje sa e thjeshtë në dukje, aq e ndërlikuar është në zgjidhje. T'i biem drejt. Në bujqësi mbeten shumë prodhime pa tërhequr. Se ka fshati, ka shumë. Nga drithërat te fshesa e kungulli, nga hudhurat e njoma, te gorrica ficet, nga fleta e ferrës fruktikoza deri te lulja e fruti i murrizit apo i shtogut. Po sa zëra mbetën pa u realizuar, do thoni ju? Shumë. Po sa bëjnë, do të thoni ju? Shumë. Miliona. Po pse mbeten, do të thoni ju?

Për mosinteresim të dyanshëm. Ja, kjo është e gjitha! — U koll dhe filloi rishtas.

— Si konkluzion, para se të kalojmë në problemin e dytë, del se në fshat lëmë mjaft artikuj pa grumbulluar, — i vuri kapakun problemit diskutanti.

— Këto probleme sot janë nëpër këmbë në çdo fshat. — përshpëriti këshilltari i ri. Këtoja pohoi me kokë, buzagaz.

— Si i marrim ne ato që prodhon fshati? — vazhdoi diskutanti. — Kjo mendoj se është ana më themelore e problemit, shtruar për zgjidhje. Mos shkojmë larg, të ndalemi te drithërat e bukës. Vetëm nga një për qind lagështirë më tepër, kooperativat humbasin me mijëra lekë. Me një për qind lëndë të huaj mbi standardin, bëhet nami. Gruri dorëzohet i përzier, i forti me të butin. Kur bëhet kështu, nuk del as miell për bakllava, as për makarona të mira. Po a e dini ju, more shokë, sa humbasin kooperativat nga këto avaze? Me mijëra. E bëjmë si ai që humbiste në vaj e fitonte në presh. — Tani oratori e ndjeu se po e zotëronte gjithë sallën.

— Po me duhanin e dini ç'bëhet?

Avniu përsëri i thotë shokut të vet me zë të ulët:

— Hë, këtu më rri. Thashë se do t'i shpëtonte, po e kapi qerratai! Ne si brigadë po digjemi nga vlerësimi i duhanit.

— Nuk thonë kot se duhani do trembëdhjetë muaj punë në vit. Mirëpo e dini si dorëzohet? Jo, nuk e dini! Ia japim për transport kooperativistit të parë që gjejmë në rrugë. Këtë e bëjmë

— Sikur paska parë fshehurazi brigadën to-

në, — i pëshpëriti këshilltarit të vjetër Avniu.

— Kjo është ana sasiore e problemit. Po cilësorja, do pyesni ju? Po jua them shkurt: Çdo teknik duhanin që fut në depo e klasifikon më ulët se ç'është në të vërtetë. A ka fakte për këtë pohim? Çdo vit uzina e fermentimit të duhanit i kthen grumbullimit mijëra lekë nga rivlerësimi i duhanit. Thoni po të doni se vlerësohet prona e grupit! — Operatori u kapërdi. Arrëza bëri një lëvizje aq sa e lejonte kollarja e përsëri shkoi në vend. Në sallë mbretëronte qetësia.

— Do të them dy fjalë edhe për blegtorinë. Ehu! Sa borxhe i kemi ne asaj! Dhe a e dini, more shokë, se kush e ha i pari? Qumështi! Pse, si kujtoni ju? Vërtet aq e ka yndyrën, sa thotë e shkruan baxhaxhiu? Jo, më thertë mua! Po që se kafshari vonohet dhjetë minuta, qumështi merrret jashtë standardit, blihet me gjysmë çmimi, por në fakt vlerat i ka të plota... — Diskutanti vështrimin e treti në fasadën përballë.

— Pse nuk e vënë përgjegjës të seksionit të kontrollit këtë njeri, po lënë Xhezairin? — pyeti me zë të ulët këshilltari i ri. Këto nuk i ktheu përgjigje. Njeriu i kollarisur krojti zërin e vazhdoi:

— Blerja e grumbullimi i bagëtive, shokë, është një histori tjetër, — u hodh ai në një kapitull tjetër. — Rrezja e mishit është në dorë të një njeriu. Mos shkojmë larg, në më lejoni, pyesim sallën: A kini ngrënë ndonjëherë mish viçi të kualitetit të parë? Po mish dashi, cjapi e qengji të parë? Me siguri që po. Dhe nuk ka diskutim se ju ka pëlqyer shumë. Po a e dini se prej dy vjetësh në Grumbullim nuk është marrë asnjë

lëkurë e cilësisë së parë e të dytë? A mund ta pranojmë një paradoks të tillë? Del se bagëtitë e rrethit tonë mishin e kanë të cilësisë së parë, kurse lëkurën të tretë. — Në sallë shpërthyen murmurima e të qeshura. Një shok nga presidiumi i ra me stilolaps tryezës.

— E thau fare! Ky qenka enciklopedist. Nuk kam dëgjuar diskutim kaq konkret dhe pa letër, — i tha Avniu kolegut të vet. Diskutanti bëri një kollitje të thatë dyshe, krojti zërin mirë e mirë dhe ndali një çast. Tashti e ndiente fare mirë se i kishte rënë sqepi në mjaltë.

— Tani po kaloj shkurt në problemin e tretë...

Mirëpo fjalën nuk e sosi dot. Një i paduruar shkëlmoi rregullat dhe u ngrit në këmbë.

— Me leje? Unë kam një pyetje, — foli një djalosh i ri rreth të njëzetave. Si duket, ishte hera e parë që merrte pjesë në mbledhje të tilla.

— Urdhëro, — iu drejtua djaloshit ai që drejtonte seancën.

— Na thoni, ju lutem, ku punon ky shoku?

— Ke të drejtë! — u dëgjua një zë i fortë dhe i qartë nga një shok i presidiumit. — Ky shoku ka qenë zëvendësdrejtor i Grumbullimit deri para pak kohësh. E shkurtuan si hallkë e tepërt. Tani punon në...

— A është autokritikë kjo që po bën sot, apo do t'i nxjerrë bojën ndërmarrjes ku ka qenë? — pyeti i riu.

Njeriu i kollarisur mblodhi fletët e diskutimit.

— Tani e mora vesh pse nuk më ktheje përgjigje! — foli Avniu.

— Thesi bosh nuk qëndron në këmbë! — iu përgjigj Kiçoja.

AH, KËTA ARINJTË!

Skuastra jonë «Bliri» dhe ajo e një rrethi bregdetar që kishim afër, po shkonin në kullotat alpine të Gurit të Topit. Mbasi ngjitën maloren e fundit tërë kthesa, ato dolën në një qafë mali, që nga dukej si në pëllëmbë të dorës fshati më skajor i rrethit tonë. Autobusët e vegjël vazhdonin rrugën bosh, kurse futbollistët ecnin më këmbë, për të shijuar më mirë panoramën në atë lartësi mbi 1800 metra.

Tare Shelegu dhe unë ecnim prapa tyre. I kishim ndjekur e shoqëruar në ditët më të vështira të kampionatit e tani donin të soditnin nga afër stërvitjen e tyre në klimë malore. Tare Shelegu, shoku im, pohonte se shëndetit tonë do t'i sillte dobi ajo klimë dhe ai lloj pushimi. Trainerët dhe drejtuesit e kishin zgjedhur vendin me shije të rrallë. Besoj se «Bliri» ynë do të linte nam e do të dilte nga kategoria e tretë. Gjithë shpresat i kishim te qendërsulmuesi, Mjamulli, te mesfushori Lajthiza dhe te portieri Dredhëza!

— Ai Mjamulli juaj, Veliko, — më thotë Sala para nisjes, — ka qenë shumë i zënë kohët e fundit. Po stërvitet me të mbesën e shokut Çano. Nuk ka më kohë për futbollin ai...

Nuk i zura besë. Ehu, sa thonë bota...

*
* *

Papritur Tarja ngadalësoi hapin duke vështruar poshtë tarracave grumbullin e njerëzve afër një shkëmbi të madh. Aty ishin mbledhur sportistët e të dyja skuadrave kokë më kokë, si atëherë kur formohet muri mbrojtës para portës. Pas tyre dalluam një park bletësh dhe një burrë me kapelë e maskë në fytyrë. Bletërritësi pas-tronte dyert e zogjve nga disa bletë.

— Meshkujt duhen hequr, — po u thoshte sportistëve.

— Po jashtu nuk mbeten bletët vejusha? — e pyeti portieri ynë Dredhëza. Tekniku shtypi njëherësh dy meshkuj në dërrasën e gurtë.

— Këta, more çuna, janë parazitë. Vetëm një duhet, sa për të bërë fluturimin e martesës me mbretëreshën, të tjerët i ke vetëm për të llupur mjaltë. As ju nuk i futni të gjithë në lojë... — Bletërritësi e lidhi bisedën me sportin.

— Ndaj kemi stolin e rezervave, — i shpjegoi treneri i «Blirit», si më i brendshmi midis miqve dhe vendasve.

— Po më tej stolit, bën vaki të keni vende? — pyeti bletërritësi.

— Kemi dhe ne brumbujt tanë, — ia ktheu me të qeshur qendërsulmuesi ynë. Mua dhe Tares na ra të kuqtë e piperit.

— Nuk bëjnë të gjitha mizat mjaltë, çunat! Këtë e dinë edhe trenerët tuaj...

— Veç brumbullit, kush e dëmton mjaltin? — pyeti një futbollist i «Dafinës».

— Ariu e ka shumë qejf. Ndaj detyrohem

të mbaj edhe qen këtu, — tha ai, duke drejtuar dorashkën atje nën hijen e murrizit ku po qëndronte kutullaç një goxha murro.

— Pse, ka arinj këtej? — u interesuan dy-tre futbollistë njëherësh.

— Po, edhe ka. Dalin nga ahishtet e pishat dhe shullëhen si qetë e punës edhe ditën. Do t'i shikoni ju, do t'i shikoni! Arinjtë e këtyre anëve janë më të mëdhenj se ata të kopshtit zoologjik të Tiranës, — tha bletërritësi si njeri kompetent.



Kampingu që vendosur në rrëzë të Gurit të Topit. U ngritën çadrat, kuzhina, po sistemohej fusha e stërvitjes. Aty edhe Tarja edhe unë dhamë ndihmesën tonë për të ngulur shtyllat e portës, se ajo puna e brumbujve na kishte djegur fort. Pasdite, pranë miqve të rinj çatisën barinj, kafsharë e druvarë e filloi një muhabet i ëmbël që s'e kishin dëgjuar kurrë ato livadhe.

— A ka ujë këtyre anëve? — pyeti ndihmëstraineri i «Dafinës».

— Ëhë! Ujku i humbi fara. Të merr malli të shohësh një sa për farë, — foli një bari i ri. — Është shtuar shumë ariu, — tha së fundi ai.

— Po njeriun e trazon ariu? — u interesua portier Dredhëza e po priste përgjigje gojëhapur.

— Po edhe e ngacmon, se mos e ka kushëri! ...

— Njëherë, një bariu që po u çonte fruta e perime të freskëta shokëve, ja, atje matanë e

zuri arusha, ia mori shportën dhe e rrahu paq...

— Pse, harrove bariun e qeve ti? Atij të gjori i ndrydhi keq një këmbë, se e vuri poshtë...

— Aty, njëditëzaj, në atë gropën atje përtej, — tregonte me dorë një kafshar, — ariu mbyti mëzin e Selimit...

— Para një jave u kishte ardhur rrotull bletëve të Pyjores, atje te shkëmbi, po e kishte përzënë qeni... — tha një bari i moshuar, i mbështetur mbi kërrabë.

— Janë shumë. Se mos janë një e dy, — ia priti tjetri.

— Dje i kishte trembur kalin çunit tim, — u hodh e foli një kafshar qumështi.

Muhabeti me arinj, arusha e të pjellët e tyre vazhdonte. Arinjtë po hynin natyrshëm në atë copëz jete që sportistët sapo kishin filluar. Jo si lojtarë e si arbitra, as si nëpër përralla, ku janë babaxhanë dhe mbrojtës të së drejtës. Në atë lartësi soji i tyre dilte se e kishte prishur biografinë. Më pas, kur dita po ia linte vendin natës, mendimet për ariun zienin në kokat e tyre.

— Po sikur të hyjë në kamping, ç'bëhet? — pyeti mesfushori rezervë i «Blirit», Agushi, duke e shfaqur ashiqare shqetësimin që ndihej në futbollistët e të dyja skuadrave.

— Mos ardhhtë, o byrazer! Po erdhi, do kurban ai! E ke dëgjuar shprehjen «nuk ngopet ariu as me dredhëza e as me miza»? Po hyri në kampingun tonë, e ka vetë merak inventarin e çadrave ai babaxhani! — e vazhdoi bisedën qendërsulmuesi Mjamulli.

Të dy trainerët e kuptuan se çështja e ariut po bëhej mjaft shqetësuese. Miçoja, treneri i

«Blirit», si më i shkathët, e ndjeu të nevojshme t'i qetësonte.

— Ne do të vazhdojmë jetën dhe stërvitjen



normalisht. Nuk të bën gjë ariu, më dëgjoni mua. Le që ne nuk dimë a ka a nuk ka arinj! Pastaj, më thoni, ju lutem, kush e ka pësuar nga ariu? Nuk i shihni ju tufat dhe stanet këndeje rrotull? Ata si . . . — Mirëpo nuk qe e thënë që Miçoja të soste fjalën, se poshtë luginës u ndien të lehura qensh.

— Pse po lehin qentë? — pyeti një futbollist i skuadrës mike.

— Kushedi se çfarë ndjekin, — ia pati Beqoja, kuzhinieri. . . — Ujk nuk ndjekin, se nga ata s'ka. Ju i dëgjuat barinjtë.

— Me siguri, xhaxha ariun kanë vënë përpara. — hamendësoi një futbollist i «Blirit».

Nata ra shpejt në kampin e sapokrijuar. Darka nën dritën e zjarrit e të fenerëve pranë zjarrit bubulak na shijoi të gjithëve.

— Përgatitja fizike, ta dini, kërkon disiplinën e ushtarit dhe regjimin e të sëmurit, — u vuri kapakun udhëzimeve treneri i «Dafinës». Ia pata zili gojëtarisë së tij dhe, desha s'desha, e krahasova me Miçon tonë.



Më pëlqeu kur pashë si po vëllazëroheshin sportistët në një çadër të madhe katërshe. Bashkë me Mjamullin e Dardhën e «Blirit», flinin edhe dy futbollistë të «Dafinës». Sa filloi të gërhinte Tare Shelegu, gjumi im u bë firar. M'u shkrep të dilja njëherë rreth e rrotull, të mbushja mushkëritë me ajër të pastër. Bëra një copë herë muhabet me Beqon, kuzhinierin, pastaj u nisa të

shtrihesha, se sikur ndjeva gjumë. Papritur në çadrën fqinje u ndez diskutimi. Zërat dilnin të qartë dhe dëgjoheshin deri larg.

— Tek «Dafina» mua nuk më zëvendëson njeri, — thoshte njëri. — Kot na sikterisën deri në këto lartësi. Kush i kalon njëzet ditë këtu! Ishim bukuri në Golem. Plazhi te dera... Sapo isha njohur dhe me një vajzë... ¶

— Mos ia lëndo atë plagë Mjamullit tonë të gjorë, — ky duhej të qe portieri ynë, Dredhëza. — Sapo filloi të cicëronte me mbesën e shokut Çano. Ta shohësh atë si është! Pastaj, ky qendër sulmuesi ynë, si me stërvitje, dhe pa stërvitje, aq jep. Për ta zëvendësuar, as që bëhet fjalë, derisa e mbajnë si më të mirin.

— Lëre, lëre. Na theri kjo stërvitje. Kujt i shkoi ndër mend, djalli e mori... — ia priti një nga ata të Bregdetit.

— Çdo sëmundje e ka një ilaç. — Duhej të qe Agushi.

— Mirë e ke. Këta arinjtë rrofshin e qofshin. Më duket se do të na e presin në mes stërvitjen. Po erdhën në kamp, ta dish, unë e mora rrugën, — njoha zërin e Mjamullit.

— Edhe unë atë mendje kam. Po nuk di rru-gën dhe nuk gjej shok, — pasoi Agushi.

— Të gjithë pas na ke, — ndërhyri Dredhëza. — U dashka të stërvitemi në lartësi! Se mos do ndeshemi në Meksiko e Kuito... .

Tek i dëgjoja, e ndieja se po më pushtonte inati për gjithë atë rrugë që kisha marrë. Nuk ndenia më gjatë. u futa në cadër pranë Tares, dhe u betova: «Veç mos u gdhiftë dita, se i kam dy fjalë me trainerët...»

Më kishte mbërthyer gjumi i parë. Po shikoja dhe një ëndërr të bukur, dhe do ta kisha sosur sikur Tare Shelegu të mos më kishte zgjuar. Zhurmë e zallamahi jashtë. Disa futbollistë kishin mbërthyer nga një urë zjarri dhe ata më guximtarët qenë sulur si nja pesëdhjetë metra tutje çadrave, duke shikuar vazhdimisht prapa, që, kur të ktheheshin, mos i pengonte gjë.

Pas pak zhurmat u shuan.

— Ju lumtë! E përzutë qafirin! Le të vijë, po ia mbajti. — Traineri i «Blirit» po përgëzonte sportistët më trima.

Kampi ra në qetësi dhe gjumi rëndoi përsëri qepallat e sportistëve. Nuk di sa kohë kisha fjetur, kur rrzëzë veshit, prapa çadrës sonë ndjeva një zhurmë, krap, krap, krap, krap, sikur dikush po brente kocka apo kore buke të fortë. Prita me ankth se çfarë do të ndodhte. Zhurma veç afrohej. Një goditje si tokmak rrzëzë çadrës, dy, tri goditje të tokës. Sokëllimë. Nuk prita më. Dy duar për një kokë janë. . .

— Çohu, Tare, se na bëri pelte ariu! — i thirra shokut.

Ndërkohë kushtrimi në të dhjetë çadrat qe dhënë i plotë.

Përsëri ura zjarri, sa sheshi para nesh u bë prush fare. Thellë në errësirë, afër pyllit, më në fund dëgjuam zërin e një kali që hingëllinte i ngjirur e i hazdisur.

— Flini tani, se sonte e pagoi kali për ne, — tha një futbollist i «Dafinës».

I lodhur, u shtriva sërish. Po a fronte agimi. Ajri i freskët që hynte në çadër, sillte edhe copëza bisede që vinin nga jashtë.

— Një rrurëz më ka humbur, e flamosura!
— dëgjoja një zë që nuk e njihja.

— E çfarë deshi rrurëza këtu? — m'u duk si zëri i Tare Shelegut. Pashë krevatin e tij portativ. Bosh fare. E mora me mend se kishte dalë jashtë e po sqaronte bariun e rrurëzave. Dola dhe unë. — Ata shokët tuaj shumë shpejt vraponin natën. Tre dëllinja njëherësh i kërcenin! Dhe me çanta në krah! — shfaqti habinë e vet bariu.

— Cilët shokë? — e pyetëm të dy njëzëri.

— Ata, sportistët, cilët! Po me kalin e Begzanës ç'patën? Ajo e gjora e pati lënë pranë staneve të shëndoshej. Ia kishin përzhitur lëkurën me ura zjarri. Pse, lodra janë këto? — fliste bariu duke ikur.

Disa çadra ishin shkrehur. Dukej sikur kishte përfunduar një betejë e vërtetë.

Kuzhinieri pastaj na sqaroi gjithëka kish ndodhur pas alarmit të parë. Beqoja kishte shtrënguar zjarrin, se donte të bënte pilaf. Mori një urë në dorë për të ndezur zjarrin e dytë për çajin. Ajo i ra në shesh duke lëshuar prush e shkëndija sa kish ndriçuar kampingun. Papritur u dëgjua një kushtrim: «Çohuni, çuna, se na dogji ariu të gjallë!

Pastaj giurulldinë më të madhe e kishte bërë Mjamulli ynë dhe Orakulli i «Dafinës». Rrëmbyen çantat, tutat, dhe therën tatëpjetë.

*
* *
*

U pa puna. Duhej marrë rruga e kthimit. Hajde të dëgjoje tifozët tanë për turmën në mal.

Pa u futur ende në të tatëpjetën e madhe, hodhëm sytë edhe një herë nga Grabova. Nga larg një njeri po afrohej duke na bërë shenjë me dorë. E pritëm. Qe bletërritësi. Na shikonte të dy dhe një fije buzëqeshje i endej në buzë.

— Ç'është kështu me ju? — na u drejtua.
— Më parë ikët se erdhët. Nuk e ngjyet së paku një herë gishtin në mjaltë, pale! Ju thashë unë që dje: nuk bëjnë të gjitha mizat mjaltë!

NUK ËSHTË BIMË DEKORATIVE

«Edhe ti, tamam ashtu si kushërinjtë e tu të largët, ka të ngjarë, të na jesh futur si bimë zbu-kurimi. Pastaj dihet se si u bë. Zaptove arat, mu-llinjtë, tregun, furrat.»

Këto imagjinoja duke dëgjuar shpjegimet e mësuesit të botanikës për misrin, në shkollën e mesme pa shkëputje nga puna. Milto Matraku më mirë se lëndën dinte historinë e përhapjes së bimëve dhe të farnave dhe i tregonte me kaq pasion, sa na rrëmbente të gjithë.

Me sytë e mendjes përfytyroja kënaqësinë e ambasadorit të Francës në Spanjë, mësje Nikos, i cili e futi duhanin në vendin e tii si bimë zbu-kuruese e kurative çudibërëse. Kur Miltoja shpjegonte nga pak fiziologji bimësh, unë kullosja mendjen se si do të ketë qenë ai kopshtari i zgjuar francez që thuri me gardhe e tela me gie-mba arën e vet të mbjellë me... patate! Vjedhja e patateve në atë arë, thonë, u bë faktori kryesor i përhapjes së kësaj kulture. Miltoja pyeste: «A

më kuptoni?»», ndërsa mua në atë kohë më shfaqej në mur, paksa përmbi dërrasën e zezë, një sulltan turk që nxori ferman t'u priste hundën dhe veshët njerëzve që pinin duhan. Po te ne kur u fut duhani dhe kush e solli? Me siguri, mendoja, ai do të ketë hyrë përpara patates, domates e misrit. E para del pija, pastaj mezja. Kështu, si zot shtëpie, ka pritur mysafirët e tjerë që erdhën nga kontinenti i ri.



Këto m'u kujtuan sërish një ditë dhjetori me shi, në një hangar duhani bosh, ku agronomi i ri po zhvillonte një bisedë për misrin me brigadën tonë. Nuk do t'u ha racionin botanistëve, agronomëve të bimëve të arave e specialistëve tanë të nderuar të misrit e orizit në Shkodër për këtë kulturë. Me misrin unë kam lidhje të tjera më të forta e më intime, se ai u bë sepse edhe për ndryshimin e gjendjes time civile. Ndaj, kudo që bie fjala për të, nuk ka si mos kujtoj atë ditë...

Sa mbarova ushtrinë, u paraqita në punë, drejt e në brigadë. Gjatë kohës së shërbimit kishin ndodhur disa ndryshime. Vajzat që i kisha lënë më të vogla, ishin rritur e më dukeshin sikur ishin pak më të bymyera, siç ndodh me sythat e pemëve në prag pranvere. Në fytyrë u qeshte shëndeti. Këtë e vija re në tërë qenien e Dritës. Buzët e saj tani kishin marrë një ngjyrë rozë të çelët.

Kur ika ushtar, Drita vazhdonte shkollën e mesme pa shkëputje nga puna. Tani e kishte marrë diplomën. Siç mban bleta matkën, ashtu

e mbanin edhe shoqet. Kur fliste ajo në brigadë, fjala i ngjiste. Dhe erdhi një ditë, e zgjodhëm brigadiere. «Tani e gjeti puna të zonë!» i jepnin gojës disa. Kapoja atë ditë na tha: «U pjekshim për të mira me brigadierin që na la shëndenë. Shokë, na iku lisi me gjithë hije.»

Shpirt njeriu ka qenë Azemi. E kujt i pati prishur qejfin? Të gjithë na pati nginjur me ditë pune. Detyrat vërtet nuk realizoheshin, por se mos ishim të vetmit që s'i arrinim. Dalëngadalë mësova se dy-tre shokët e mi kishin qenë krahu i djathtë i Azemit. Shtabi i brigadës s'qe gjë para tyre! Një herë ua bënte me sy brigadieri e ata e kishin marrë vesh me kohë se në cilën qafë do të dilnin.

Hamiti kishte mendim tjetër për brigadieren e re. «Do të bëjë nga do të bëjë, në brazdë do të bjerë dhe kjo», u shpreh ai. Mirëpo Dritës «mirë-mëngjes» në arë i thoshim ne. Kishim qejf të na thoshte ajo, po ku na linte ai i flamosur gjumë! Kësisoj, nuk po merrej vesh ku ishin brazdat e kush do të binte në to.» Ah, more byrazerë, nisi të flasë njëherë Kapoja. Ku i patëm mendtë atë ditë! Të propozosh e të zgjedhësh brigadiere një grua, është zarar i kokës. A e pi duhanin? Jo! A shtrohet në raki e në dolli fshatçe? Jo! Ndaj, po ngrite dorën të votosh për të, mendohu mirë, se të kërcet kurrizi më tutje.»



Azemi qe i thekur për muhabet. Apo s'i kishte qejf qyfyret e gazmoret! Kurse Drita fjalët

I ka të shkurtra dhe ditën e punës të gjatë. Na hapi telash të madh dhe ai Servet Kosiqi i Dibrës. Drita, sa u kthye nga Maqellara, i kllaposi në një bllok zotimet tona, emër për emër, dhe na i kujtonte për javë, pa bërë asnjë lëshim. «Iku ajo kohë kur në brigadë kishte dymbëdhjetë pleq e trembëdhjetë çibukë! Apo jo. Mane?» më drejtohej mua. Sa herë këmbenim dy fjalë bashkë, më shkonnin mornica nga majat e flokëve te thonjtë e këmbëve.

Sa për vete, dihet, e kisha hallin ndryshe, prandaj, kur kapja shatin, e zinte zerzoleja, siç thonë në anët tona. Në perëndim të diellit, hidhja sytë prapa të soditja ç'kisha bërë. Mbushesha me frymë e gaz për mbarësinë e ditës, po nuk qe e thënë të gëzohesha gjatë. Vinte Drita dhe ëmbël-ëmbël thoshte: «Që këtu e deri këtu do ta bësh edhe një herë, Mane! Nuk e ke prashitur mirë. Nesër ta mat.» Ajo largohej me gaz në buzë, unë bëhesha dushk e helm. Njëherë i rrëmbeu kazmën çekgjatë Kapos dhe iu fut punës vetë. «Kështu e do misri. Uleni kurrizin! Nuk është himë dekorative ai... Dhe dëgjo ti, shoku Kapo! Me kaq punë, nuk mbahet shtëpia. Kam marrë vesh se po vjen vërdallë edhe për nuse, pale!» Pastaj, me lezet, i hodhi sytë nga Nafija që punonte pak më tutje e veshët i mbante pipëz.

Kapoja doli më kurajoz se unë. Si pa u ndier po veçohej nga shoqëria dhe çoku përcillte Nafijen buzë mbrëmjeve.

— E! — i them një ditë Dritës. — Po çiftohen bota.

Qeshi dhe ma drodhi përgjigjen shejtania.

— Ti shiko t'i mbash zotimet, se je hala tek



ura. Je nga lagjja e Samit Çairit ti! Samiti në kohën e tij mbillte misër e korrte tallë... — vazhdonte të më shigjetonte brigadierja.

Kështu, edhe asaj here, nuk këmbeva fjalët që më gurgullonin brenda. Kur filloi ujitja, Drita na mblodhi nën një hije dhe na e preu në kërcu.

— Do t'i shtroheni punës ju? Këtë më shkoqitni. Nuk do të dijë misri se paska Mondial futbollit, kupa e stërkupa. Më rrini tërë natën në televizor e tërë ditën mërzeni si demat e Zelos, duke ujitur. Ndodhi ç'ndodhi, e lëmë me kaq, se ujitja nuk është leje pushimi dhe as festë për brigadën. Apo jo, Mane?

Mbeta mes dy zjarresh. Në një anë qëndronte Drita, plot shëndet e buzagaz. Edhe pse nuk lëshonte pe gjëkund, kurmi i rrezatonte disa si valë të pakuptueshme që syri im i kapte si radar. Tamam si radari ku kisha kryer shërbimin ushtarak. Në anën tjetër misri, dy bojë burri i lartë, donte ujë. Shumë thonë se ujitja është e lehtë, po ec e pyet të vuajturin. Koka të piqet në diell e këmbët akull në ujë e baltë.

Pasdite kisha marrë një deng me fier në krah dhe po ecja ledhit. Dëgjova këmbë pas meje. Pastaj një zë të njohur që më piku në zemër.

— Po atë fier ç'e do? Mos ke ndër mend të shtrohesh natën si në jatak e të bësh ndonjë sy gjumë?

Mora guxim e ia prita.

— Ku vjen i ziu gjumë kur të mendoj ty...!
— Ndjeva se u skuqta deri në maja të veshëve e sepse më pushtuan dridhjet.

— Jo, more! Ke kohë kështu? — pyeti ajo.

— Nuk do të vish të më kontrollosh ujitjen sonte? Duket, ti s'e di si ujitet me fier, sado që ke qenë edhe në Dibër... — e ngacmova. Ajo u skuq dhe u hutua. Aq desha unë. Lashë fierin e shatin e i kapa duart. Për një çast po e haja me sy.

— Mos, Mane! Mos se na shohin bota, — foli dhe sytë nuk i ngrinte.

— Unë të dua, Drita! Dhe ta dish, po nuk të mora ty, ia bëra një cen vetes. Ndaj mos më mundo... — dëgjova zërin tim krejt të ndryshuar dhe e pushtova nga mesi. Fytyrat tona u afruan.

— Jemi në mes të fushës, Mane! Lërmë tani E jotja jam, çdo më... — pëshpëriti e mezi u shkëput nga unë. E pashë se fytyra i qe bërë lulëkuqe.

Sa u largua pak, më tha:

— Në këtë brigadë nuk ke për të qëndruar më!

Unë ia prita:

— Pse, nuk e lejon statuti burrë e grua në një brigadë?

Ajo qeshi, përshëndeti me dorë dhe me hapin e lehtë e të shpejtë si kaprolli po largohej tej.

— Shko ujit tani, se po afrohen dhe shokët, — tha së fundi.

— Ah! Të ujitur që do bëj! — i fola së largu.

— Prit mblesët në shtëpi këto ditë, — ngrita zërin.

— Aman! Të mbarojë fushata, Mane! — foli me përgjërim.

Eh, more misër, vërtet nuk je bimë dekorative!

KUR KRITIKOHEJ NJË PËRGJEGJËS SEKTORI

Shqyrtohej materiali i kontrollit kompleks në sektorin e Dushkut. Si u siguruan se pyetje nuk kishte, kaluan në diskutime. I pari e mori fjalën Emmini, përgjegjës i sektorit. Duhej marrë fjala, se materiali nga fillimi në fund lakonte emrin e tij.

— A kemi pasur të meta? Nuk them jo. Kemi pasur dhe kemi, se, të hash bukë, do të bësh edhe thërrime. Po kemi edhe arritje. Pse s'përmendeshin gjëkundi ato? Jua them unë... Se grupi i punës e ka parë gjendjen me syze të zeza, se ka dashur të nxijë realitetin. Pse, vetëm në sektorin tim qenkan këto të meta? Jua them unë... Këto janë kudo, bile ne, si sektori më i largët, kemi më pak... — U hodhi një vështrim anëtarëve të kryesisë dhe kuadrove që mbushnin zyrën. Edhe ata nuk ia ndanin sytë. Ç'po bënte kështu Emmini? Kishte lajthitur fare. Në vend të bënte autokritikë, po sulmonte grupin e kontrollit.

— E di unë pse bëhen të gjitha këto... Sepse doni të më shkarkoni nga detyra, prandaj grupi nuk përtoi të rendiste tridhjetë e pesë konstatime. Duket ashiqare se janë bërë me tendencë. — Kaq tha Emmini si parathënie dhe u ul.

— Diskutimi i Eminit, shokë, mendoj se jo vetëm e mbushi buzë për buzë kupën, por edhe e derdhi. Prona kolektive për faqe të zezë. Frutat kalbeshin poshtë pemëve, dyqanet teneqe. Disa brigada ankoheshin për thasë, magazinës po i mykeshin kollitë me thasë të pahapur. siç i mori nga baza e bujqësisë. E ç't'ju them më përpara!

Shkurt muhabeti, shoku kryetar, atje kudo kishte dëmtime të rënda, — e sosi fjalën Selfoja, kryetar i degës së financës së kooperativës së bashkuar, me përqindje e shifra.

— Me leje! — kërkon fjalën një anëtar i moshuar i kryesisë. — Me ç'po më dëgjojnë lllapat e veshëve, kjo është skandaloze. Si, more, një grup i tërë e gjen bërnut sektorin dhe shoku Emin ka sy e faqe të thotë se po ia bëjnë me qëllim?! Ku e keni ju ndëgjegjen, po turpin?

Asgjë s'po pipëtinte në zyrë.

— Shoku kryetar, kjo është paturpësi, s'ka tjetër emër. Ka ligje për disa shkelje të tilla... — e mbylli diskutimin anëtari i vjetër i kryesisë.

Faslliu, kryetar i degës së planit, e zgjeroi diskutimin në sferën e fushës së vet.

— Sektori i Dushkut ka probleme me normat, me ditët e punës. A e dini ju, more shokë, se mungesat pa arsye në vend të shkonin drejt uljes, janë rritur? Si shpjegohet kjo? Vetëm me dy fjalë: Sepse atje ka lëshime, ka oportunitizëm. Apo i ka gjetur punës njeriun? Emimi i ka ndarë ato të flamosura detyra si t'i jepte qorrit pasqyrë, qerosit krëhër e shurdhit daulle.

Të qeshura në sallë.

— Na e ndaj pak grurin nga egjri, shoku Faslli. Ne, anëtarët e kryesisë, duam të dimë ç'i takon përgjegjësit e ç'ju takon juve. Se, për besë, me sa shoh e dëgjoj sot këtu, pa një gjemb në këmbë nuk do dilni, jo. — foli një kooperativiste e re.

Shefi i planit u përcoll.

— I kemi thënë, e kemi porositur, e kemi këshilluar. Kot, se Emimi s'ka dashur të dëgjojë...

Fjalën e kërkoi Ruzhdiu, agronomi i koope-

rativës. Ai e nisi dhe e mbaroi diskutimin, si i thonë fjalës, ngri e lësho Eminin. Ruzhdiu i Plepasit njihej se ngrinte pluhur edhe në llaç. E shkërmoqi përgjegjës in e sektorit të Dushkut me fakte konkrete, duke përmendur emra parcelash e arash që, për pakujdesi të organizimit dhe drejtimit, nuk kishin dhënë as gjysmën e prodhimit.

E dërrmoi aq shumë, sa dhe kryetarit i erdhi keq.

— Hë, Emin, si thua? — ndërhyri kryetari.

— Drejt e ka Ruzhdiu, — tha përgjegjësi.

Një e qeshur e lehtë lodroi në sytë e buzët e pjesëmarrësve nga pohimi i singertë i Eminit.

— Mirë e ke, vetëm autokritika të shpëton! — i pëshpëriti Eminit afër veshit përgjegjësi i sektorit fqinj.

— Do ta bëj, do ta bëj! Do ta shikosh. Kusur s'do t'i lë vetes, — foli Emini nën zë.

Më tej edhe tre diskutantët e tjerë e bënë bërlok përgjegjës in e sektorit më të largët. Erdhi e u kërrus i gjori Emin sa u bë një dorë njeri.

— E, Emin! I dëgjove? — e pyeti së fundi kryetari.

— Si urdhëron, i dëgjova!

— Ke për të shtuar gjë?

Kjo tingëlloi si fjala e fundit që i jepet të pandehurit.

— Kam, posi! Dhe unë dakord jam me të gjitha sa u thanë këtu, shoku kryetar. Kaq munda, kaq shkunda. E kam hak të më hiqni. U binda dhe vetë që s'jam për këtë punë. Më mirë të kthehem në prodhim, andej nga kam ardhur.

Të gjithë i kishin ngulur sytë martirit të mbledhjes.

— Lutja ime e fundit, — vazhdoi Emin, — vendosni një përgjegjës tjetër nga kjo sallë, që sot. Të vijë me mua dhe t'i bëj dorëzimet, se punët nuk presin. Fushatat po trokasin në derë... — tha ai dhe u ul.

U bë aq qetësi, sa dëgjohej miza.

— Mirë, — u dëgjua zëri i kryetarit. — Ti, Emin, na fal pak e prit aty jashtë, — foli ai, sikur brenda do të merrej vendimi i gjyqit.



— Problemi, shokë, është i qartë dhe i thjeshtë. Në mos sot, nesër, Emimi duhet të zëvendësohet. Për të mirën e punës dhe të tijën, më mirë që sot... Përgjegjësi do të dalë nga radhët tona, — vazhdoi kryetari. — E zëmë nga unë. Siç e dini, unë kam tetë muaj kryetar kooperative, pra, jam më i riu. Sa vjet po bën ti, Faslli, në detyrën e shefit të planit?

Faslliu u zbardh në fytyrë, u ngrit në këmbë e po kruante mjekrën.

— M'u bënë... m'u bënë nja tetë vjet, o kryetar! — tha ai me zë krejt të ndryshuar.

— Pra, ke fituar goxha përvojë. Sikur të shkoje në sektorin e Dushkut! Njerëzit i njeh... Punën po... Si mendon?

— Ju, ndoshta nuk e dini, shoku kryetar, unë vuaj kiamet nga veshkat. Tre gurë kam. Minierë, ore, minierë! Në shtëpi dhe nuk ia dal dot. Ziej e pi vetëm mustaqe misri e bishta qershie me okë...

— Shkurt, je me raport dhe nuk ke si të shkosh. — foli kryetari me një pëllëmbë hundë.

— Po! Ama duhet të më kuptoni... Unë qarkullimin... — desh të vazhdonte me zë të ulët Faslliu.

— E mora vesh, pra, — tha kryetari. — Po ti, Qerim, si thua?

— Nuk e ka mirë Faslliu, shoku kryetar.

— More, për vete, për vete, si thua?

— Ç'ne unë! — protestoi agronomi i pemëtarisë. — Le që jam i specializuar për pemëtari,

por vuaj edhe nga zemra. Kam kartelë në rreth... Po nuk besuat, pyetni poliklinikën... E marrim në telefon që tani...

— Hë! Po ti, Selfo, sa vjet ke në këtë punë?

— ndërron frontin e pyetjeve kryetari.

— Unë? Nëntë vjet dhe mund të qarkulloja. Bile as që prisja të ma thoshin të tjerët, po halli është se unë sapo jam martuar dhe s'm'i vete që s'm'i vete mbarë shëndeti fëmijës.

Kryetari psherëtiu thellë.

— Po kë të propozojmë para masës, more shokë, kë të propozojmë? Manen apo Shanikon, që janë në prag të pensionit? — Dukej se kryetari qe vërtet në hall. — Hë, të shkretën, na gjeni ndonjë kantidaturë të mirë... — i nxiti ai pjesëmarrësit.

U bë një zhurmë e mbytur në zyrë. Lëvizën disa karrige. Kryetari kontrolloi edhe një herë me sy. Pritja po bëhej e nderë.


— Me leje? — foli Ruzhdiu, duke u ngritur më këmbë. Kureshtarët po prisnin kë do të propozonte agronomi.

— Kam mendimin t'i japim dhe një herë dorën Eminit, shoku kryetar...

Të gjithë aprovuan njëzëri. E thirrën Eminin që po priste përjashta dhe i dhanë dorën për t'i uruar riemërimin.

TRASTA MË MBAROI PUNË

Si ajo zaphana nuk kisha parë ndonjëherë. Ishte e mbështjellë me mushama nga kreu në fund. Maune, dëgjova se i thoshin. Anash i zbardhnin



ca shkronja të mëdha, ALBANIA. Me një kamion të tillë më nisi nipi për në Tiranë. Besova se shoferi, si njeri «i dalë», do të na kënaqte me muhabetë gjatë rrugës.

— Ju shikoni botë! — ia filloi gruaja që kishte ndenjur përpara meje, bri shoferit. Shoferi nuk iu përgjigj.

— Kur i është bërë kësmet, pse të mos shikojë? — i dha shkëlqim muhabetit udhëtari që rrinte në krahun tim.

Ishte i veshur shik. Po t'i shihje vetëm fytyrën ngjante me atë të gjahtarit të dhelprave. Shoferi shikonte punën e tij, me duart shtrënguar mbi timon. «Ky që na ra në hisë këtë herë, i druhet muhabetit», mendova. Mirëpo, sa kaluam rrugën e paasfaltuar, shoferi u kthye nga unë e më pyeti:

— Nga të kemi?

Vura re se qylafi im zinte çerekun e pasqyrës dhe shoferi nuk po m'i ndante sytë.

— Nga malësia e Poroçanit jam, — ia ktheva plot gojën.

— Ku ke punuar? — vazhdoi të më pyeste.

— Ku nuk kam punuar, thuaj! Po me pyjet jam marrë shumë, — fola dhe padashur shtrëngova trastën që po mbaja mbi gjunjë.

— Sot edhe unë bulmet pishë po transportoj. Ngarkova në pyjore, — foli buzagaz.

Udhëtarët hapën sytë e i bënë shenjë njëritjetrit: ç'që ky bulmet pishash? Mbase iu duk si kod i fshehtë, s'besoj t'u këtë vajtur mendja për rrëshirë. Shoferi, sa për mirësjellje, e pyeti edhe gruan prej nga ishte e ku shkante.

Aq u desh. Gruas nuk i mbante goja arra

gjëkundi. Donte të dinte sa herë në muaj del shoferi jashtë shtetit, në cilat shtete shkon, ku ngarkon, ku shkarkon. Nisi të interesohej ku hante e pinte e ku bënte gjumin. Ai babloku priti sa mbaroi pyetjet dhe e sqaroi se dilte jashtë shtetit sipas planit, shkarkonte ku kishte kontratë dhe flinte ku t'i vinte gjumi.

Burri qe diçka më i përmbajtur. Rremo Murrizi e quanin dhe, me sa duket, ishte i gjezdisur, se filloi ta pyeste shoferin sikur fliste për vende të njohura, nëse e kishte parë lumin e liqenin e madh pranë Gjenevës, nëse kishte ndonjë fotografi nga galeria e arteve të Vjenës, nëse kishte vizituar ekspozitën e Brukselit.

— Kushedi sa plaçka ke sjellë... — ndërhyri gruaja.

Burri i hodhi një vështrim të egër. Siç doli më vonë, ata s'kishin të bënin me njëri-tjetrin.

— Çfarë nuk po bëj për një rrugë! — pëshpëriti Rrema. Aty, njëditëzaj, dy shokët e mi kishin sjellë një model motosharre. E provuam në fushë të druve dhe e di që po na shkon mirë? Të porositim dhe ca të tjera, i propozova drejtorisë. Ah, sikur t'i zgjidhet gjuha Rakos kësaj here dhe të më nisë mua... Në Itali, ose në Rumani...

Sa dëgjova bisedë sharrash, menjëherë ndërhyra, se më takonte.

— Për sharrën e fshatit tim u hodha dhe unë njëherë andej nga kryeqyteti... Ç'kemi hequr atëherë për një copë zinxhir. — Vura re se po qeshnin nën buzë. E mblodha e vazhdova: — Bile, edhe kësaj here për një pjesë këmbimi i jam vënë kësaj rruge. Na u këput dollaja...

Gruaja u mblodh sikur ta priste barku, pastaj filloi të kukuriste me vete.

— Dalloja, hə! — qeshi përsëri. — O xhaje, mos ma merr për keq, më qafsh, po dalloja, dollaja e dollmaja njëlloj më duken... Rrofsh, xhaje, se na kënaqe sot! Italiane apo romune janë këto dollatë? — pyeti përsëri dhe qeshi sa mundi.

— Dollatë janë të gabelëve. — Kaq fola dhe e kyça derisa arritëm në kryeqytet.

— Kot iu zemërove, — më tha shoferi kur u ndamë, — se asaj aq ia priste.



Pasi dola bosh në disa vende, më në fund u përplasa te zyra e drejtorisë. Adresën e shokut Rako e kisha në kutinë e duhanit. Roja që ndodhej në fundin e shkallëve, më tha të ngjitesha në katin e tretë. Pas pesë minutash isha në një zyrë të madhe të shtruar me qilim, me një tryezë në formë goneje, në krye të së cilës qëndronte shoku Rako dhe anash një burrë rreth të tridhjetave. Një vajzë e hollë dhe e gjatë si stap arixheshke që përkulur mbi tryezën e vogël dhe sec shkruante me një stilolaps.

Shoku Rako, sapo e mori vesh se kush isha e pse isha munduar, më uli në një karrige pranë stufës. Tërë prapësitë më duket se m'i solli ai djall telefoni që tingëlliti atë çast.

— Nuk do të mërzitesh! — foli Rakoja. — Më kërkoni për një punë me shumë rëndësi, —

tha ai i qeshur vesh më vesh e doli i përcjellë nga shikimet ziliqare të dy të tjerëve.

— Si duket, e kanë vendosur. Do nisen për motosharrat, — i foli burri me zë pak të ulët.

«Nuk m'u ndakan motosharrat mua! Në ALBANIA me ato, dhe këtu në zyra po me motosharra.» Mirëpo çifti nuk bëhej merak se për çfarë mendoja unë.

— Ti do të shkosh se s'bën! — ia ktheu vajza.
— Ke menduar çfarë do më sjellësh mua? — Tjetri u mbush me frymë dhe e nxori ngadalë me një siklet të madh.

— Të vete njëherë, shoqja Fili...

— Do vesh patjetër, — ia ktheu ajo. — As mos e diskuto. Shoku Rako s'ma prish mua...

— Ajo shoqja jote që u kthye pardje, kishte ardhur rëndë, më thanë...

Vajza s'pati kohë të përgjigjej, se atë çast hyri në zyrë një djalosh i bëshëm me trup sportisti.

Fili u ngrit e po hetonte me kujdes të porsaardhurin nga koka deri te këpucët. Sytë i mbetën më gjatë te pulovri e tij me katrorë shahu.

— Si dole andej? — e pyeti vajza me tërë kuriozitet.

— Kishte gjëra me interes për sektorin tonë dhe ne mund të vëmë në zbatim disa nga ato metodat që pashë atje... — i shpjegoi i porsaardhuri.

— Ehe! U morëm vesh! — foli vajza.

Qaniu me të porsaardhurin dolën, pasi i lanë adresën Filit se ku do të venin. Mbeta vetëm me sekretaren. Biondja mori edhe një herë në telefon e foli me dikë italisht.

— Ashtu është, motër, ashtu! Venë e çojnë

matufët jashtë shtetit. Sapo doli një nga zyra. Asgjë nuk kishte marrë. Edhe pulovri nuk m'u duk si i jashtëm... Seç dërdëlliste për ca metoda. — Nxori nga çanta një pasqyrë të vogël, u shikua, u dha flokëve me të pesë gishtat e po ' buzëqeshte vetes. Nuk pati mundësi ta sodiste fytyrën gjatë, se në derë u ndien të trokitura. Pas pak hapësirën e saj e zuri trupi i bëshëm i Rremo Murrizit, me të cilin kishin udhëtuar së bashku në maune një ditë më parë. Pyeti për Rakon dhe u ul pranë meje. U kthye edhe Qaniu me nja dy shokë të tjerë, me sa duket e kishin kapur te shkallët.

— Po ti, xhaje, çfarë pret? — më pyeti për të tretën herë gjatovica. Nënteksti që i qartë: «Rrallohu, se po na bën vapë.»

— Ta thashë, pres shokun Rako.

— Çfarë kërkon nga shoku Rako? — nguli këmbë biondja.

— Një të firmosur për dolla sharre, — i thashë si fakiri që lyp thesin dhe miellin.

— Si, si? — u interesua të pyeste vajza duke ua bërë me shenja shokëve.

— Dolla-a-a! — shqiptova me zë të lartë. — Është ca noprane në të dëgjuar, po ka edhe një të mirë. Po ta rroku një herë veshi, nuk e harron më... Pastaj, dua t'i tregoj shokut Rako edhe disa pjesë këmbimi që i ka prodhuar uzina mekanike e rrethit tonë.

— Çfarë, për shembull? — pyeti Qaniu, duke drejtuar sytë nga trasta. Ajo qëndronte atje ku e kisha lënë, në qoshe, bashkë me shkopin, e fryrë, dingëz. Pesë palë sy tani e shikonin me zili.

— Zinxhirë motosharre dhe koka palle... — e sqarova. — Ne i kemi provuar dhe provat kanë kaluar me sukses.

Me sa duket, dyshonin se në çantë do kishte gjëra të tjera dhe jo vegla këmbimi.

— Më duket se ky xhaja e preu biletën për në Itali me këto dhuratat që ka sjellë sot, — tha biondina.

— Kur ke ndër mend të kthehesh? — më pyeti Rremo Murrizi.

— Pa pjekur me shokun Rako? — mora tallaz unë. — As e luaj këmbën prej këtej. . .

— O xhaje, mos u bëj zevzek! A ke ardhur për kollodokun e sharrës së ujit, apo dollanë, si i thua ti? — pyeti njëri nga shokët e Qaniut.

— Po, mor xhan, — iu përgjigja.

— Atë ta gjejmë ne, — rrahu gjoksin ai. — Fili, të lutem, merr një autorizim, vulose dhe me një frymë të ndodhesh këtu. — Pastaj m'u drejtua mua. — Me këtë autorizim do marrësh dollanë në Sharrat e Bishnicës me një mikrobus që do të nisët pas gjysmë ore. Që aty Poroçanin e ke në prag të derës. Makinat e tranzitit vijjnë si pikat e shiut

Ma ngjeshën autorizimin në dorë. Rremoja më futi krahun. Demek, kuptova unë, «nisu e mos e zgjat më!»

— T'ia kishim mbajtur atë trastën. Kam frikë se do na e bëjë çorbë punën me të, — fliste me zë të ulët merakliu i rrugëve jashtë shtetit. Desha ta hiqja edhe unë pak vallen.

— Falemnderit shumë, — u thashë si e rrasa autorizimin në xhep, — po unë kam porosi nga kryeinxhinieri i uzinës t'i raportoj shokut Rako për këto pjesë, se po dërgojnë shokë jashtë shtetit. Pse t'i mundojmë të gjorët, pse të ndahen nga familja, pse të trapiten gjer në Danimarkë e Suedi, se andej bën qamet ftohtë dhe s'dihet si u prin kli-

ma. — Disa po më shikonin më urrejtje që isha poftisur aty në një çast të pavolitshëm e disa po më qanin hallin që isha aq i trashë ose naiv.

Makina erdhi e unë gjoja sikur s'doja të nisesha po bëja naze, gjasme prisja shokun Rako. Në fund të fundit, autorizimin e dollasë e kisha në xhеп. Ç'më duhej më shumë? Edhe me makinë angazhe po më nisnin. O po këta që venë jashtë shtetit si në pazarin e qytetit, kur duan, bëjnë mrekuллira.

*

* * *


Dollanë e solla, i raportova kryetarit.

— Më jep njerëz dhe për pesë ditë e ke sharrën në punë. . .

— Si të priti shoku Rako? Besoj se të ndihmoi. . . — më tha duke dashur të mësonte hollë-sira.

— Shoku Rako qe i zënë, po, për fat, shokët e tij u treguan të gjindshëm.

Tani po ju rrëfej pse nuk ua lashë trastën. Se atje unë s'kisha as zinxhir motosharre, as hekura, po vargje me oshaf molle e dardhe dhe me speca djegës që më pati shtirë ime shoqe për të kunatën. Siç i shpura, ashtu i solla, po nuk kam pse të qahem që u hoqa të rëndët, se ato më ndihmuan për të mbaruar punë.



P È R M B A J T J A

Hallet e hallës sime	3
Ta mendojmë... ..	10
Me leje?!	18
Ç'ke, o Rexho, që rënkon?	23
Pleqtë e fshatit tim	34
Ua tregoj unë atyre	39
Qenami	54
Më shtinë në brazdë	61
Konsultimi	70
Ethet e pemëtarisë	76
Ama, të njohur!	81
Eh, këta fëmijët e sotëm, moj motrani... ..	85
A e keni parë mistrinë time?	90
Fletët e dafinave dhe ato të hithrave	98
Çeloja merret me meteorologji popullore	106
Shoku i degës nga rrethi	115
Ku punon ky shoku?	122
Ah, këta arinjtë!	128
Nuk është bimë dekorative	137
Kur kritikohej një përgjegjës sektori	144
Trasta më mbaroi punë	149